

Instituti i Kosovës për Drejtësi

Kosovo Law Institute

Kosovski Institut Právde

19/2020

KRIMET E RËNDA NË KOSOVË - 2019

(ANALIZË E TRAJTIMIT TË RASTEVE GJYQËSORE
NË DEPARTAMENTET E KRIMEVE TË RËNDA NË SISTEMIN E DREJTËSISË)

Prishtinë, tetor 2020

Autoret: Medina Kadriu dhe Sabina Pergëga

Ekipi i Redaktorëve: Betim Musliu, Ehat Miftaraj, Gzim Shala dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

Ky botim është produkt i projektit “Kërko Drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë”, i cili mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan përmes Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe zbatohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD në partneritet me Iniciativa për Progres – INPO.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Tetor 2019

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	5
2. Metodologjia.....	7
3. Korniza ligjore.....	8
3.1. Mandati ligjor i prokurorive dhe gjykatave në Departamentin e Krimeve të Rënda (DKR)	11
3.2. Kërkesa e gjykatësve të DKR-së të GjTh në Prishtinë drejtuar Gjykatës Kushtetuese lidhur me trajtimin e lëndëve të PSRK-së	13
4. Ngarkesa e Gjykatave dhe Prokurorive me lëndë në DKR.....	17
4.1 Ngarkesa totale me lëndë e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës gjatë katër viteve (2016, 2017, 2018, 2019)	17
4.2 Ngarkesa më lëndë në DKR-të e GjTh-ve gjatë viteve 2016, 2017, 2018 dhe 2019....	19
4.3 Ngarkesa më lëndë në DKR të GTh sipas kategorive të veprave penale.....	23
4.4. Ngarkesa totale me lëndë e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.....	29
4.5. Ngarkesa me lëndë në DKR të PTH gjatë viteve 2016, 2017, 2018 dhe 2019.....	30
4.6. Ngarkesa më lëndë në DKR-të e PTh sipas kategorive të veprave penale	33
5. Performanca e individuale e gjykatësve dhe prokurorëve në DKR.....	35
5.1. Performanca e gjykatësve në DKR	35
5.2. Mënyra e zgjidhjes së lëndëve në DKR të Gjykatave Themelore gjatë vitit 2019	39
5.3. Performanca e prokurorëve në DKR.....	40
5.4. Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga DKR-të e Prokurorive Themelore gjatë vitit 2019 ...	42
6. Ngarkesa më lëndë në DKR-të e Gjykatës së Apelit gjatë viteve 2016, 2017, 2018 dhe 2019.....	44
6.1 Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga gjykatësit e DKR-ve të GjA-së gjatë periudhës 2016-2019.....	45
6.2 Performanca e gjykatësve të DKR-së së GjA-së gjatë vitit 2019	46
7. Gjetjet e IKD-së në trajtimin e rasteve në Krime të Rënda	48
8. Trajtimi i detajuar i disa nga rasteve të analizuara nga IKD në DKR-të për vitin 2019	57
9. ANEX I: Analizë e detajuar e rasteve që kanë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë.....	58
10. ANEX II: Trajtimi i detajuar i rasteve të kthyera në rigjykim	72
11. ANEX III: Analizë e detajuar e rasteve që kanë përfunduar në shkallë të parë	99
12. ANEX IV: Analizë e detajuar e rastit që është ende në proces	110
13. Rekomandime.....	113

LISTA E SHKURTESAVE:

DKR	Departamenti i Krimeve të Rënda
DS	Departamenti Special
DUDNJ	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
GjEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GjTh	Gjykata Themelore
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Kodit i Përkohshëm Penal i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPPK	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PTh	Prokuroria Themelore

1. Përmbledhje ekzekutive

Gjatë monitorimit të DKR-ve të Gjykatave Themelore, IKD ka gjetur se numri i lëndëve të zgjidhura që nga viti 2016 e deri në fund të vitit 2019 ka rënë vazhdimisht.

Paradoksalisht, ulja e numrit të lëndëve të zgjidhura ka shkuar paralelisht me ngritjen e numrit të gjyqtarëve. Pra, përderisa ideja e ngritjes së numrit të gjyqtarëve është rritja e efikasitetit në kuptim të numrit të lëndëve të zgjidhura, e kundërta ka ndodhur në DKR-të e Gjykatave të Republikës së Kosovës.

Këtë fakt, në KGJK e kanë arsyetuar me faktin se disa lëndë janë më komplekse dhe disa lëndë mund të kryhen më shpejtë, si dhe me ndikimin që ka mundur ta kenë ndryshimet legislative pas hyrjen në fuqi të kodit të ri penal.

Sa i përket parashkrimit të rasteve në DKR-të e Gjykatave, IKD gjenë se në vitin 2019 ka një rënie të kësaj dukurie, derisa nisur nga natyra e rasteve që trajtohen në këtë departament, numri i rasteve të parashkruara është ende i lartë. Sipas statistikave zyrtare të KGJK-së, gjatë vitit 2018 ishin parashkruar gjithsej 52 raste në DKR-të e shtatë Gjykatave Themelore (46 parashkrim absolut, 6 parashkrim relativ), derisa në vitin 2019 janë parashkruar 39 raste (21 parashkrim relativ, 18 parashkrim absolut) apo 13 raste më pak se në 2018. Edhe pse sistemi gjyqësor vazhdimisht deklarohet se i trajton me prioritet rastet e korrupsionit, IKD ka gjetur se edhe në vitin 2019 janë parashkruar 7 raste të korrupsionit, për dallim nga viti 2019 ku ishte parashkruar një lëndë më shumë, përkatësisht 8 lëndë të korrupsionit.

Sa i përket sistemit prokurorial, mënyra e paraqitjes së statistikave në raportet zyrtare të këtij sistemi pamundëson trajtimin e trandit të efikasitetit të DKR-ve të Prokurorive Themelore, derisa nga të dhënat e paraqitura shihet se ndonëse prokurorët kanë arritur që gjatë katër viteve me radhë të zgjidhin lëndë më shumë se sa që kanë pranuar, shqetësuese vazhdon të mbetet numri i lëndëve që trashëgohen vit pas viti në DKR-të e Prokurorive Themelore, dhe qasja e sistemit prokurorial përkitazi me këto lëndë. Po ashtu, sistemi prokurorial nuk posedon, apo të paktën nuk ka ofruar, të dhëna lidhur me numrin e rasteve të parashkruara në sistemin prokurorial.

IKD në këtë raport ka analizuar edhe performancën individuale të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Shprehur në mesatare të numrit të lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e gjyqtarëve, i bie se gjatë vitit 2019, secili gjyqtar ka zgjidhur mesatarisht nga afërsisht 32 lëndë në vit, apo një (1) lëndë më shumë se sa norma orientuese për gjyqtarët e DKR-ve, e përcaktuar nga KGJK. Ndërsa, sipas raportit vjetor të Prokurorit të Shtetit, prokurorët e DKR-ve gjatë vitit 2019 kanë zgjidhur mesatarisht nga 65.29 lëndë ose 2.71 lëndë nën normën e përcaktuar me udhëzim.

Ndërsa, nëse analizojmë punën individuale të secilit gjyqtarë, atëherë shohim se ka një disbalanc të theksuar në mes numrit të lëndëve të zgjidhura, ku ka gjyqtarë që brenda një viti kanë zgjedhur 102 lëndë, derisa ka edhe gjyqtarë të tjera që brenda një viti nuk kanë arritur as normën orientuese për gjyqtarë të DKR-ve, të përcaktuar nga KGJK.

Për dallim nga KGJK që ka dëshmuar transparencë përmes publikimit të këtyre raporteve, KPK nuk ka dhënë qasje në këto të dhëna.

Sa i përket mënyrës së zgjidhjes, IKD gjenë se gjatë vitit 2019, dënimi më i shpeshtë i shqiptuar nga DKR-të e Gjykatave Themelore ka qenë dënimi me burgim efektiv, pasuar nga dënimi me gjobë dhe ai me kusht.

Ndërsa, sa i përket mënyrës së zgjidhjes së lëndëve në sistemin prokurorial, shumica e tyre janë zgjidhur duke ngritur aktakuza.

Në trajtimin e rasteve në DKR si sfidë vazhdon të mbetet kohëzgjatja e procedurave gjyqësore, ku në të paktën tri (3) raste, IKD ka gjetur se që nga ngritja e aktakuzës e deri më 31 dhjetor 2019 kanë kaluar mbi nëntë (9) vite. Krahas të tjerave, kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore i kontribuon edhe praktika e kthimit të rasteve në rigjykim nga ana e Gjykatës së Apelit, e cila gjykatë gjatë vitit 2019, ka kthyer në rigjykim gjithsej 464 raste gjyqësore që trajtohen në DKR.

Sa i përket konfiskimit të pasurisë së përfitur në mënyrë të kundërligjshme, prej 806 rasteve të monitoruara gjatë vitit 2019, IKD gjenë se Prokurori i shtetit kishte paraqitur kërkesë për sekuestrim në vetëm 68 raste, ndërsa në 738 raste nuk kishte paraqitur kërkesë.

Sa i përket konfiskimit të pasurisë së përfitur me vepër penale, më 10 janar 2019 ka hyrë në fuqi Ligji nr.06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë. Në këtë drejtim, mbi 17 muaj pas miratimit të këtij ligji, i njëjti është aplikuar vetëm në një rast nga PSRK, e cila e dhënë e pothuajse e klasifikon këtë ligj si të mirë në letër, por të pazbatuar në praktikë.

Krahas të tjerave, IKD ka identifikuar raste kur të pandehurit i janë shkelur të drejtat kushtetuese. Përderisa në një (1) rast ishte bërë presion ndaj të pandehurit për ta pranuar fajësinë, në rastin tjetër i akuzuari është mbajtur mbi katër (4) vite në një procedurë penale, me anë të një aktakuze të ngitur pas afatit ligjor. Në një rast tjetër, IKD ka gjetur se i pandehuri është arrestuar dhe dënuar, pas rihapjes së kundërligjshme të procedurës gjyqësore, në të cilin rast, Prokurorja e Shtetit me anë të rikualifikimit të aktakuzës, kishte shkelur parimin e ndalimit të veprimit retroaktiv të ligjit.

Në këtë raport, IKD ka dhënë edhe 18 rekomandime, disa prej të cilave janë: 1) KGJK dhe KPK të bëjnë një analizë gjithëpërfshirëse të ngarkesës së DKR-ve me lëndë, në mënyrë që të kenë mundësi të ndërmarrin hapa për stabilizimin e këtyre departamenteve, veçanërisht sa i përket lëndëve të cilat barten vit pas viti, 2) Për të shmangur parashkrimin, si dhe për të respektuar të drejtën e të pandehurve për gjykim në kohë të arsyeshme, Gjykata e Apelit në rastet kur ia mundëson ligji, të vendos në mënyrë meritore dhe lëndët mos të kthehen në rigjykim, ashtu që të mos krijohet “ping-pong” gjyqësor, 3) Për rastet e lejuara me ligj, Prokurorët të aplikojnë Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë etj.

2. Metodologjia

IKD me qëllim që të përpilojë një raport sa më gjithëpërfshirës dhe analitik, në lidhje me trajtimin e rasteve në Departamentin e Krimeve të Rënda nga sistemi prokurorial dhe gjyqësor, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit.

Për draftimin e këtij hulumtimi, IKD ka përdorur dokumente të ndryshme zyrtare (legjislacionin primar dhe sekondar, raporte të ndryshme zyrtare të KGJK-së, raporte të ndryshme zyrtare të KPK-së si dhe të dhëna të tjera të siguruar nga këto institucione përmes kërkesave për qasje në dokumente publike). Po ashtu, janë përdorur dokumente ndërkombëtare, të cilat janë të obligueshme dhe drejtpërdrejtë të zbatueshme në sistemin e drejtësisë.

Përpos këtyre dokumenteve, draftimi i këtij raporti është bazuar në monitorimin e drejtpërdrejtë të performancës së prokurorive dhe gjykatave në zbatimin e ligjit, politikave dhe planeve të veprimit për trajtimin e rasteve në Departamentin e Krimeve të Rënda. Për të dhënat e grumbulluara gjatë procesit të monitorimit të sistemit të drejtësisë, IKD tanimë ka lansuar për publikun edhe Platformën e Monitorimit të Gjyqësorit (<https://ejudiciary.org/>).

IKD bazuar në obligimet ligjore dhe planet e veprimit ka krijuar indikatorë të qartë për matjen e progresit dhe regresit të sistemit prokurorial dhe atij gjyqësor.

Ky raport përfshin monitorimin e rasteve të Departamentit të Krimeve të Rënda në shtatë prokuroritë themelore dhe shtatë gjykatat themelore, për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2019, si dhe ngarkesën dhe efikasitetin e gjykatave dhe prokurorinë në zgjidhjen e lëndëve nga viti 2016 e deri në vitin 2019. Ndërsa, për vitin 2019, në këtë raport trajtim i veçantë i bëhet disa nga rastet, në të cilat IKD ka evidentuar shkelje.

Sa i përket DKR-ve të gjykatave dhe prokurorive themelore të Republikës së Kosovës, IKD ka analizuar ngarkesën me lëndë të këtyre departamenteve, trendin e efikasitetit, mënyrën e zgjidhjes së lëndëve, performancën e Prokurorëve dhe Gjyqtarëve etj. Për të gjitha këto, IKD në këtë raport jep edhe vlerësimet dhe rekomandimet.

Sa i përket rasteve të trajtuara në mënyre të detajuar, IKD ka analizuar trajtimin e tyre nëpër të gjitha fazat e procedurës penale, duke përfshirë fazën prej ngritjes së kallëzimit penal e deri në shpallje të aktgjykimit nga gjykatat e shkallës së parë, duke analizuar bazën ligjore. Në këtë raport, fillimisht trajtohen të gjeturat kryesore për këto raste, derisa në Anëxin 1 të këtij raporti, trajtohen të gjeturat për secilin rast veç e veç.

3. Korniza ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e miratuar 12 vite më parë, si një Kushtetutë bashkëkohore, garanton të drejtat dhe liritë e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Për më tepër, mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore është bazament mbi bazën e të cilit ndërtohet dhe zhvillohet rendi kushtetues kosovar.

Për nga numri i normave kushtetuese, numri më i madh i normave që përbëjnë Kushtetutën e Republikës së Kosovës janë normat që kanë të bëjnë me garantimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Në këtë drejtim, Kushtetuta e Republikës së Kosovës me anë të nenit 22, ka zbatuar në mënyrë të drejtpërdrejtë tetë (8) instrumente ndërkombëtare, Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj, Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; Konventën për të Drejtat e Fëmijës, Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese. Këto instrumente, bashkë me kushtetutën tonë dhe ligjet që janë në fuqi garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Gjithashtu, këto instrumente kanë epërsi ndaj akteve të tjera vendore¹.

Ndërsa, në nenin 53 të aktit më të lartë juridik, është paraparë se të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj)². GjEDNj është themeluar në vitin 1959 dhe është një nga mekanizmat më të rëndësishëm dhe kryesor për zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), si dhe konstatimin e shkeljeve të të drejtave që variojnë nga kjo konventë. Ndërkaq, aktgjykimet e kësaj gjykate janë obligative për shtetet të cilat kanë ratifikuar KEDNJ.

Akti më i lartë juridik i shtetit tonë garanton se të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit dhe se askush nuk është mbi ligjin. Çdo shtet ku frymon demokracia për mision ka sundimin e ligjit, e me anë të sundimit të ligjit garantohej edhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut.

Me nenin 3 të Kushtetutës është përcaktuar se Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore. Tutje, Kushtetuta e Republikës së Kosovës nënvizon se ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 22.

² Po aty. Neni 53.

ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre³.

Me anë të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është përcaktuar se pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat dhe është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë, si dhe se gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës e Ligjit, derisa theksohet fakti se gjyqtarët duhet të jenë të pavarur e të paanshëm⁴.

Më anë të nenit 30 të Kushtetutës është përcaktuar se çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale si, të njoftohet për drejtat e tij apo saj sipas ligjit, të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton për natyrën dhe shkakun e akuzës, të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet, të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi, të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh të komunikojë lirisht me të dhe nëse nuk ka mjete të mjaftueshme t'i sigurohet falas. Gjithashtu, me anë të këtij neni garantohet e drejta e secilit person që të mos shtrëngohet i akuzuari apo akuzuara për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë⁵.

Tutje, me anë të nenit 31 është garantuar e drejta për gjykim të drejtë dhe të pavarur, e cila e drejtë garantohet edhe me nenin 6 të KEDNj-it.

Sipas nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike dhe se çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

Sipas këtij neni, gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Me këtë nen, gjithashtu është përcaktuar se çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

Sa i përket publicitetit të gjykimit, GjEDNj në jurisprudencën e saj e ka vendosur publicitetit e gjykimit si aspekt që mbron palët ndërgjyqëse nga administrimi i fshehur i drejtësisë:

³ Po aty. Neni 3.

⁴ Po aty. Neni 102.

⁵ Po aty. Neni 30.

“Gjykata rithekson se mbajtja publike e seancave gjyqësore përbën një parim themelor të sanksionuar në paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-it. Ky karakter publik i mbron palët ndërgjygjëse kundër administrimit të drejtësisë në mënyrë të fshehur pa shqyrtim publik. Gjithashtu, është një nga mënyrat me anë të së cilës mund të mbahet besimi në gjykata. Duke e bërë administrimin e drejtësisë në mënyrë transparente, publiciteti kontribuon në arritjen e qëllimit të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ, që nënkupton një gjykim të drejtë, garancion, i cili është një nga parimet themelore të çdo shoqërie demokratike, brenda kuptimit të KEDNJ⁶”.

Tutje, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës është përfshirë edhe parimi i prezumimit të pafajësisë, ku thuhet se çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, KEDNJ-it dhe jurisprudencës së GjEDNJ-së, ndihma juridike falas do t’u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nën kushtet dhe rrethanat e përcaktuara.

Edhe me anë të nenit 6 të KEDNJ, që është i aplikueshëm drejtpërdrejtë në shtetin tonë, është paraparë se çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.⁷

Me nenin 33 të Kushtetutës, përcaktohet se nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit. Gjithashtu, përcaktohet se dënimi i shqiptuar për një vepër penale nuk mund të jetë më i ashpër sesa ka qenë i përcaktuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës dhe se ashpërsia e dënimit nuk mund të jetë në disproporcion me veprën penale e se dënimet përcaktohen në bazë të ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, me përjashtim të veprave për të cilat ligji i mëvonshëm i aplikueshëm është më i favorshëm për kryesin e veprës⁸.

Kurse, me nenin 34 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcaktohet se askush nuk mund të gjykohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale⁹ (parimi *ne bis in idem*).

Tutje, me nenin 31 të Kushtetutës është paraparë e drejta e përdorimit të mjetit efektiv që parasheh të drejtën e çdo personi që të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative, përmes të cilave sipas ankuesit mund të cenohen të drejtat apo interesat e tij të parapara me ligj.¹⁰ Kjo është e inkorporuar edhe në 8 të Deklaratës Universale për të

⁶ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Malhous kundër Republikës së Çekisë. Paragrafi 55 dhe 56.

⁷ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Neni 6.

⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 33.

⁹ Po aty. Neni 34.

¹⁰ Po aty. Neni 31.

Drejtat e Njeriut (DUDNJ), ku thuhet se “Gjithkush ka të drejtë për mjete juridike të frytshme para gjykatave kompetente kombëtare për veprimet me të cilat shkelen të drejtat themelore të garantuara nga kushtetuta ose ligjet”¹¹.

Pra, në rreshtat paraparak shihet se edhe në procedurën penale manifestohet njëra prej parimeve kryesore mbi të cilat ndërtohet rendi juridik kosovar, e që është mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

3.1. Mandati ligjor i prokurorive dhe gjykatave në Departamentin e Krimeve të Rënda (DKR)

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ndërtohet mbi parimin e ndarjes së pushteteve. Në lidhje me pushtetin gjyqësor, Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton se “Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat”¹² dhe se “Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata”¹³.

Në lidhje me gjykatat, Kushtetuta e Republikës së Kosovës organizimin, funksionimin dhe juridiksionin e lë në rregullim të ligjit. Në këtë kuptim, Kushtetuta përcakton se “Organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i Gjykatës Supreme dhe i gjykatave të tjera, rregullohen me ligj”¹⁴.

Në kuptim të zbatimit të këtij obligimi kushtetues, Kosova ka miratuar Ligjin për Gjykatat. Më 1 janar 2013 kishte hyrë në fuqi Ligji nr.03/L-199 për Gjykatat, i cili kishte ndryshuar edhe strukturën e sistemit gjyqësor që ishte në të kaluarën. Ky ligj ka pësuar ndryshe jothelbësore me miratimin e Ligjit nr.06/-L-054 për Gjykatat, i cili ka hyrë në fuqi më 2 janar 2019.

Sipas Ligjit për Gjykatat, sistemi i gjykatave i Republikës së Kosovës përbëhet nga: Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Secila prej shtatë (7) Gjykatave Themelore kanë edhe degët e saj.

Po ashtu, ky ligj përcakton edhe strukturën e brendshme për secilën gjykatë. Sipas këtij ligji, secila Gjykatë Themelore, përfshi edhe degët e saj, ka Departamentin e Përgjithshëm, derisa në secilën seli të Gjykatës Themelore veprojnë edhe Departamenti i Krimeve të Rënda dhe Departamenti për të Mitur.

Për dallim nga gjashtë (6) Gjykatat e tjera Themelore, në Gjykatën Themelore të Prishtinës funksion edhe Departamenti Special për Lëndët e PSRK-së, Departamenti për Çështje Administrative dhe Departamenti për Çështje Ekonomike.

Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore i gjykon veprat penale të dënueshme mbi dhjetë (10) vite, si dhe veprat penale që konsiderohen krime të rënda sipas Kodit Penal apo

¹¹ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut. Neni 8.

¹² Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 102.1.

¹³ Po aty. Neni 102.2.

¹⁴ Po aty. Neni 103.1.

Kodit të Procedurës Penale. Të gjitha çështjet në Departamentin për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore gjykohen nga trupi gjykues prej tre (3) gjyqtarëve profesionist, nga të cilët njëri duhet të jetë kryesues i trupit gjykues.

Deri më 28 qershor 2019, Departamenti për Krimet e Rënda në Gjykatat Themelore ka gjykuar lëndët më të rënda. Ky departament ka gjykuar lëndët e Departamentit për Krime të Rënda të Prokurorive Themelore si dhe lëndët që hynë në kompetencë të PSRK-së.

Me Ligjin e ri për Gjykatat, i cili ka hyrë në fuqi më 2 janar 2019, është paraparë edhe krijimi i Departamentit Special për Lëndët në Kompetencë të PSRK-së, i cili funksionon në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe në Gjykatën e Apelit. Në këtë mënyrë, kjo pjesë e lëndëve tanimë është larguar nga Departamenti i Krimeve të Rënda dhe ka kaluar në departamentin e ri.

Ky departament është funksionalizuar nga KGJK më 28 qershor 2019. Ky departament merret me trajtimin e lëndëve që ngritën nga Prokuroria Speciale. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), në takimin e mbajtur me 23 prill 2019, kishte miratuar Rregulloren për Organizimin dhe Funksionalizimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionalizimin e Departamentit Special si dhe përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe stafit. Drejtues të institucioneve të drejtësisë kishin deklaruar se krijimi i këtyre departamenteve do të jep rezultate pozitive në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të profilit të lartë.

Aktualisht, Departamentet për Krime të Rënda, të cilat veprojnë në kuadër të Gjykatave Themelore në vend kanë gjithsej 51 gjyqtarë.

Në anën tjetër, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj.¹⁵

Sikurse në rastin e sistemit gjyqësor, edhe për Prokurorin e Shtetit, Kushtetuta ka përcaktuar se organizimi, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit përcaktohen me ligj.

Për të zbatuar këtë obligim kushtetues, Republika e Kosovës ka miratuar Ligjin për Prokurorin e Shtetit. Sipas këtij ligji, sikurse në rastin e gjykatave, në sistemin prokurorial funksionojnë shtatë (7) prokurori themelore, Prokuroria e Apelit dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKSH).

Përpos këtyre prokurorive, me Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës është themeluar edhe PSRK si një organ prokurorial i përhershëm dhe i specializuar që vepron në kuadër të Prokurorit të Shtetit.¹⁶

¹⁵ Po aty. Neni 109.1.

¹⁶ Ligji nr.03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Neni 1.1.

Po ashtu, Kushtetuta ka përcaktuar edhe institucionet që për detyrë kanë administrimin e drejtësisë. Në këtë drejtim, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka themeluar si institucione Kushtetuese KGJK-në dhe KPK-në. Për të dy këto institucione, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ligje të veçanta.

3.2.Kërkesa e gjykatësve të DKR-së të GjTh në Prishtinë drejtuar Gjykatës Kushtetuese lidhur me trajtimin e lëndëve të PSRK-së

Me 23 nëntor 2018, Kuvendi i Kosovës kishte miratuar Ligjin për Gjykatat, që ishte shpallur në Gazetën Zyrtare me 18 dhjetor 2018 dhe kishte hyrë në fuqi më 2 janar 2019. Në zbatim të obligimeve sipas këtij ligji, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më 23 prill 2019, kishte miratuar Rregulloren (nr.03/2019) për organizimin dhe funksionalizimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit.

Në bazë të nenit 18 të Ligjit për Gjykatat është themeluar Departamenti Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, departament i cili do të gjykojë lëndët të cilat bien në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Kosovës.

Sipas nenit 42.4, të këtij ligji, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, lëndët e PSRK-së, për të cilat ende nuk është mbajtur shqyrtimi fillestar do të transferohen në shqyrtim në Departamentin Special, ndërsa lëndët për të cilat është mbajtur shqyrtimi fillestar do të vazhdojnë të shqyrtohen në gjykatat përkatëse deri në përfundimin e tyre.

Më 4 nëntor 2019, gjykatësit e Departamentit për Krime të Rënda, në Gjykatën Themelore në Prishtinë kishin parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Përkatësisht, kërkesa në Gjykatën Kushtetuese ishte nënshkruar nga gjyqtarët Suzana Çerkini, Shpresa Hasaj - Hyseni, Isuf Makolli, Shashivar Hoti, Violeta Namani, Naser Foniqi, Nushe Kuka- Mekaj, Beqir Kalludra, Vesel Ismajli, Lutfi Shala dhe Naime Krasniqi- Jashanica.

Ata kishin pretenduar se neni 42, paragrafi 4 i Ligjit për Gjykatat nuk është në pajtueshmëri me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Thelbi i kërkesës së parashtruesve të kërkesës konsistonte në pretendimin se neni 42, paragrafi 4 i Ligjit për Gjykatat, duke përcaktuar që lëndët që bien në kompetencë të Departamentit Special, por për të cilat është mbajtur shqyrtimi fillestar do të vazhdojnë të procedohen në gjykatat përkatëse, rrjedhimisht në kuadër të Departamentit për Krime të Rënda, cenon nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Gjyqtarët e DKR të GjTh në Prishtinë argumentin e tyre lidhur me kushtetutshmërinë e Ligjit për Gjykata e kishin ndërtuar duke u bazuar në parimin e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm kohor në çështje penale, ku kanë theksuar se gjykimi i lëndëve që referohen nga PSRK nga Departamenti i Krimeve të Rënda e jo nga Departamenti Special do ta vështirësonte gjykimin e këtyre çështjeve penale brenda afatit të arsyeshëm kohor.

Të njëjtit kishin përmendur disa raste sikurse rasti "Medicus" që është në gjykim më tepër se 10 vite, pastaj rastet "Toka 1 dhe 2", "Syri i Popullit", "Veteranët", "Vizat" si dhe shumë lënde të tjera të kësaj natyre.

Lidhur me këtë pretendim, ata i ishin referuar një rasti të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të datës 24 tetor 1989.

Gjykatësit që kanë parashtruar këtë kërkesë, kanë sqaruar se pranojnë ankesa nga palët në procedurë për shkak të tej zgjatjes së procedurës për arsye se në Departamentin për Krime të Rënda, në të njëjtën kohë gjykohen raste të cilat bien në kompetencën e tyre lëndore, përfshirë edhe rastet që me dispozitat e Ligjit për Gjykata bien edhe në kompetencën e Departamentit Special.

Parashtruesit e kërkesës po ashtu kishin theksuar se Departamenti Special është themeluar për të shqyrtuar lëndët të cilat janë në kompetencë të PSRK-së, e që janë raste që kanë të bëjnë me vepra penale të një natyre veçanërisht të rëndë dhe në funksion të natyrës së këtyre rasteve edhe është zhvilluar një procedurë e veçantë e përzgjedhjes së gjyqtarëve, i cili është proces i strukturuar mbi disa kushte, të cilat është dashur t'i plotësoj secili që ka pretenduar të përzgjidhet gjykatës në kuadër të këtij departamenti, andaj gjyqtarët që janë përzgjedhur është vlerësuar se janë të vetmit që mund të gjykojnë lëndë të kësaj natyre.

Lidhur me këtë, gjyqtarët e DKR të GjTh në Prishtinë pretendonin se në këtë rast shkelet parimi i gjyimit të drejtë, për arsye se të akuzuarit gjykohen nga një nivel gjyqësor jo kompetent, jo i përgatitur në nivel të mjaftueshëm profesional karshi këtyre lëndëve të kësaj natyre.

Pastaj, sipas tyre, shkelja e parimit të gjyimit të drejtë ndërlidhet edhe me shkeljen e parimit të barazisë së palëve, pasi që personat të cilët kanë kryer vepra të një natyre të njëjtë gjykohen në departamente të ndryshme, e në këtë funksion nga gjyqtarë të cilët supozohet se kanë nivel të ndryshëm të përgatitjes profesionale.

Në këtë kontest, parashtruesit e kërkesës i referohen paragrafi 86 të rastit të GJEDNJ-së "*Mullai dhe te tjerët kundër Shqipërisë*", aktgjykim i 23 qershorit 2010, në të cilin rast GJEDNJ ndër të tjera kishte vlerësuar se "*ekzistenca e procedurave gjyqësore paralele të shumta dhe të ndërlidhura duke shtruar në thelb të njëjtën çështje ligjore nuk mund të konsiderohet në përputhje me sundimin e ligjit*".

Gjithashtu, gjyqtarët e DKR të GjTh në Prishtinë pretendonin se neni 42, paragrafi 4 i Ligjit të kontestuar "*përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale*" sipas nenit 384.

Në këtë kontekst, të njëjtit kanë theksuar se kompetenca lëndore asnjëherë më parë nuk ka ndodhur të shpërndahet në dy shkallë dhe të gjykohet nga dy instanca të ndryshme gjyqësore.

Në fund, duke iu referuar nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenit 18 dhe 22 të KPPRK-së, nenit 18 dhe 19 të Ligjit për Gjykatat, gjyqtarët e DKR të GjTh në Prishtinë kanë kërkuar që Gjykata Kushtetuese

të pranojë kërkesën e tyre dhe të shfuqizojë nenit 41, 42, paragrafi 4 të Ligjit nr.06/L-054 për Gjykata si të papajtueshëm me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Mirëpo, këtë kërkesë të parashtruar nga gjyqtarët e Krimeve të Rënda në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e kishte refuzuar Gjykata Kushtetuese pa u futur fare në merita të çështjes.

Kjo pasi që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka vlerësuar se kërkesa e dorëzuar nga parashtruesit është paraqitur në cilësinë e tyre si gjyqtar të DKR-së në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe e njëjta nuk mund të merret e parashtruar nga një “gjykatë”.

Sipas nenit 113, paragrafi 8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që të jetë e pranueshme kërkesa në Gjykatën Kushtetuese, duhet t’i plotësojë disa kritere në mënyrë kumulative, ndër të cilat është edhe ajo që kërkesa duhet të jetë e dorëzuar nga një “gjykatë”.

“Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesë e dorëzuar nga parashtruesit e kërkesës, në cilësinë e tyre si gjyqtarë të Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore nuk mund të merret si kërkesë e parashtruar nga një gjykatë siç përcaktohet në legjislacionin e përmendur më lartë, më saktësisht në nenin 113, paragrafin 8 të Kushtetutës, Ligjin dhe Rregulloren e Punës dhe si është specifikuar në praktikën gjyqësore të kësaj Gjykate”, thuhet në aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Duke arsyetuar vendimin e saj, Kushtetuesja përmend edhe një rast që ishte vendosur nga ana e saj, me numër K0157/18, ku theksohet se kërkesa ishte paraqitur nga ana e Gjykatës Supreme dhe ishte nënshkruar nga Kryetari i Gjykatës Supreme, si dhe në rastin K0126/16, kur Gjykata Kushtetuese kishte vlerësuar se “gjykatë” është gjithashtu çdo gjyqtar ose koleg gjyqtarësh që ka kompetencë për të gjykuar meritat e një rasti në pritje përpara saj.

Mirëpo, në rastin konkret të kërkesës së paraqitur nga ana e gjyqtarëve të Departamentit për Krime të Rënda në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka vlerësuar se kërkesa nuk është dorëzuar as nga një koleg gjyqësor që ka rastin në shqyrtim e as nga kryetari i gjykatës.

Sipas vlerësimit të Kushtetueses, në kërkesën e paraqitur nuk është saktësuar nëse ndonjë trup gjykues i DKR-së ka një rast në shqyrtim që do duhej të trajtohej nga Departamenti Special, mirëpo vetëm janë përmendur në mënyrë të përgjithshme disa raste siç janë rasti “Medicus”, “Veteranët”, “Toka” etj, mirëpo pa saktësuar rrethanat specifike të këtyre rasteve dhe nëse këto raste do duhej të trajtoheshin nga Departamenti Special.

“Si përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës nuk janë palë e autorizuar për paraqitjen e kërkesës para Gjykatës dhe, për këtë arsye, kërkesa është e papranueshme”, thuhet në fund të aktvendimit të Gjykatës Kushtetuese.¹⁷

¹⁷ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Rasti KO197/19. 18 shkurt 2020. (Shih linkun https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2020/02/ko_197_19_av_shq.pdf?fbclid=IwAR0Gyo36aWAJjMwOvYe_NPbWhr-1TVVRH68OFDy8y4OTuPNsG05P0v9I1l8). (Qasur për herë të fundit më 25 qershor 2020).

4. Ngarkesa e Gjykatave dhe Prokurorive me lëndë në DKR

IKD me qëllim të pasqyrimin sa më të saktë të punës ndër vite të gjykatave dhe prokurorive të Republikës së Kosovës, me fokus në Departamentet për Krime të Rënda, ka analizuar ngarkesën me lëndë dhe trendin e kësaj ngarkese që nga viti 2016 deri më 31 dhjetor 2019. Në vazhdim paraqitet analiza e detajuar për të gjitha DKR-të e gjykatave dhe prokurorive.

4.1 Ngarkesa totale me lëndë e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës gjatë katër viteve (2016, 2017, 2018, 2019)

Me qëllim të pasqyrimin sa më të saktë të punës ndër vite të gjykatave të Republikës së Kosovës, me theks të veçantë Departamentit për Krime të Rënda, IKD ka analizuar ngarkesën me lëndë që nga viti 2016 deri më 31 dhjetor 2019. Në këtë analizë, IKD ka paraqitur edhe trendin e ngarkesës me lëndë në sistemin e drejtësisë, me fokus të veçantë në DKR-të e të gjitha gjykatave themelore dhe DKR-në e Gjykatës së Apelit.

Në bazë të raporteve statistikore të gjykatave që KGJK publikon çdo vit kalendarik, gjykatat themelore në Republikën e Kosovës gjatë vitit 2016 kanë pasur në punë gjithsej 831,376 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 465,800 apo 56% të lëndëve, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura 365,505 lëndë apo 44% të lëndëve.

Gjatë vitit 2017, gjykatat themelore kanë pasur gjithsej në punë 569,373 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 295,358 apo 52 % të lëndëve, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 273,888 apo 48% të lëndëve.

Gjatë vitit 2018, gjykatat themelore kanë pasur në punë 375,136 lëndë, prej të cilave kanë zgjidhur 163,978 ose 44% ndërsa numri i lëndëve që kanë ngelur të pazgjidhura është 211,049 ose 56%.

Në vitin 2019, gjykatat themelore kanë pasur në punë 307,387 lëndë, prej të cilave gjatë kësaj periudhe i kanë zgjidhur 122,978 apo 40%, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 184152 apo 60% e lëndëve.



Grafika 1 – Numri i lëndëve në punë dhe përqindja e numrit të lëndëve të zgjidhura nga GjTh gjatë viteve 2016, 2017, 2018, 2019.

Sipas këtyre statistikave, vërehet se gjykatat themelore në Republikën e Kosovës më së shumti lëndë kanë zgjidhur në vitin 2016, ndërsa nga viti në vit sipas këtyre statistikave vërehet rënie

e numrit të lëndëve të zgjidhura, pra çdo vit gjykatat themelore ulin numrin e lëndëve të zgjidhura.

Sa i përket ngarkesës me lëndë në Gjykatat e Republikës së Kosovës, Kryetari i Gjykatës së Apelit dhe kryetarët e shtatë gjykatave themelore të Kosovës, në mbledhjen e 225 të KGJK-së kur kanë deklaruar raportimet mbi punën gjashtëmujore të vitit 2019, kanë vlerësuar se gjatë periudhës prill-shtator 2019 ka pasur rezultate të mira, pasi kanë zgjidhur lëndë më shumë se sa që kanë pranuar¹⁸.

Ashtu siç kanë deklaruar krerët e gjykatave, nëse krahasohet numri i lëndëve të pranuar gjatë një viti me numrin e lëndëve të zgjidhura, çdo herë del që gjykatat zgjidhin brenda vitit më shumë lëndë se sa kanë pranuar, por pa e llogaritur numrin total të lëndëve.

Në këtë rast, në vitin 2016, gjykatat kanë pranuar 2,144 lëndë të reja, ndërsa kanë zgjidhur 2,841 lëndë apo 697 lëndë më shumë se sa kanë pranuar, pa llogaritur numrin e lëndëve që i kanë mbetur të pazgjidhura. E njëjta vlen edhe për vitet e ardhshme. Në vitin 2017 gjykatat kanë pranuar lëndë më pak se në vitin 2016, pra gjithsej 1,405 lëndë, ndërsa i kanë zgjidhur 1,930 lëndë apo 525 lëndë më shumë se sa kanë pranuar pa llogaritur numrin total të lëndëve. Pra, përkundër faktit se Gjykatat Themelore si në vitin 2016 ashtu edhe në vitin 2017 kanë zgjidhur lëndë më shumë se sa që kanë pranuar, kjo diferencë është ngushtuar në vitin 2017, në raport me vitin 2016.

Në vitin 2018, gjykatat kanë pranuar 1,340 lëndë të reja, ndërsa i kanë zgjidhur 470 lëndë më shumë se sa kanë pranuar. Pra, diferenca në mes të numrit të lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve të pranura është zvogëluar edhe në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017.

Ndërsa, në vitin 2019 gjykatat kanë pranuar 1,207 lëndë të reja, ndërsa kanë zgjidhur 1,630 lëndë apo 423 lëndë më shumë se sa kanë pranuar.

Pra, nga kjo del se gjykatat vit pas viti kanë ulur numrin e lëndëve të zgjidhura, edhe pse në krahasim me numrin e lëndëve të reja që i pranojnë në punë del që zgjidhin më shumë se sa kanë pranuar.

Por, kjo diferencë është ulur çdo vit. Në vitin 2016, gjykatat kanë zgjidhur 697 lëndë më shumë se sa kanë pranuar, ndërsa në vitin në 2017 kanë zgjidhur 525 lëndë më shumë se sa kanë pranuar, pra më pak lëndë të zgjidhura se në vitin 2017. Në vitin 2018 kanë zgjidhur 470 lëndë më shumë se sa kanë pranuar, derisa në 2019 kanë zgjidhur 423 lëndë më shumë se sa kanë pranuar.

¹⁸ “Krerët e gjykatave thonë se zgjidhën më shumë lëndë sesa i pranuan në punë, kërkojnë nga KGJK-ja rritjen e numrit të gjykatësve”. Betimi për Drejtësi. 25 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kreret-e-gjykatave-thone-se-zgjidhen-me-shume-lende-sesa-i-pranuan-ne-pune-kerkojne-nga-kgjk-ja-rritjen-e-numrit-te-gjykatavesve/>). (Qasur për herë të fundit më 25 qershor 2020).

4.2 Ngarkesa më lëndë në DKR-të e GjTh-ve gjatë viteve 2016, 2017, 2018 dhe 2019

Departamentet e krimeve të rënda të gjykatave themelore në Republikës e Kosovës, gjatë vitit 2016, kanë trashëguar 5598 lëndë nga viti paraprak, i kanë pranuar 2144 lëndë, derisa kanë pasur në punë gjithsej 7737 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 2841, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura 4840, ndërsa në kompetencë kanë dërguar 56 lëndë.¹⁹ Pra, gjatë vitit 2016, DKR-të e Gjykatave Themelore kanë zgjidhur 37% të lëndëve në punë, derisa kanë mbetur të pazgjidhura edhe 63% të lëndëve.


Gjatë vitit 2017, DKR e të gjitha Gjykatave Themelore nga viti paraprak kanë trashëguar 4726 lëndë, kanë pranuar 1405, gjithsej në punë kanë pasur 6131, prej të cilave i kanë zgjidhur 1930, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura 4091 lëndë, ndërsa kanë dërguar në kompetencë 110 lëndë. Në përqindje del se nga numri i lëndëve që kanë pasur në punë, DKR-të gjatë vitit 2017 kanë zgjidhur 31 % të lëndëve, derisa kanë mbetur të pazgjidhura 69 % të lëndëve në punë²⁰.

Gjatë vitit 2018, DKR-të kanë pasur në punë 5,431 lëndë, 4,091 prej të cilave i kanë trashëguar nga viti paraprak, derisa kanë pranuar edhe 1,340 lëndë të reja. Prej këtij numri të lëndë në punë, DKR-të e GjTh-ve gjatë vitit 2018 i kanë zgjidhur 1810 lëndë, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura 3532 lëndë derisa kanë dërguar në kompetencë 89 lëndë. Në përqindje del se nga numri i lëndëve që kanë pasur në punë DKR-të gjatë vitit 2018, kanë zgjidhur 33 % të lëndëve, derisa kanë mbetur të pazgjidhura 67 % të lëndëve në punë.

Në vitin 2019, Departamentet e Krimeve të Rënda kanë pasur në punë 4,739 lëndë, prej të cilave kanë trashëguar 3,532 lëndë ndërsa kanë pranuar në punë 1,207 lëndë të reja. Prej këtyre lëndëve në punë, DKR-të e GjTh-ve kanë zgjidhur 1630 lëndë apo 34%, kanë mbetur të pazgjidhura 2866 apo 66% të lëndëve, derisa kanë dërguar në kompetencë 243 lëndë.

¹⁹ Shënim: Këto të dhëna janë marrë nga raportet statistikore zyrtare të KGJK-së.

²⁰ Shënim: Mos përputhjet eventuale të të dhënave janë mos përputhje që derivojnë nga raportet statistikore të KGJK-së.



Grafika 2 – Lëndët e zgjidhura dhe të pazgjidhura në Departamentin e Krimeve të Rënda gjatë viteve 2016, 2017, 2018, 2019.

Ashtu siç është cekur edhe në raportin e publikuar të IKD-së për punën e DKR-ve gjatë periudhës kohore 1 janar 2018 - 30 qershor 2019, DKR-të gjatë vitit 2016, kanë pasur përqindjen më të lartë të zgjidhjes së lëndëve, në vitin 2017 është zvogëluar numri i lëndëve të zgjidhura më 31%, ndërsa në vitin 2018, është rritur numri i lëndëve të zgjidhura për vetëm 2%, përkatësisht në 33%, ndërsa në vitin 2019 është rritur numri i lëndëve të zgjidhura për vetëm 1%.

Lidhur me këtë trend, Kryesuesi i KGJK-së, Skender Çoçaj ka thënë se *“Fakti se ka rritje të përqindjes së lëndëve të kryera, tregon se ka rritje të efikasitetit në Departamentin e Krimeve të Rënda edhe pse në përqindje të vogël”*²¹.

Por, nëse nuk e shikojmë me përqindje të krahasuar në mes të numrit të lëndëve në punë dhe atyre të zgjidhura, por vetëm sipas numrit të lëndëve të zgjidhura, IKD gjen se DKR-të e GjTh-ve vit pas viti kanë ulur numrin e lëndëve të zgjidhura. Kjo pasi përderisa në vitin 2016 DKR-të e GjTh-ve kanë zgjidhur 2,841 lëndë, në vitin 2017 kanë zgjidhur 1,930 lëndë, apo 911 lëndë më pak se sa në vitin 2017. Ky regres i efikasitetit ka vazhduar edhe në vitin 2018, ku DKR-të kanë zgjidhur 1,810 lëndë, apo 120 lëndë më pak se sa në vitin paraprak. Dhe po ashtu, i njëjti regres ka vazhduar edhe në vitin 2019, ku DKR-të e GjTh-ve kanë zgjidhur 1,630 lëndë, apo 830 lëndë më pak se sa në vitin 2018.

Pra, sipas këtyre të dhënave, DKR-të e GjTh-ve vit pas viti kanë ulur efikasitetin e tyre në zgjidhjen e lëndëve në punë. Ndonëse që nga viti 2016 numri i lëndëve të pranuar në DKR-të e Gjykatave Themelore ka rënë, përqindja e lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit është rritur.


²¹ Përgjigje e Kryesuesit të KGJK-së Skender Çoçaj, për IKD. 2 nëntor 2020.

Paradoksalisht, ulja e numrit të lëndëve të zgjidhura ka shkuar paralelisht me ngritjen e numrit të gjyqtarëve. Pra, përderisa ideja e ngritjes së numrit të gjyqtarëve është rritja e efikasitetit në kuptim të numrit të lëndëve të zgjidhura, e kundërta ka ndodhur në DKR-të e Gjykatave të Republikës së Kosovës.

Në këtë drejtim, IKD vlerëson se ky është një shembull tipik se mungesa e resurseve humane nuk është problemi kryesor i sistemit gjyqësor në kuptim të numrit të madh të lëndëve. Kjo për arsye se përkundër faktit se në nivel të të gjitha DKR-ve të GjTh-ve kemi një ngritje të numrit të gjyqtarëve për 19% (8 gjyqtarë), kjo rritje nuk ka reflektuar fare në ngritjen e efikasitetit. Përkundrazi, numri i rasteve të zgjidhura vazhdimisht ka rënë.

Lidhur me këtë gjetje të IKD-së, Kryesuesi i KGJK-së, Skender Çoçaj ka thënë se *“Natyra e lëndëve në Departamentin e Krimeve të Rënda është nga më të ndryshmet, ka lëndë që janë mjaft komplekse dhe zgjasin shumë, por ka lëndë që mund të kryhen më shpejtë. Po ashtu, ndryshimet legislative pas hyrjes në fuqi të Kodit Penal të ri, ka mundur të ndikoj në këto statistika”*²².

Përpos numrit të lëndëve të DKR-ve në të gjitha Gjykatat Themelore, IKD në tabelën më poshtë ka analizuar edhe ngarkesën e secilit DKR në shtatë (7) Gjykatat Themelore dhe ka pasqyruar se DKR i GjTh-ve ka zgjidhur më së shumti lëndë gjatë katër viteve (2016, 2017, 2018, 2019):



Grafika 3 – Numri i lëndëve të zgjidhura në DKR-të e GjTh-ve gjatë viteve 2016, 2017, 2018, 2019.

²² Po aty.

DKR Prishtinë - Duke u bazuar në raportet vjetore të gjykatave përgjatë katër viteve, vërehet se DKR i GjTh në Prishtinë secilin vit krahasuar me numrin e lëndë të DKR-ve tjera e ka numrin më të madh të lëndëve në punë. Gjatë vitit 2016, sipas llogaritjeve të IKD-së duke u bazuar në raportin e publikuar të gjykatave për këtë vit, kjo gjykatë ka zgjidhur vetëm 23% të rasteve. Në 2017, gjykatësit e DKR-së në Prishtinë, vërehet se kanë rritur numrin e lëndëve të zgjidhura në 60 lëndë më shumë. Mirëpo në vitin 2018, vërehet se ka pasur numër më të vogël të lëndëve të zgjidhura, ngase në 2017, janë zgjidhur 751 lëndë, ndërsa në 2018 janë zgjidhur 122 lëndë më pak. Edhe gjatë vitit 2019 është vërejtur rënie e numrit të lëndëve të zgjidhura në këtë gjykatë, pasi gjatë këtij viti gjykatësit i kanë zgjidhur 112 lëndë më pak.

DKR Gjilan – Edhe në DKR të GjTh në Gjilan vërehet se vit pas viti është përqindja e lëndëve të zgjidhura. Në vitin 2016, ky departament i kësaj gjykate ka zgjidhur 55% të rasteve, në 2017 52% të rasteve, në 2018 ka rritur përqindjen e lëndëve të zgjidhura 55%, ndërsa në vitin 2019 përsëri ka ulur numrin e lëndëve të zgjidhura në 53%.

DKR Prizren – Edhe në DKR të kësaj gjykate sipas grafikës më lartë vërehet se nga viti në vit është ulur numri i lëndëve të zgjidhura. Në vitin 2016, gjykatësit e DKR në Prizren kanë zgjidhur 48% të lëndëve krahasuar me numrin e lëndëve që ka pasur në punë. Në 2017 janë zgjidhur 60% të rasteve krahasuar me numrin e lëndëve në punë, pasi është ulur numri i lëndëve me të cilat ky departament ka qenë i ngarkuar. Në këtë drejtim, ky departament i kësaj gjykate në vitin 2017 ka zgjidhur 66 lëndë më pas se në vitin 2016, 34 lëndë më pak në vitin 2018 krahasuar e vitin paraprak, dhe në vitin 2019 8 lëndë më pak se në vitin 2018. Pra, në vitin 2016, kjo gjykatë ka pasur efikasitetin më të madh, i cili efikasitet ka pësuar regres vit pas viti.

Sipas Gjykatës Themelore në Prizren, në këtë trend ka ndikuar kategoria e veprave penale me të cilat ky departament ka qenë i ngarkuar:

“Në vitin 2016 në Departamentin e Krimeve të Rënda, ka qenë kompetencë e këtij departamenti vepra penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” kjo vepër penale në 90% të rasteve janë përfunduar në shqyrtimin fillestar pasi që të akuzuarit kanë pranuar fajësinë për këtë vepër penale. Nga viti 2017 e këndeje kjo vepër penale ka kaluar në kompetencë të Departamentit të Përgjithshëm. Pra që do të thotë se kjo vepër penale ka përfunduar në shqyrtim fillestar edhe padyshim që e ka rritur efikasitetin e Departamentit të krimeve të rënda. Nga vitit 2017 Departamenti i krimeve të Rënda ka pasur një numër të veprave penale e sidomos tek rastet e veprave penale të korrupsionit, që duhet të sigurohen prova të ndryshme dhe ekspertizave të nevojshme që padyshim këto raste dhe rastet tjera janë më të ndërlikuara dhe lypin më shumë kohë deri në përfundimin e tyre. Po ashtu vlen të përmendet fakti se në vitin 2017 ky departament ka qenë në mungesë të një gjyqtari, pasi që për një kohë ka pasur probleme shëndetësore”²³.

DKR Mitrovicë – Në vitin 2016, gjykatësit e DKR-ve kanë zgjidhur 601 raste, mirëpo në vitin 2017 i kanë zgjidhur vetëm 140, apo 461 raste më pak. Në 2017, cilësohet rritje e numrit të

²³ Përgjigje nga nënkryetari i Gjykatës Themelore në Prizren, Artan Sejrani, për IKD-në. 21 qershor 2020.

lëndëve të zgjidhura, pra 140 lëndë të zgjidhura më shumë se në vitin 2017, në vitin 2018 janë zgjidhur 298 apo 158 lëndë më shumë. Ndërsa, në vitin 2019, është rritur numri i lëndëve të zgjidhura në 29 lëndë më shumë. Pra DKR i GjTh në Mitrovicë ka pësuar regres vetëm në vitin 2017, derisa ka pasur progres në vitet 2018 dhe 2019.

DKR Gjakovë – Edhe DKR i GjTh në Gjakovë nga viti në viti ka ulur numrin e lëndëve të zgjidhura. Në 2016, janë zgjidhur 263 lëndë, ndërsa 107 lëndë më pak janë zgjidhur në vitin 2017. Mirëpo, rënie të numrit të lëndëve të zgjidhura ka pasur edhe në vitet 2018 dhe 2019, pasi në 2018 janë zgjidhur 91 lëndë, apo 70 lëndë më pak se në 2017, derisa në vitin 2019 janë zgjidhur 18 lëndë më pak se në vitin 2018.

Në përgjigjen e Gjykatës Themelore në Gjakovë thuhet se për shkak të efikasitetit të GjTh në Gjakovë, ka pasur vazhdimisht ngarkesë më të vogël të lëndëve, derisa ka pasur numër më të vogël të lëndëve të pranuar, por se lëndët e pranuar kanë qenë më komplekse:

“Sipas vlerësimit tonë numri më i vogël i rasteve është si rezultat i punës së Gjykatës Themelore të Gjakovës në kryerjen e lëndëve. (P. Sh. nëse krahasojmë vitin 2016 kur gjykata në DKR ka nisur punën me 257 lëndë, në vitin 2019 e njëjta ka nisur punën me 66 lëndë, që i bje se kemi qenë mjaft efikas në kryerjen e këtyre lëndëve dhe kemi ulur numrin e lëndëve të trashëguara nga 257 në 66.) Po ashtu kemi pasur numër më të vogël të lëndëve që kanë ardhur në gjykatën tonë. Duhet theksuar faktin se çdo vit lëndët e ardhura në DKR, kanë qenë më komplekse në trajtim dhe ka pasur shumë pak raste që janë kryer në shqyrtim fillestar”²⁴.

DKR Pejë – Në vitin 2016, në DKR të GjTh në Pejë janë zgjidhur 391 lëndë, ndërsa në vitin 2017 janë zgjidhur 208 lëndë më pak nga gjithsej, përkatësisht janë zgjidhur 183 lëndë. Edhe në vitin 2018 vërehet rënie e numrit të lëndëve të zgjidhura, ku në krahasim me vitin paraprak janë zgjidhur 44 lëndë më pak, ndërsa në vitin 2019, janë zgjidhur 36 lëndë më pak se në vitin 2018.

DKR Ferizaj – Për dallim nga gjashtë DKR-të e gjykatave tjera, në Ferizaj vërehet se nga viti në vit është rritur numri i lëndëve të zgjidhura. Kjo pasi në vitin 2016 janë zgjidhur 191 lëndë, ndërsa në vitin 2017 janë zgjidhur 198 lëndë apo tetë lëndë më shumë. Në 2018 janë zgjidhur 7 lëndë më shumë se në vitin 2017, derisa në vitin 2019 janë zgjidhur 19 lëndë më shumë se në vitin 2018.

4.3 Ngarkesa më lëndë në DKR të GjTh sipas kategorive të veprave penale

IKD përpos numrit të përgjithshëm të lëndëve në DKR-të e gjykatave themelore, ka analizuar edhe ngarkesën e lëndëve sipas kategorive të veprave penale.

Sipas këtyre të dhënave, rezulton se në vendin tonë, gjykatat themelore përkatësisht DKR-të, më së shumti kanë qenë të ngarkuara me lëndë nga kategoria “Veprat penale kundër jetës dhe trupit” ku më së shumti raste nga kjo kategori e veprave penale rezulton se ka pasur për veprat

²⁴ Përgjigje e zëdhënësit të GjTh në Gjakovë, Lekë Muçaj, për IKD-në. 20 qershor 2020.

penale “vrasja” dhe “vrasja e rëndë”. Pas “veprave penale kundër jetës dhe trupit, ngarkesa e DKR0-ve gjatë vitit 2019 pasohet me rastet e veprave penale të narkotikëve (713), vepra penale të armëve (579), dhe vepra penale kundër pasurisë (474).

Në tabelën më poshtë, është paraqitur numri i lëndëve të trashëguara nga DKR-të e GjTh-ve, numri i lëndëve të pranuar, në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura për secilën kategori të veprave penale:

Veprat penale sipas kapitullit të Kodit Penal	Lëndë të trashëguara	Lëndë të pranuara	Lëndë në punë	Lëndë të zgjidhura	Lëndë të pazgjidhura	Lëndët në kompetencë brenda gjykate
Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Rep. së KS	23	3	26	8	18	0
Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare	167	43	210	48	161	1
Veprat penale kundër jetës dhe trupit	717	197	914	232	660	22
Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut	78	15	93	11	78	4
Veprat penale kundër të drejtave të votimit	121	34	155	57	98	0
Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës	6	0	6	3	3	0
Veprat penale kundër integritetit seksual	195	56	251	91	156	4
Veprat penale kundër martesës dhe familjes	18	15	33	8	25	0
Veprat penale kundër shëndetit publik	13	2	15	0	14	1
Veprat penale të narkotikëve	435	278	713	303	403	7
Krim i organizuar	57	6	63	7	55	1
Veprat penale kundër ekonomisë	206	50	256	109	142	5
Veprat penale kundër pasurisë	360	114	474	151	304	19
Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore	6	1	7	0	7	0
Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë	17	8	25	8	16	1
Veprat penale të armëve	369	210	579	303	117	159
Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik	44	7	51	20	31	0
Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike	19	8	27	7	20	0
Veprat penale kundër rendit publik	19	0	19	4	7	12
Veprat penale kundër detyrës zyrtare	263	156	419	150	269	0
Totali	3133	1203	4336	1520	2584	236

Tabela 1 – Numri i lëndëve sipas kapitujve të Kodit Penal të Republikës së Kosovës për vitin 2019.²⁵

²⁵ Sqarim: Veprat penale nga kategoritë e evidentuara me një numër shumë të vogël të rasteve janë vepra penale të cilat parimisht gjykohen nga Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, por që për shkaqe procedural, ka edhe raste përjashtuese kur një vepër e tillë gjykohej edhe në DKR.

Përpos ngarkesës më lëndë, IKD ka analizuar edhe dënimet që DKR-të e gjykatave themelore kanë shqiptuar gjatë vitit 2019.

Sikurse edhe në vitin 2018, kur DKR-të kanë shqiptuar më së shumti dënime me burgim efektiv, përkatësisht dënime me burgim efektiv janë shqiptuar në gjithsej 483 raste, edhe në vitin 2019 rezulton përafërsisht numër i njëjti i këtij lloji të dënimit. Përkatësisht, DKR-të e GjTh-ve gjatë vitit 2019 kanë shqiptuar gjithsej 487 dënime me burgim efektiv.

Mirëpo për dallim nga viti 2018 kur DKR-të pas dënimit me burgim efektiv kanë shqiptuar dënime me kusht në gjithsej 407 raste, ndërsa dënime me gjobë në 327 raste, në vitin 2019, rezulton se DKR-të gjatë vitit 2019 viti kanë shqiptuar më shumë dënime me gjobë se sa dënime me kusht, përkatësisht 311 dënime me gjobë dhe 245 dënime me kusht.

Në vitin 2018 janë shqiptuar 152 aktgjykime liruese, derisa në vitin 2019 rezulton se është ulur numri i aktgjykimeve liruese pasi këtë vit gjykatat në 121 raste kanë shqiptuar këtë lloj të aktgjykimit. Mirëpo, gjatë vitit 2019 rezulton se është rritur numri i aktgjykimeve refuzuese në 195 raste, pasi në vitin 2018 DKR-të e Gjykatave Themelore kishin shqiptuar 150 aktgjykime refuzuese.

Në anën tjetër, pavarësisht pse dukuria e parashkrimit çdoherë ka qenë dukuri shqetësuese, sipas këtyre të dhënave rezulton se në vitin 2019 ka më pak raste të parashkruara se në vitin 2018.

Sipas statistikave zyrtare të KGJK-së, gjatë vitit 2018 ishin parashkruar gjithsej 52 raste në DKR-të e shtatë Gjykatave Themelore (46 parashkrim absolut, 6 parashkrim relativ), derisa në vitin 2019 janë parashkruar 39 raste (21 parashkrim relativ, 18 parashkrim absolut) apo 13 raste më pak se në 2018.

Në këtë drejtim, IKD vlerëson se mbi këto të dhëna, KGJK duhet të adresojë këtë problem, duke mbajtur përgjegjës akterët relevant lidhur me këtë dukuri dhe duke ndërmarrë masa konkrete me qëllim të evitimit të kësaj dukurie. Për më tepër, në të kaluarën ka pasur akuza nga vetë KGJK se çështja e parashkrimit është një “patate e nxehtë” që sistemi prokurorial ia “lë në dorë” sistemit gjyqësor²⁶. Përkundër që pas këtyre kritikave ishte kërkuar që të trajtohet kjo çështje, ky trajtim nuk është bërë asnjëherë.

Për dallim nga viti 2018, ku në numër më të madh të lëndëve të parashkruara kishte prirë kategoria e veprave penale kundër ekonomisë me gjithsej 22 lëndë të parashkruara për një vit (20 me parashkrim absolut dhe 2 relativ), në vitin 2019, nga 10 raste janë parashkruar nga kategoria e narkotikëve (3 absolut, 7 relativ) dhe kategoria e veprave penale kundër integritetit seksual (5 absolut dhe 4 relativ).

²⁶ "Kryesuesi i KGJK-së: Prokurorët po na e lënë në dorë "patatën e nxehtë"". Betimi për Drejtësi. 1 mars 2018. (<https://betimiperdrejtesi.com/kryesuesi-i-kgjk-se-prokuroret-po-na-e-lene-ne-dore-pataten-e-nxehte/>). (Qasur për herë të fundit më 17 shtator 2019). (Qasur për herë të fundit më 25 qershor 2020).

Edhe pse sistemi gjyqësor vazhdimisht deklarohet se i trajton me prioritet rastet e korrupsionit, IKD ka gjetur se edhe në vitin 2019 janë parashkruar shtatë (7) raste të korrupsionit, për dallim nga viti 2019 ku ishte parashkruar një lëndë më shumë, përkatësisht tetë (8) lëndë të korrupsionit.

Sa i përket veprave penale të korrupsionit të cilat janë parashkruar në vitin 2019, të gjitha kanë të bëjnë me parashkrim absolut të ndjekjes penale.

Kryesuesi i KGJK-së, Skender Çoçaj, në një përgjigje për IKD-në lidhur me këtë raport, ka thënë se *“KGJK vazhdimisht është duke u angazhuar që asnjë lëndë të mos parashkruhet”*²⁷.

Më poshtë, IKD ka paraqitur në mënyrë të detajuar mënyrën e zgjidhjes së rasteve sipas kategorive të veprave penale.

²⁷ Përgjigje e Kryesuesit të KGJK-së Skender Çoçaj, për IKD. 2 nëntor 2020.

Veprat penale sipas kapitullit të Kodit Penal	Dënim me kusht	Dënim me kusht	Dënim me kusht	Dënim tjerë	Aktgjykim i lirë	Aktgjykim i kusht	Është zgjidhur në kusht	Parashikim absolut	Parashikim relativ
Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Rep. së KS	4	0	1	0	2	0	1	0	0
Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare	17	6	7	1	7	5	5	0	0
Veprat penale kundër jetës dhe trupit	132	14	18	6	15	21	23	1	2
Veprat penale kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut	3	1	0	1	0	3	3	0	0
Veprat penale kundër të drejtave të votimit	0	4	31	1	3	13	5	0	0
Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës	0	0	1	0	2	0	0	0	0
Veprat penale kundër integritetit seksual	27	5	9	2	16	21	2	5	4
Veprat penale kundër martesës dhe familjes	0	1	4	0	1	0	2	0	0
Veprat penale kundër shëndetit publik	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Veprat penale të narkotikëve	143	58	50	2	15	22	3	3	7
Krim i organizuar	2	1	1	1	0	1	0	0	1
Veprat penale kundër ekonomisë	13	18	18	3	4	44	5	0	4
Veprat penale kundër pasurisë	68	9	9	3	19	23	17	2	1
Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë	3	2	1	0	1	0	1	0	0
Veprat penale të armëve	36	156	65	10	8	10	17	0	1
Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik	7	0	2	0	0	11	0	0	0
Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike	1	2	1	0	0	2	0	0	1
Veprat penale kundër rendit publik	1	2	0	0	0	1	0	0	0
Veprat penale kundër detyrës zyrtare	30	32	27	2	28	18	6	7	0
Totali	487	311	245	32	121	195	90	18	21

Tabela 2 - Dënimet e shqiptuara sipas kapitujve të Kodit Penal të Republikës së Kosovës për vitin 2019.

4.4. Ngarkesa totale me lëndë e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës


Përveç ngarkesës së lëndë në sistemin gjyqësor, IKD ka analizuar edhe ngarkesën me lëndë në sistemin prokurorial të Republikës së Kosovës për vitet 2016, 2017, 2018 dhe 2019.

Prokuroritë Themelore gjatë vitit 2016 kanë pasur në punë 191,755 lëndë. Nga ky numër i lëndëve, 136.414 apo 66.64 % janë të trashëguara si lëndë të pazgjidhura nga vitet paraprake, ndërsa 55.641 ose 33.35 % lëndë janë pranuar në punë gjatë vitit 2016. Prokuroritë gjatë këtij viti, kanë zgjidhur 63.055 lëndë apo 33 %, ndërsa 128.700 ose 67 % e të gjitha lëndëve kanë mbetur pa u zgjidhur.

Prokuroritë Themelore gjatë vitit 2017 kanë pasur në punë 185.772 lëndë. Nga ky numër i lëndëve, 129.531 apo 66.64 % janë të trashëguara si lëndë të pazgjidhura nga vitet paraprake, ndërsa 56.241 ose 33.35 % janë pranuar në punë gjatë vitit 2017. Prokuroritë gjatë këtij viti, kanë zgjidhur 71.230 lëndë apo 38%, ndërsa 114.542 ose 62% e të gjitha lëndëve kanë mbetur pa u zgjidhur²⁸.

Prokuroritë Themelore gjatë vitit 2018 kanë pasur në punë 179,242 lëndë. Nga ky numër i lëndëve, 119.454 apo 66.64 % janë të trashëguara si lëndë të pazgjidhura nga vitet paraprake, ndërsa 59.788 ose 33.35 % janë pranuar në punë gjatë vitit 2018. Prokuroritë gjatë këtij viti, kanë zgjidhur 74.031 lëndë apo 41.31 %, ndërsa 105.211 ose 58.69 % e të gjitha lëndëve kanë mbetur pa u zgjidhur.

Ndërkaq, në vitin 2019, nga gjithsej 166,633 lëndë në punë, janë trashëguar 111,340 lëndë, janë pranuar 55,293, janë zgjidhur 79,675 apo 48% e lëndëve, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 86,958 lëndë apo 52% e tyre.



Grafika 4 – Krahësimi i numrit të lëndëve në punë me numrin e lëndëve të zgjidhura nga viti 2016 deri në vitin 2019.

Për dallim nga sistemi gjyqësor kur vërehet se vit pas viti kanë ulur numrin e lëndëve të kryera, kjo ndryshon në sistemin prokurorial, pasi vërehet se vit pas viti është rritur numri i lëndëve të zgjidhura, mirëpo për dallim nga sistemi gjyqësor, në sistemin prokurorial numri i lëndëve të pranuar ka qenë jo edhe shumë i lartë, përkatësisht Prokurori i Shtetit gjatë vitit 2016 ka

²⁸ Shënim: Mos përputhjet në statistika derivojnë nga raportet statistikore të KPK-së.

pranuar 55.641, gjatë vitit 2017 ka pranuar 56.241 lëndë, gjatë vitit 2018 ka pranuar 59.788 lëndë dhe gjatë vitit 2019 ka pranuar 55,293 lëndë.

4.5. Ngarkesa me lëndë në DKR të PTH gjatë viteve 2016, 2017, 2018 dhe 2019


DKR-të e Prokurorive Themelore në Republikën e Kosovës gjatë vitit 2016 kanë trashëguar nga viti paraprak 2.208 lëndë, i kanë pranuar 1.910 lëndë të reja, ndërsa gjithsej kanë pasur në punë 4.118 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 2.188 apo 53% të lëndëve, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura edhe 1,930 apo 47% e tyre.

DKR-të e Prokurorive Themelore në Republikën e Kosovës, gjatë vitit 2017, kanë trashëguar nga viti paraprak 2.974 lëndë, i kanë pranuar 1.834 lëndë të reja, ndërsa gjithsej kanë pasur në punë 4.808 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 2.620 apo 54% të lëndëve, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura edhe 2,188 apo 46% e tyre.

Ndërsa, sipas raporteve statistikore të KPK-së, DKR-të e Prokurorive Themelore në Republikën e Kosovës, gjatë vitit 2018, kanë trashëguar nga viti paraprak 11.003 lëndë, i kanë pranuar 4.578 lëndë të reja, ndërsa gjithsej kanë pasur në punë 15.581 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 5.252 apo 34% të lëndëve, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura edhe 10,329 apo 66% e tyre.

Sipas të dhënave zyrtare të Prokurorit të Shtetit, në vitin 2019, DKR-të e Prokurorive Themelore nga viti 2019 kanë trashëguar 11,199 kanë pranuar 4,383 lëndë të reja, ndërsa gjithsej numri i lëndëve të ngarkuara është 15,582, prej të cilave i kanë zgjidhur 6,631 apo 43%, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 8,951 lëndë apo 57% e lëndëve.

Pra, në vitin 2016, prokurorët e DKR-ve kanë zgjidhur 53% të rasteve, në 2017 kanë zgjidhur 54%, pra kanë ngritur numrin e lëndëve të zgjidhura në 1%, në 2018 i kanë zgjidhur 34% të lëndëve, pra kanë ulur dukshëm përqindjen e lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve në punë, ndërsa në vitin 2019 kanë zgjidhur 57% të lëndëve, duke shënuar rritje të përqindjes së numrit të lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve në punë.



Grafika 5 – Përqindja e lëndëve të zgjidhura në DKR-të e PTh nga viti 2016 deri 2019.


Sipas këtyre të dhënave nga viti në vit paraqitet një disbalancë e madhe në përqindjen e zgjidhjes së lëndëve. Kjo pasi në vitin 2016 rezulton se janë zgjidhur 53% të lëndëve, në vitin

2017 vërehet rritje në 1% më shumë, mirëpo dallim të madh mes viteve 2016 dhe 2017 me vitin 2018 është se në këtë vit ka pasur ulje drastike të përqindjes së lëndëve të zgjidhura, pra rreth 20% më pak lëndë të zgjidhura. Ndërsa, në vitin 2019 vërehet se është balancuar numri i lëndëve të zgjidhura me vitet 2016 dhe 2017 duke shënuar numër të lëndëve të zgjidhura.

Por, me tepër se nga puna reale e prokurorëve në DKR-të e Prokurorive Themelore, problematikë sa i përket vitit 2018 shfaqet tek mënyra e paraqitjes së statistikave në raportet zyrtare statistikore të KPK-së. Kjo pasi përderisa në fund të vitit 2017 në këto raporte evidentohet 2,188 lëndë të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese, në vitin 2018 figurojnë 11.003 lëndë të trashëguara në viti 2017. Për këto mos përputhje, raportet statistikore të KPK-së nuk japin asnjë sqarim.

Në anën tjetër, nga këto të dhëna shihet se ndonëse prokurorët kanë arritur që gjatë katër viteve me radhë të zgjidhin lëndë më shumë se sa që kanë pranuar, shqetësuese vazhdon të mbetet numri i lëndëve që trashëgohen vit pas viti në DKR-të e Prokurorive Themelore, dhe qasja e sistemit prokurorial përkitazi me këto lëndë.

Përpos numrit të lëndëve të DKR-ve në të gjitha prokuroritë themelore, IKD në tabelën më poshtë ka analizuar edhe ngarkesën e secilit DKR në 7 (shtatë) prokuroritë themelore dhe ka pasqyruar punën e secilit Departament gjatë katër viteve (2016, 2017, 2018, 2019):



Grafika 6 – Krahasimi i numrit të lëndëve të zgjidhura në DKR-të e prokurorive themelore gjatë viteve 2016, 2017, 2018 dhe 2019.

DKR i PTh në Prishtinë – Sipas raporteve vjetore të Prokurorit të Shtetit përgjatë katër viteve, vërehet se DKR i PTh në Prishtinë në vitin 2016 ka zgjidhur 1,371 lëndë apo 52% të lëndëve më të cilat ka qenë e ngarkuar, ndërsa në vitin 2017 janë zgjidhur 50% e lëndëve, që do të thotë se DKR-të kanë ulur numrin e lëndëve të zgjidhura në 2%, apo 367 lëndë më pak të zgjidhura se në vitin 2016. E njëjta gjë vlen edhe për vitin 2018, ku nga gjithsej 1,570 lëndë në punë, janë zgjidhur 42% e lëndëve, pra prokurorët e DKR-ve kanë zgjidhur 349 lëndë më pak se në vitin 2017. Ndërsa në vitin 2019, janë zgjidhur 45% e lëndëve, që do të thotë se është rritur në 3% numri i lëndëve të zgjidhura. Mirëpo, nëse llogaritet se në vitin 2018 janë zgjidhur 2,697 lëndë, ndërsa në vitin 2019 janë zgjidhur 5,966 lëndë, do të thotë se në vitin e fundit prokurorët e DKR-ve kanë zgjidhur 2,042 lëndë më shumë se në vitin 2018.

DKR i PTh në Gjiilan – Në vitin 2016, nga gjithsej 410 lëndë në punë, janë zgjidhur 359 lëndë, apo 88% e lëndëve, në vitin 2017 nga gjithsej 367 lëndë në punë DKR i PTh në Gjiilan ka kanë zgjidhur 343 apo 93% e lëndëve, në vitin 2018, nga 346 lëndë në punë prokurorët e DKR në këtë prokurori i kanë zgjidhur 319 lëndë apo 92%, ndërsa në vitin 2019 nga 767 lëndë në punë, i kanë zgjidhur 541 apo 71% të lëndëve.

DKR i PTh në Prizren – Në vitin 2016, nga 530 lëndë në punë, janë zgjidhur 400 prej tyre apo 75% e lëndëve, në 2017, nga 398 lëndë në punë, prokurorët e DKR në PTh në Prizren i kanë zgjidhur 293 apo 74% të lëndëve, pra 1% më pak se në vitin 2016, në vitin 2018, nga 342 lëndë në punë, i kanë zgjidhur 247 lëndë apo 72%, përkatësisht 2% më pak se vitin e kaluar, ndërsa në vitin 2019, i kanë zgjidhur 1,449 lëndë apo 40% të lëndëve, që do të thotë se gjatë vitit 2019 ka numër më të madh të lëndëve në punë, prandaj edhe ka ulje të përqindjes së numrit të lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve të pazgjidhura, ndonëse si i vetëm, numri i lëndëve të zgjidhura është ngritur.

DKR i PTh në Mitrovicë – Në vitin 2016, nga 1290 lëndë në punë, prokurorët e DKR në Mitrovicë i kanë zgjidhur 424 apo 33% të lëndëve, ndërsa në vitin 2017 nga gjithsej 1020 lëndë i kanë zgjidhur 306 apo 30% të lëndëve, pra 3% më pak se në vitin 2016. Në vitin 2018, nga 961 lëndë në punë, i kanë zgjidhur 401 apo 42% të lëndëve, pra ka pasur rritje të përqindjes së lëndëve të zgjidhura në 12%. Ndërkaq në vitin 2019, është trefishuar numri i lëndëve në punë, ashtu që nga gjithsej 3,518 lëndë në punë, prokurorët e DKR të kësaj prokurorie kanë zgjidhur 32% të lëndëve.

DKR i PTh në Gjakovë – Në vitin 2016, prokurorët e DKR në Gjakovë kanë pasur në punë 365 lëndë, ndërsa i kanë zgjidhur 222 apo 61% të lëndëve, në vitin 2017, i kanë pasur në punë 282, ndërsa i kanë zgjidhur 176 apo 62%, pra ka pasur rritje të numrit të lëndëve të zgjidhura për 1%. Në vitin 2018 nga 219 lëndë në punë i kanë zgjidhur 122 apo 56% të lëndëve, ndërsa në vitin 2019, nga 1,496 lëndë në punë, i kanë zgjidhur 514 apo 34% të lëndëve.

DKR i PTh në Pejë – Në vitin 2016 prokurorët e DKR në Pejë kanë pasur në unë 554 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 433 apo 78% të lëndëve, në vitin 2017 i kanë pasur në punë 304, ndërsa i kanë zgjidhur 251 apo 83%, në 2018 nga gjithsej 234 lëndë i kanë zgjidhur 163 apo 70% të lëndëve, duke e ulur numrin e lëndëve të zgjidhura në 7%, ndërsa në vitin 2019, është

rritur edhe numri i lëndëve në punë në gjithsej 868 lëndë prej të cilave prokurorët e DKR në Pejë i kanë zgjidhur 597 apo 69% të lëndëve, duke e ulur numrin e lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve të pazgjidhura për 1%.

DKR i PTh në Ferizaj – Në vitin 2016, DKR i PTh në Ferizaj ka pasur në punë 416 lëndë ndërsa i prokurorët e këtij departamenti i kanë zgjidhur 244 apo 59% të lëndëve. Në vitin 2017 nga gjithsej 444 lëndë të njëjtit i kanë zgjidhur 247 apo 56%, duke e ulur në 3% numrin e lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve të pazgjidhura. Në vitin 2018, nga 446 lëndë në punë prokurorët e këtij departamenti i kanë zgjidhur 281 apo 63%, ndërsa në vitin 2019 nga 1,518 lëndë në punë i kanë zgjidhur 558 apo 37%, që nënkupton se është ulur përqindja e numrit të lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve të pazgjidhura për 26%.

Kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, ka thënë se numri i lëndëve të zgjidhura në DKR të PTh-ve është rritur vazhdimisht, duke shtuar se shumica e DKR-ve të PTh-ve kanë tejkaluar numrin e lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve të pranuar.

"Mund të konstatojmë se numri i lëndëve të zgjidhura është rritur nga viti në vit, ndërsa shkalla e përqindjes së lëndëve të zgjidhura në vitin 2019 është rritur në krahasim me vitin 2018. Sa për informim, efikasiteti i punës së organeve të sistemit gjyqësor sipas standardeve/indikatoreve të CEPEJ – Këshilli i Evropës, matet me numrin lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve të pranuar, e jo me numrin lëndëve të bartura (backlog) ndër vite. Pothuajse të gjitha DKR-të e prokurorive themelore, kanë tejkaluar në shkallë të lartë (disa prej tyre edhe dyfishim) numrin e lëndëve të pranuar, duke zgjidhur numër mjaftë më të lartë të lëndëve se sa kanë pranuar gjatë viteve përkatëse, ndërsa në rastet e pakta kur prokuroritë nuk kanë arritur të tejkalojnë këtë numër mund të kenë qenë faktor të ndryshëm, përfshirë këtu edhe lëvizjet potenciale të prokurorëve, mund të jenë lëndët të cilat kanë probleme procedurale, si pezullimi apo ndonjë faktorë tjetër" ka deklaruar Hyseni²⁹.

Me këtë rast, IKD rikujton se pa marrë parasysh përqindjen e zgjidhjes së lëndëve në raport me numrin e lëndëve të pranuar, sistemi prokurorial dhe gjyqësor duhet ti japin përgjigje lëndëve të vjetra, të cilat barten vit pas viti, në mënyrë që kjo ngarkesë të bie, dhe lëndët e reja të procedohen brenda një afati të arsyeshëm.

4.6. Ngarkesa më lëndë në DKR-të e PTh sipas kategorive të veprave penale

Për dallim nga sistemi gjyqësor që çdo vit përpos raportit vjetor mbi punën e gjykatave, publikon edhe një raport të veçantë mbi punën e DKR-ve sipas kategorive të veprave penale, në raportin vjetor të Prokurorit të Shtetit, paraqiten vetëm 6 kategori të veprave penale: kategoritë e veprave penale të terrorizmit, krimeve të luftës, korrupsionit dhe krimeve ekonomike si dhe trafikimit me qenie njerëzore.

²⁹ Përgjigje e Kryesuesit të KPK-së, Bahri Hyseni, për IKD. 21 qershor 2020.

Në lidhje me kategorinë e veprave penale të terrorizmit, PSh gjatë vitit 2019 ka pranuar 16 raste me 25 persona, si dhe 8 raste në regjistrin PPN (lëndë të ndryshme), prej të cilave i ka zgjidhur 26 raste me 37 persona. (ndaj 26 personave është ngritur aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve, ndaj 2 personave është hudhur kallëzimi penal dhe ndaj 9 personave janë pushuar hetimet).

Për veprat penale të krimeve të luftës, PSh gjatë vitit 2019 ka trashëguar 942 lëndë nga viti 2018, derisa ka pranuar në punë 346 raste të reja, ndërsa ka zgjidhur 122 raste (ndaj katër (4) personave ka ngritur aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve, ndaj dy (2) personave ka bërë bashkim të procedurës, ndaj 18 personave ka deleguar në kompetencë dhe ndaj tre (3) personave ka pushuar hetimet).

Sa i përket veprave penale nga kapitulli i korrupsionit, nga regjistri “PP”, Prokuroritë Themelore kanë pranuar në punë 419 kallëzime penale ndaj 896 personave, prej të cilave i kanë zgjidhur 400 raste ndaj 771 personave, ndërsa nga regjistri “PPN”, PTh-të gjatë vitit 2019 kanë pranuar në punë 482 lëndë me 914 persona, apo kanë zgjidhur 563 lëndë me 967 persona.

Sa i përket veprave penale të krimeve ekonomike nga regjistri “PP”, sipas këtij raporti, PSh gjatë vitit 2019 kanë pranuar në punë 502 lëndë me 736 persona prej të cilave i kanë zgjidhur 532 apo ndaj 712 personave, ndërsa nga regjistri “PPN”, sipas këtij raporti, PSh gjatë vitit 2019 kanë pranuar në punë 379 lëndë me 414 persona, ndërsa i kanë zgjidhur 337 lëndë me 50 persona.

Lidhur me veprat penale të trafikimit me qenie njerëzore, PSh gjatë vitit 2019 ka pasur në punë gjithsej 126 raste me 222 persona, prej të cilave i kanë zgjidhur 37 raste me 58 persona, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura edhe 89 raste me 164.

5. Performanca e individuale e gjykatësve dhe prokurorëve në DKR

Në vijim, IKD ka analizuar performancën individuale të gjyqtarëve dhe prokurorëve gjatë vitit 2019.

5.1. Performanca e gjykatësve në DKR

Sipas rregullores për caktimin e normave të punës së gjyqtarëve, e miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) më 14 shtator 2011, norma mujore e një gjyqtari në Departamentin e Krimeve të Rënda është 3, ndërsa norma vjetore 31.

Për dallim nga viti 2018, që KGJK ka publikuar raportin statistikor për punën e gjyqtarëve, në vitin 2019, KGJK ka përparuar duke lansuar një platformë në faqen zyrtare të KGJK-së, në të cilën figuron lista e secilit gjykatës se sa lëndë ka përfunduar gjatë këtij viti. Kjo platformë është quajtur nga KGJK “*Pasqyra e performancës*”³⁰.

Në tabelën në vijim, vërehet një disbalancë e madhe mes lëndëve të përfunduar nga një gjykatës i DKR-së brenda një viti, pasi ka gjykatës që brenda vitit ka përfunduar 102 lëndë apo 71 më shumë se sa norma vjetore prej 31 lëndësh, mirëpo ka gjykatës që ka përfunduar lëndë aq sa normal vjetore e përcaktuar. Gjatë vitit 2019, një gjykatës i Krimeve të Rënda në GjTh në Mitrovicë, del që ka përfunduar brenda vitit 102 lëndë apo 71 më shumë se sa norma mujore, mirëpo në tabelë vërehet se ka edhe gjykatës të tjerë që kanë përfunduar dyfish më pak lëndë. Sidoqoftë, të gjithë gjyqtarët që figurojnë në tabelën si më poshtë, kanë arritur të përmbushin normën vjetore të zgjidhjes së lëndëve, të përcaktuar nga KGJK.

³⁰ Pasqyra e Performancës. KGJK. (Shih linkun <https://www.gjyqesori-rks.org/pasqyra-e-performances/>). (Qasur për herët të fundit më 29 qershor 2020).

Gjykatësi	Gjykata	Numri i lëndëve të zgjidhura gjatë vitit 2019	Norma vjetore 31 lëndë
Радослав Марковић	Mitrovicë	102	+71
Violeta Namani	Prishtinë	91	+60
Isuf Makolli	Prishtinë	83	+52
Suzana Çerkini	Prishtinë	77	+46
Синиша Мандушић	Mitrovicë	67	+36
Sahit Krasniqi	Ferizaj	65	+34
Naser Foniqi	Prishtinë	62	+31
Shpresaj Hasaj-Hyseni	Prishtinë	60	+29
Vesel Ismaili	Prishtinë	59	+28
Ibrahim Idrizi	Ferizaj	56	+25
Naser Maliqi	Gjilan	54	+23
Naime Krasniqi-Jashanica	Prishtinë	50	+19
Nushe Kukaj-Mekaj	Prishtinë	50	+19
Agim Ademi	Gjilan	47	+16
Zyhdi Haziri	Gjilan	47	+16
Beqir Kalludra	Prishtinë	44	+13
Aziz Shaqiri	Gjilan	44	+13
Lutfi Shala	Prishtinë	42	+11
Томислав Петровић	Mitrovicë	41	+10
Avni Mehmeti	Mitrovicë	38	+7
Mustaf Tahiri ³¹	Ferizaj	36	+5
Beqir Halili	Mitrovicë	35	+4
Sylë Lokaj	Pejë	35	+4
Ajser Skenderi	Prizren	35	+4
Shadije Gërguri	Prishtinë	34	+3
Shashivar Hoti	Prishtinë	34	+3
Valbona Musliu-Selimaj	Prishtinë	32	+1

Tabela 3 – Lista e gjykatësve të DKR-ve që kanë zgjidhur lëndë më shumë se norma vjetore gjatë vitit 2019.

Në anën tjetër, sipas të dhënave të paraqitura në “Pasqyrën e Performancës”, sipas të cilave të dhëna është ndërtuar edhe tabela në vijim, është një numër i konsiderueshëm i gjyqtarëve të cilët gjatë vitit 2019 nuk kanë arritur të përmbushin normën e zgjidhjes së lëndëve të përcaktuar nga KGJK.

³¹ Shënim: Gjykatësi Mustaf Tahiri përfshihet në dy tabelat, për shkak se nga GjTh në Prishtinë është transferuar në GjTh në Ferizaj.

Gjykatësi	Gjykata	Numri i lëndëve të përfunduara gjatë vitit 2019	Norma vjetore 31 lëndë
Shaqir Zika	Gjakovë	29	-2
Raima Elezi	Prizren	27	-4
Xheladin Osmani	Prizren	27	-4
Hamdi Ibrahim	Prishtinë	26	-5
Lumturije Muhaxheri	Pejë	26	-5
Artan Sejrani	Prizren	26	-5
Musa Konxheli	Ferizaj	21	-10
Sami Sharaxhiu	Pejë	20	-11
Kadrije Goga-Lubishtani	Ferizaj	19	-12
Hysnije Gashi	Ferizaj	17	-14
Gëzim Pozhegu	Gjakovë	17	-14
Nikollë Komani³²	Gjakovë	17	-14
Sali Berisha	Pejë	16	-15
Burim Ademi	Mitrovicë	15	-16
Mustaf Tahiri	Prishtinë	11	-20
Pranvera Ademi	Mitrovicë	10	-21
Sahit Boroci	Gjilan	9	-22
Ramiz Azizi	Gjilan	8	-23
НИКОЛА КАБАШИЋ	Mitrovicë	7	-24
Besarta Doli	Gjakovë	7	-24
Kymete Kicaj	Prizren	6	-25
Bashkim Hyseni	Ferizaj	6	-25
Skender Çocaj	Prizren	5	-26
Violeta Husaj-Rugova	Pejë	4	-27
Mentor Bajraktari	Gjakovë	4	-27
Arben Hoti	Prishtinë	3	-28
Kreshnik Radoniqi	Pejë	2	-29
ГОРДАНА ВИРИЈЕВИЋ	Mitrovicë	1	-30
Behar Ymeri	Gjilan	1	-30

Tabela 4 – Lista e gjykatësve të DKR-ve që kanë zgjidhur lëndë nën normën vjetore gjatë vitit 2019³³.

³² Shënim: Nga data 1 korrik 2019, gjyqtari Nikollë Komani, është caktuar ushtrues detyre i Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjakovë nga KGJK.

³³ Shënim: Në këtë listë nuk mund të përfshihen të dhëna të sakta, për shkak se disa gjykatës nuk kanë punuar në DKR gjatë gjithë vitit 2019 dhe ka prej tyre që janë transferuar në departamente të tjera. Në qershor 2019 KGJK kishte emëruar gjykatësit e Departamentit Special në GjTh dhe në Gjykatën e Apelit. Për DS janë emëruar: Valbona Musliu-Selimaj, Valon Kurtaj, Arben Hoti, Albina Shabani-Rama, Musa Kongjeli dhe Shadije Gërguri, ndërsa në DS të Gjykatës së Apelit janë emëruar: Kreshnik Radoniqi, Valon Durguti dhe Burim Ademi. Këta gjykatës punën e tyre në këto departamente e kanë filluar me 1 korrik 2019, që do të thotë në gjashtëmuorin e parë të vitit 2019 kishin punuar në departamente të tjera. Po ashtu, KGJK, kishte caktuar si ushtrues detyre të Kryetarit të GjTh në Pejë z. Sami Sharraxhiu, gjyqtar, nënkryetar i Gjykatës, ndërsa në Gjykatën Themelore në Gjakovë, ushtrues detyre të Kryetarit të Gjykatës caktoi z. Nikollë Komani, gjyqtar, nënkryetar i Gjykatës. Po

Duke marrë për bazë këto statistika, vihet re një diferencë e madhe e numrit të lëndëve të kryera nga gjykatësit në Departamentin e Krimeve të Rënda. Një dukuri e tillë ishte evidentuar edhe në raportin e publikuar nga IKD me titull *“Krimet e Rënda në Kosovë Ligji vs Praktika për periudhën 1 janar 2018 dhe 31 qershor 2019”*³⁴.

Pra, sipas këtyre të dhënave, vërehet një disbalancë e madh në numrin e lëndëve të zgjidhura nga gjyqtarët, e cila disbalancë paraqitet në dy drejtime. Fillimisht, ka disbalancë të madhe në numrin e lëndëve të zgjidhura nga gjyqtarët të cilët veç se e kanë arritur normën vjetore, derisa ky disbalancë është edhe më i theksuar sa i përket gjyqtarëve që kanë arritur normën dhe gjyqtarëve që nuk kanë arritur normën e zgjidhjes së lëndëve të përcaktuar nga KGJK.

Edhe lidhur me këtë gjetje të IKD-së, Kryesuesi i KGJK-së, Skender Çoçaj, ka thënë se *“Natyra e lëndëve në Departamentin e Krimeve të Rënda është nga më të ndryshmet, ka lëndë që janë mjaft komplekse dhe zgjasin shumë, por ka lëndë që mund të kryhen më shpejtë. Po ashtu, ndryshimet legjislative pas hyrjes në fuqi të Kodit Penal të ri, ka mundur të ndikoj në këto statistika”*³⁵.

Po ashtu, Kryesuesi Çoçaj ka thënë norma e gjyqtarëve merret parasysh nga KGJK me rastin e vlerësimit të performancës së gjyqtarëve³⁶.

Në vijim, IKD ka analizuar edhe numrin e lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e gjyqtarëve në të gjitha DKR-të e Gjykatave. Kjo analizë është bërë për vitet 2016-2019.



Grafika 7 – Numri i lëndëve të zgjidhura gjatë katër viteve, krahasuar me numrin e gjykatësve.

ashtu, në mesin e këtyre Gjyqtarëve bënë pjesë edhe Gjyqtari Skender Cocaj, i cili më 14 shkurt 2019, është zgjedhur kryesues i KGJK-së, për të cilën arsye ka pezulluar detyrën e gjyqtarit. Ndërsa, në shtator 2019, Gjyqtari i DKR në Pejë, Sali Berisha, është arrestuar, për të cilën arsye KGJK ka pezulluar të njëjtin nga detyra. Po ashtu, Gjyqtari Bashkim Hyseni është Kryetar i Gjykatës Themelore në Ferizaj.

³⁴ Pergega Sabina, Shahini-Grajçevci Valentina. *“Krimet e Rënda në Kosovë, ligji VS praktika”*. IKD. Shtator 2019. (Shih linkun https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Raporti-p%C3%ABr-Krimet-e-R%C3%ABnda_21.09.201-FINAL-1-1.pdf). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

³⁵ Përgjigje e Kryesuesit të KGJK-së Skender Çoçaj, për IKD. 2 nëntor 2020.

³⁶ Po aty.

Në vitin 2016, numri i gjyqtarëve në të gjitha DKR-të e Gjykatave ka qenë 42, derisa numri i lëndëve të zgjidhura ka qenë 2841, që do të thotë se secili gjykatës i DKR-së duke u bazuar në numrin e lëndëve të zgjidhura brenda këtij viti, ka zgjidhur mesatarisht nga 67.64 lëndë.

Në vitin 2017, numri i gjyqtarëve në DKR është ngritur për dy (2) gjyqtarë, derisa janë zgjidhur 911 lëndë më pak, që do të thotë se secili gjykatës ka zgjidhur mesatarisht nga 43.86 lëndë, apo secili prej tyre ka zgjidhur mesatarisht 24 lëndë më pak se në vitin 2016.

Në vitin 2018, numri i gjyqtarëve në DKR-të e gjykatave është ngritur edhe për gjashtë (6) gjyqtarë, mirëpo edhe gjatë këtij viti rezulton se është ulur numri i lëndëve të zgjidhura edhe pse është rritur numri i gjykatësve, që do të thotë se gjykatësit e DKR-ve gjatë 2018-tës kanë zgjidhur mesatarisht nga 36.2 lëndë në vit. Pra, përforsimi i këtij departamenti me 8 gjyqtarë të rinjë, “ka ndikuar” që të kemi ulje të numrit të lëndëve të zgjidhura, edhe pse do të ishte dashur të ndodhte e kundërta, pra të kemi rritje të numrit të lëndëve të zgjidhura.

Në vitin 2019, është ngritur për një (1) numri i gjykatësve në DKR-të e gjykatave themelore, mirëpo prapë ka pasur ulje të numrit të lëndëve të zgjidhura në krahasim me vitin 2018. Nga kjo rezulton se në vitin 2019 edhe pse është rritur numri i gjykatësve nga 50 në 51, kemi 180 lëndë më pak të zgjidhura se në vitin 2018.

Pra, nëse gjykatësit e DKR-ve do të vazhdonin me tempon e njëjtë si në vitin 2016, atëherë do të shumëfishohej numri i lëndëve të zgjidhura vit pas viti dhe do të ulej dukshëm numri i lëndëve të trashëguara. Por, përderisa përpjekja e sistemit gjyqësor ka qenë të ngritet numri i lëndëve të zgjidhura përmes ngritjes së numrit të gjyqtarëve, paradoksalisht ka ndodhur e kundërta.

5.2. Mënyra e zgjidhjes së lëndëve në DKR të Gjykatave Themelore gjatë vitit 2019

Gjatë vitit 2019, gjykatësit e DKR-vë të gjykatave themelore kanë zgjidhur gjithsej 1,630 lëndë.

Dënimi më i shpeshtë që DKR kanë shqiptuar gjatë këtij viti ka qenë dënimi me burgim efektiv (498 raste), pastaj radhitet dënimi më gjobë (319 raste) dhe dënimi me kusht (252 raste).

Ndërsa, për dallim nga viti 2018, vërehet se gjatë vitit 2019, DKR-të e GjTh-ve pas dënimit me burgim efektiv, kanë shqiptuar më shumë dënime me gjobë se sa dënime me kusht pasi në vitin 2018 ka qenë e kundërta, më shumë dënime me kusht se sa me gjobë.

Gjatë vitit 2019, DKR-të në 128 raste kanë shpallur aktgjykime liruese dhe në 244 raste aktgjykime refuzuese, ndërsa në vitin 2018, kanë shpallur 160 aktgjykime liruese, ndërsa 186 aktgjykime refuzuese.

Burgim efektiv	Dënim me gjobë	Dënim me kusht	Aktgjykim lirues	Aktgjykim refuzues
498	319	252	128	244

Tabela 5 – Llojet e dënimeve më të shpeshta të shpallura nga gjykatësit e DKR-ve gjatë vitit 2019.

5.3. Performanca e prokurorëve në DKR

Për dallim nga KGJK e cila në vitin 2018 kishte publikuar raportin vjetor mbi performancën individuale për secilin gjyqtar, KPK këtë nuk e ka bërë as në vitin 2018 e as në 2019, duke treguar mos transparencë dhe duke mos i dhënë qasje publikut në performancën individuale të secilit prokuror.

Për këtë arsye, si në rastin e sistemit gjyqësor, edhe në rastin e sistemit prokurorial IKD ka analizuar dhe krahasuar numrin e lëndëve të zgjidhura ndër vite në raport me numrin e prokurorëve.



Grafika 8 - Numri i lëndëve të zgjidhura gjatë katër viteve, krahasuar me numrin e prokurorëve.

Sipas këtyre të dhënave, në vitin 2016, 44 prokurorët e DKR-ve i kanë zgjidhur mesatarisht nga 49,7 lëndë në vit, ndërsa në vitin 2017, 39 prokurorët e DKR-ve kanë zgjidhur 2,620 lëndë, apo mesatarisht nga 67 lëndë në vit, përkatësisht nga 18 lëndë më shumë se në vitin 2016.

Në vitin 2018, është ngritur numri i lëndëve të zgjidhura, në të cilin vit prokurorët e DKR-ve të PTh-ve kanë zgjidhur gjithsej 5,252 lëndë, edhe pse numri i prokurorëve rezulton se ka qenë më i ulët, përkatësisht një (1) më pak, pra 38 prokurorë. 38 prokurorët e këtyre departamenteve mesatarisht kanë zgjidhur nga 138 lëndë, apo nga 71 lëndë më shumë se në vitin 2017.

Në vitin 2019, 39 prokurorët e DKR-së i kanë zgjidhur 6,631 lëndë apo secili prej tyre ka zgjidhur mesatarisht nga 170 lëndë në vit, që nëse llogaritet me vitin 2018, vitin e fundit këta prokurorë kanë zgjidhur 32 lëndë më shumë.

Sipas udhëzimit administrativ, një prokuror i DKR-së brenda një muaji duhet të zgjidhë gjashtë (6) kallëzime penale, ndërsa brenda një vitit 66 kallëzime penale.

Sipas raportit vjetor të Prokurorit të Shtetit, prokurorët e DKR-ve gjatë vitit 2019 kanë zgjidhur mesatarisht nga 65.29 lëndë ose 2.71 lëndë nën normën e përcaktuara me udhëzim.

Sipas këtij raporti, rezulton se një prokuror i PTh në Mitrovicë ka zgjidhur më së shumti lëndë për një muaj, pra 10.11 lëndë në muaj, pas tyre radhitën prokurorët e PTh në Gjilan me 6.33 lëndë në muaj, prokurorët e PTh në Ferizaj me 8.12 lëndë, prokurorët e PTh në Gjakovë me 7.04 lëndë, ndërsa nën norën mujore radhiten prokurorët e PTh në Prizren me 5.14 lëndë në muaj, prokurorët e PTh në Prishtinë me 4.41 lëndë në muaj, si dhe prokurorët e PTh në Pejë me 3.4 lëndë në muaj.³⁷

Sipas kësaj, vërehet se disa prokurori nuk e kanë arritur minimumin e normës vjetore, prandaj sipas IKD-së, KPK duhet të kërkojë sqarime se cilat kanë qenë arsyet se përse kanë ardhur deri te kjo gjendje, për shkak se edhe në vitin 2018 ka qenë e njëjta gjendje e zgjidhjes së lëndëve ku disa prokurori kanë përmbushur normën, ndërsa disa prej tyre nuk e kanë përmbushur.

Për më tepër, KPK duhet të kërkojë llogaridhënie nga të gjithë prokurorët që nuk arrijnë të përmbushin normën vjetore të zgjidhjes së lëndëve. Kjo pasi që, veçanërisht, situata të tilla ndikojnë që përkundër numrit të mjaftueshëm të prokurorëve, mos të kemi shfrytëzim të këtyre kapaciteteve, dhe përballë progresit të kërkuar, të kemi regres në punën e sistemit prokurorial, i cili regres tërheq pas vetes probleme dhe shkelje të një pas njëshme.

Por, sipas Kryesuesit të KPK-së, Bahri Hyseni, mos përmbushja e normës ndikon në matjen e performancës së një prokurori me rastin e vlerësimit të performancës.


“Pothuajse të gjitha DKR-të e prokurorive themelore, kanë tejkaluar në shkallë të lartë (disa prej tyre edhe dyfishim) numrin e lëndëve të pranuar, duke zgjidhur numër mjaftë më të lartë të lëndëve se sa kanë pranuar gjatë viteve përkatëse, ndërsa në rastet e pakta kur prokuroritë nuk kanë arritur të tejkalojnë këtë numër mund të kenë qenë faktor të ndryshëm, përfshirë këtu edhe lëvizjet potenciale të prokurorëve, mund të jenë lëndët të cilat kanë probleme procedurale, si pezullimi apo ndonjë faktorë tjetër” thuhet në përgjigjen e Hysenit³⁸.

³⁷ “Raporti i punës për vitin 2019”. Prokurori i Shtetit. Shkurt 2020.

³⁸ Përgjigja e Kryesuesit të KPK-së, Bahri Hyseni, për IKD-në. 21 qershor 2020.

5.4. Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga DKR-të e Prokurorive Themelore gjatë vitit 2019

Sa i përket mënyrës së zgjidhjes sipas personave gjatë vitit 2019, mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga Prokurori i Shtetit është si në vinim: me aktakuzë të drejtpërdrejtë Prokurori i Shtetit ka përfunduar 53 ose 1,66% të personave, me kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor kanë përfunduar 5 ose 0,16% të personave, me hudhje të kallëzimit penal janë zgjidhur 666 ose 20,88% të personave. Ndërkaq, pas përfundimit të hetimeve, janë ngritur aktakuza ndaj 1,512 personave, ndaj 515 personave kanë pushuar hetimet, ndaj 5 personave është propozuar shqiptim i masave të trajtimit të detyrueshëm.



Grafika 9 - Mënyra e zgjidhjes së kallëzimeve penale në Departamentin e Krimeve të Rënda gjatë vitit 2018.

Në fund të vitit 2019 kanë mbetur të papërfunduara hetimet ndaj 521 personave, ndërsa janë parashtruar 772 kërkesa për caktim të paraburgimit, prej të cilave gjykatat i kanë aprovuar 495 apo 64% të këtyre kërkesave.

Aktgjykim fajësues	Urdhër ndërkimor	Masa të trajtimit të detyrueshëm	Hudhje	Refuzim	Lirim
1272	3	5	58	126	128

Tabela 6 – Vendimet gjyqësore përkitazi me aktet akuzuese të prokurorëve.

Sipas këtyre të dhënave, rezulton se 1,272 apo 79.90% e personave janë shpallur fajtor, përkatësisht janë dënuar me aktgjykim dënues, 128 persona janë liruar nga akuza, ndaj 126 personave është refuzuar aktakuza, ndaj 58 personave është hudhur aktakuza, ndaj 5 personave

është shqiptuar masa e trajtimit të detyrueshëm, ndërsa ndaj 3 personale është shqiptuar urdhër ndëshkimor.

Ndaj këtyre vendimeve, prokurorët e Departamentit të Krimeve të Rënda kanë parashtruar 358 ankesa nga të cilat 226 janë parashtruar vetëm për shkak të vendimit mbi dënimin. Lidhur me vendimet e Gjykatës së Apelit përkitazi me ankesat e prokurorëve, Raporti i Prokurorit të Shtetit nuk ofron të dhëna.


6. Ngarkesa më lëndë në DKR-të e Gjykatës së Apelit gjatë viteve 2016, 2017, 2018 dhe 2019

Departamenti i Krimeve të Rënda i Gjykatës së Apelit të Republikës e Kosovës, gjatë vitit 2016, ka trashëguar 173 lëndë nga viti paraprak, i ka pranuar 744 lëndë, derisa ka pasur në punë gjithsej 917 lëndë, prej të cilave i ka zgjidhur 727, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura 190. Pra, gjatë vitit 2016, DKR i GjA-së ka zgjidhur 79% të lëndëve në punë, derisa kanë mbetur të pazgjidhura edhe 21% të lëndëve.

Gjatë vitit 2017, DKR i GjA-së nga viti paraprak ka trashëguar 190 lëndë, ka pranuar 591 dhe gjithsej në punë ka pasur 781 lëndë, prej të cilave i ka zgjidhur 702, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura 79 lëndë. Në përqindje del se nga numri i lëndëve që kanë pasur në punë, DKR i GjA-së gjatë vitit 2017 ka zgjidhur 90 % të lëndëve, derisa kanë mbetur të pazgjidhura 10 % të lëndëve në punë.

Gjatë vitit 2018, DKR i GjA-së nga viti 2017 ka trashëguar 79 lëndë, i ka pranuar 636 lëndë të reja, ka pasur në punë 715 lëndë, i ka zgjidhur 623, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura 92 lëndë. Në përqindje del se nga numri i lëndëve që ka pasur në punë, DKR i GjA-së gjatë vitit 2018 ka zgjidhur 87% të lëndëve, derisa kanë mbetur të pazgjidhura 13% të lëndëve në punë.

Në vitin 2019, DKR i GjA-së ka trashëguar nga viti 2018, 92 lëndë, i kanë pranuar 660 lëndë të reja, nga të cilat i kanë pasur në punë gjithsej 752 lëndë, i kanë zgjidhur 652 lëndë ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 100 lëndë. Pra gjatë vitit 2019, DKR i GjA-së ka zgjidhur 87% të lëndëve, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura edhe 13%.



Grafika 10 – Lëndët e zgjidhura dhe të pazgjidhura nga DKR i GjA-së gjatë viteve 2016-2019.

Pra nga raportet statistikore të gjykatave vërehet se DKR i GjA-së, gjatë vitit 2017 ka pasur përqindjen me të lartë të lëndëve të zgjidhura me 90%, ndërsa përqindjen me të ulët vërehet se

e kanë pasur gjatë vitit 2016, me 79% të lëndëve. Ndërsa, gjatë viteve 2018 dhe 2019 vërehet se DKR i GjA-së ka pasur përqindje të lartë të numrit të lëndëve të zgjidhura, me ç' rast përqindja e numrit të lëndëve të pazgjidhura në raport me numrin e lëndëve në punë ka qenë vetëm 13%.

Pra, sipas këtyre të dhënave, vërehet se në vitin 2017 është rritur efikasiteti në zgjidhjen e lëndëve, mirëpo në vitet 2018 dhe 2019 krahasuar me vitin 2017 ka pasur ulje të numrit të lëndëve të zgjidhura krahasuar me numrin total të lëndëve, pasi kanë ulur përqindjen në 3% më pak lëndë të zgjidhura gjatë viteve 2018-2019 krahasuar me vitin 2017. Sidoqoftë, kjo ulje nuk ka ndikuar në destabilizimin me lëndë më DKR të GjA-së, pasi përkthyer me numër të lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese, diferenca nuk është e madhe.

6.1 Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga gjykatësit e DKR-ve të GjA-së gjatë periudhës 2016-2019

IKD përpos ngarkesë më lëndë dhe efikasitetin në zgjidhjen e lëndëve nga gjykatësit e DKR-ve të GjA-së ka analizuar edhe mënyrën e kryerjes së këtyre lëndëve nga këta gjykatës.

Sipas raporteve statistikore të gjykatave, rezulton se gjykatësit e Apelit në të shumtën e rasteve i vërtetojnë aktgjykimet e shkallës së parë, pasi nga gjithsej katër vite (2016, 2018, 2018, 2019), rezulton se këta gjykatës 1626 aktgjykime të shkallës së parë i kanë vërtetuar, ndërsa në 81 raste kanë hudhur si të pabazuara ankesat e parashtruara kundër aktgjykimit të shkallës së parë.

Në aktgjykimet e shkallës së parë, vërehet se gjykatësit e Apelit për periudhën 2016-2019 kanë shfuqizuar 464 aktgjykime të shkallës së parë, ku 212 prej tyre i kanë shfuqizuar për shkak të konstatimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, 249 prej tyre për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale, ndërsa për shkak të paraqitjes së provave dhe fakteve të reja vërehet se kanë shfuqizuar aktgjykimet në vetëm në 3 raste, të cilat raste kanë qenë gjatë vitit 2017, ndërsa gjatë viteve 2016, 2018 dhe 2019, vërehet se për këtë arsye gjykatësit e Apelit nuk kanë shfuqizuar asnjë aktgjykim.

Në raportet statistikore të gjykatave vërehet se gjykatësit e DKR të GjA-së, për katër vite kanë ndryshuar 534 aktgjykime të shkallës së parë. Nga ky numër vërehet se në 309 raste kanë zbutur dënimin që shkalla e parë ua kishte shqiptuar, në vetëm 125 raste kanë ashpërsuar këto dënime, për arsye të tjera i kanë ndryshuar 88 aktgjykime të shkallës së parë, ndërsa për shkak të shkeljes së ligjit penal i kanë ndryshuar 12 aktgjykime.

Gjatë këtyre katër viteve vërehet se gjykatësit e DKR të GjA-së dyfish më shumë kanë zbutur dënime të cilat i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë se sa që kanë ashpërsuar këto dënime.

			Është abroguar			Është ndryshuar			
	Ankesa është hudhur poshtë	Është vërtetuar	Për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendies faktike	Për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale	Për shkak të paraqitjes së provave dhe fakteve të reja	Për shkak të shkeljes së ligjit penal	Dënimi është ashpërsuar	Dënim i është zbutur	Për arsye të tjera
2016	20	442	85	10	0	12	35	105	18
2017	18	434	107	6	3	0	31	85	18
2018	29	367	20	86	0	0	18	75	28
2019	14	382	0	147	0	0	41	44	24
Total	81	1625	212	249	3	12	125	309	88

Tabela 7 - Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga gjykatësit e DKR-vë të GjA-së gjatë periudhës 2016-2019.

6.2 Performanca e gjykatësve të DKR-së së GjA-së gjatë vitit 2019

Në Departamentin për Krime të Rënda, gjatë viteve 2016 dhe 2017 kishin qenë të angazhuar nga tetë (8) gjyqtarë, ndërsa në vitin 2019 është ulur numri gjyqtarëve për një, pra numri i gjyqtarëve ka rënë në shtatë (7). Të njëjtit gjyqtar, punën e kanë zhvilluar në tri kolegje, ndërsa një gjyqtar nga Departamenti i Përgjithshëm, i kishte plotësuar kolegjet, por nuk është ngarkuar më lëndë të krimeve të rënda.

Gjatë viti 2016, tetë gjykatësit e DKR-ve të GjA-së kanë zgjidhur 727 lëndë apo 79% të lëndëve më të cilat kanë qenë të ngarkuar, që do të thotë se një gjykatës brenda një viti ka zgjidhur mesatarisht nga 90 lëndë.

Gjatë vitit 2017, tetë gjykatësit kanë zgjidhur 702 lëndë apo 90% e lëndëve më të cilat kanë qenë të ngarkuar, që do të thotë se brenda këtij viti një gjykatës ka zgjidhur mesatarisht nga 87 lëndë, pra nga tri (3) lëndë më pak se sa në vitin paraprak.

Gjatë vitit 2018, rezulton se në DKR janë zgjidhur 623 lëndë, që do të thotë shtatë (7) gjykatësit e DKR të GjA-së i kanë zgjidhur mesatarisht nga 89 lëndë, përkatësisht nga dy (2) lëndë më shumë se sa në vitin paraprak. .

Nga korriku 2019, ky departament ka mbetur me vetëm gjashtë gjyqtar, pasi një gjyqtare është dekretuar në Gjykatën Supreme. Gjatë vitit 2019, janë zgjidhur 652 lëndë, që do të thotë gjashtë gjykatësit (pa përfshirë gjykatësen që ka kaluar në Supreme), kanë zgjidhur mesatarisht nga 108 lëndë në vit.


7. Gjetjet e IKD-së në trajtimin e rasteve në Krime të Rënda

IKD tash e disa vite monitoron në mënyrë sistematike sistemin e drejtësisë, në të cilin monitorim përfshihen rastet e të gjitha natyrave, si penale, civile, administrative etj.

Në këtë raport, subjekt i hulumtimit dhe analizës janë rastet e trajtuara nga Departamentet për Krime të Rënda të monitoruara gjatë vitit 2019 nga hulumtuesit e IKD-së, të cilët gjatë këtij viti kanë monitoruar 2,228 seanca gjyqësore, ku përfshihen 806 raste me 1,870 persona të akuzuar.

Prej 1,870 personave të akuzuar, 1,720 i takojnë gjinisë mashkullore, derisa 114 i takojnë gjinisë femërore.


Prej 2,228 seancave të monitoruara, 1,680 seanca apo 75% të seancave janë mbajtur ndërsa 548 seanca apo 25% të seancave janë shtyrë për arsye të ndryshme.



Grafika 11 – Numri i seancave të monitoruara nga IKD në DKR të Gjykatave Themelore gjatë vitit 2019.

Bazuar në monitorimin sistematik të IKD-së në Departamentet e Krimeve të Rënda në të gjitha Gjykatat Themelore, rezulton se janë shpallur 579 aktgjykime, prej të cilave 423 kanë qenë aktgjykime dënuese, 118 liruese dhe 38 refuzuese.

Nga dënimet e shqiptuara nga DKR-të e Gjykatave Themelore gjatë vitit 2019, në rastet e monitoruara nga IKD, dënimi më i shpeshtë ka qenë dënimi me gjobë, ku 229 persona janë dënuar me gjobë, ndërsa me burgim efektiv një më pak, apo 228 dënime dhe dënime me kusht ndaj 138 personave.



Grafika 12: Llojet e dënimeve të shqiptuara gjatë vitit 2019.

Nga rastet e monitoruara në Departamentet për Krime të Rënda, IKD gjen se shqetësuese vazhdon të mbetet mos interesimi i Prokurorit të Shtetit që luftën ndaj kriminalitetit të përfshirë në këto raste ta orientoj edhe në fushën e konfiskimit të pasurisë së përfituar përmes veprës penale.

Në këtë drejtim, prej 806 rasteve të monitoruara gjatë vitit 2019, IKD gjen se Prokurori i shtetit kishte paraqitur kërkesë për sekuestrim në vetëm 68 raste, ndërsa në 738 raste nuk kishte paraqitur kërkesë.

IKD vlerëson se këto statistika të Prokurorit të Shtetit janë shqetësuese. Pa marrë parasysh rezultatin në vendimin përfundimtar, këto statistika tregojnë qasjen e Prokurorit të Shtetit në raport me konfiskimin e pasurisë së përfituar përmes veprës penale.

Përderisa kërkesë për konfiskim të pasurisë së përfituar me vepër penale nuk ka pasur në 738 aktakuzat e Prokurorit të Shtetit, kjo nënkupton se gjatë gjykimeve, prokurorët nuk janë marrë fare me konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale. Kjo pasi në mungesë të objektit, përkatësisht propozimit për konfiskim në aktakuzë, të njëjtit nuk kanë pasur se çfarë të mbrojnë gjatë gjykimeve.

Për këtë arsye, IKD i rikujton Prokurorit të Shtetit se njëra ndër fushat kryesore për luftimin e kriminalitetit, krahas shqiptimit të dënimeve kryesore, alternative dhe plotësuese, është konfiskimi i pasurisë së përfituar përmes veprës penale. Për më tepër, orientimi i luftimit të kriminalitetit në fushën e konfiskimit të pasurisë së përfituar në mënyrë të kundërligjshme është proklamuar dhe premtuar vazhdimisht, derisa gjetjet e IKD-së dështojnë një mos interesim të Prokurorit të Shtetit për këtë fushë.

Sa i përket konfiskimit të pasurisë së përfituar me vepër penale, më 10 janar 2019 ka hyrë në fuqi Ligji nr.06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë. Miratimi i këtij ligji ka pasuar dhe shfuqizuar Ligjin nr.04/L-140 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfituar me Vepër Penale.

Sipas këtij ligji, pasi një i pandehur shpallet fajtor për një vepër penale të përcaktuar në nenin 2 paragrafi 1 të këtij ligji, Prokurori i Shtetit, me një kërkesë të veçantë në gjykatën e cila e ka

nxjerrë aktgjykimin, mund të kërkoj verifikimin e pasurisë brenda periudhës pesë (5) vjeçare pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, siç është përcaktuar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Miratimi i këtij ligji ishte paraqitur vazhdimisht si histori suksese dhe si ligj i cili do të bëjë kthesën në sistemin e drejtësisë sa i përket konfiskimit të pasurisë së përfituar përmes veprës penale, derisa skepticizmi i vazhdueshëm i IKD-së ka qenë se edhe ky ligj nuk do të zbatohet në praktikë, ashtu siç nuk ishte zbatuar ligji paraprak.

Në këtë drejtim, mbi 17 muaj pas miratimit të këtij ligji, i njëjti është aplikuar vetëm në një rast nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, e cila e dhënë e pothuajse e klasifikon këtë ligj si të mirë në letër, por të pazbatuar në praktikë.

Në këtë mënyrë, mos paraqitja e kërkesave për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale në aktet akuzuese të Prokurorit të Shtetit dhe mos aplikimi i Ligji nr.06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë tregon mos interesimin e Prokurorit të Shtetit për luftimin e kriminalitetit përmes konfiskimit të pasurisë së përfituar përmes veprës penale.

Në anën tjetër, nga monitorimi sistematik i rasteve të trajtuara nga Departamentet për Krime të Rënda, IKD ka gjetur se në mbi 90% të rasteve, gjykatësit shkelin afatet ligjore për trajtimin e rasteve sipas Kodit të Procedurës Penale.

Në këtë drejtim, IKD gjen shkelje të të drejtave të personave në procedurë penale, të cilët nuk gjykohen në kohë të arsyeshme, e drejtë e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Përveç rasteve në të cilat procedohet me pranim të fajësisë apo marrëveshje për pranim të fajësisë, nga rastet e analizuara, qytetarët e Republikës së Kosovës në një proces gjyqësor qëndrojnë mbi tri (3) vite.

Në këtë kuptim, rast specifik është rasti “Çekiçi”, rast i cili deri më 31 dhjetor të vitit 2019, i ka mbushur 9 vite e 11 muaj në proces gjyqësor, ku gjatë kësaj kohe të pandehurit kanë qëndruar në paraburgim, duke ju shkelur kështu të drejtat e tyre të garantuara nga ligji. Pastaj, është rasti “Shega”, në të cilin rast nga ngritja e aktakuzës deri më 31 dhjetor kanë kaluar 6 vite e 9 muaj, rasti i vrasjes në Lipjan, ku kanë kaluar 9 vite e 2 muaj, rasti i Granit Elshanit dhe Nexhat Ademit ku kanë kaluar mbi 3 vite, rasti i terrorizmit i njohur si rasti “Badovci”, ku kanë kaluar 3 vite e 10 muaj deri në aktgjykimin përfundimtar. Po ashtu, rast i kësaj natyre është edhe rasti i vrasjes i njohur si “Bon Vivant”, ku kanë kaluar 4 vite, 5 muaj e 24 ditë, pastaj, rasti i Naser Pajazitajt ku kanë kaluar mbi 2 vite e gjashtë muaj dhe rasti i të akuzuarit për terrorizëm, Leonis Frangajt, ku kanë kaluar 3 vite, 10 muaj e 6 ditë.

Si pasojë e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore është edhe “ping-pongu”, mes gjykatës së shkallës së parë e të dytë, ku rastet vazhdimisht kthehen në rigjykim.

Se një praktikë e tillë e tejzgjatjes së procedura gjyqësorë është e dëmshme për të drejtat e të pandehurit e kishte konstatuar edhe GjEDNJ.

Kjo gjykatë në rastin “Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë”, në aktgjykimin e vitit 2013 kishte konstatuar shkelje të së drejtës për shkak të kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore.

Lidhur me këtë, GjEDNJ nënvizon se: *“Problemi kryesor në çështjen në fjalë, të cilin Gjykata e ka shqyrtuar edhe në një çështje të mëparshme kundër shtetit të paditur, është kthimi i shpeshtë i çështjeve për rigjykim nga gjykatat më të larta te gjykatat më të ulëta. Gjykata është e mendimit se kjo vonesë i atribuohet tërësisht gjykatave të vendit. Në këtë rast procesi penal zgjati 6 vjet dhe 11 muaj, zgjatje e cila çoi në një shkelje që i atribuohet gjykatave të brendshme”*³⁹.

Sa i përket gjyimit të rasteve brenda një afati të arsyeshëm, në Gjykatën Themelore në Prizren thonë se po thuajse 90% të rasteve caktohen në afatin e paraparë ligjor:

“Në Gjykatën Themelore në Prizren – Departamenti i Krimeve të Rënda, pothuajse në 90% të rasteve, lëndët caktohen në afatin e paraparë ligjor sipas Kodit të Procedurës Penale. Sa i përket zvarritjes, ne nuk mund të themi se kemi të bëjmë me zvarritje por Kodi i Procedurës Penale, ka paraparë shqyrtimin fillestar, Shqyrtimin e dytë dhe Shqyrtimin kryesor – gjyqësor. Nga shqyrtimi fillestar deri në shqyrtimin kryesor nevojitet një kohë prej 3 muajve. Në shqyrtimin kryesor varësisht prej rastit mund të kemi propozime për sigurimin e ndonjë provë (ekspertiza) dhe padyshim që duhet kohë për t’i siguruar provat e nevojshme varësisht prej ndërlikueshmërisë së rastit. Në këto rrethana nuk mund të konsiderohet se kemi të bëjmë me shkelje të të drejtave të personave për një gjykim të drejtë dhe të shpejtë”⁴⁰.

Ndërsa, në Gjykatën Themelore në Gjiilan thonë se arsye e mos përfundimi i lëndëve sipas afateve ligjore është ngarkesa me lëndë dhe numri i vogël i gjyqtarëve⁴¹.

Ndërsa, në përgjigjen e Gjykatës Themelore në Gjakovë thuhet se deri tek zgjatja e kohës së një gjykimi ka ardhur si rezultat i disa veprimeve dhe pengesave procedurale:

“Gjykata Themelore në Gjakovë, ka bërë përpjekje të vazhdueshme që shqyrtimet fillestare të caktohen brenda afateve ligjore, mirëpo gjate rrjedhës së shqyrtimeve gjyqësore si rezultat i propozimit të palëve në procedurë (ekspertiza etj.) dhe pengesave tjera për sigurimin e prezencës së personave të domosdoshëm për pjesëmarrje në shqyrtime, ka ardhur deri tejzgjatja e kohës së përfundimit gjyqësorë”⁴².

Ndërkaq, ka edhe raste të cilat janë proceduar me pranim të fajësisë, ku gjykata nuk ka respektuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale lidhur me pajtimin e fajësisë. Në rastin e të

³⁹ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Aktgjykim. Rasti Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë. Nr.33192/07 dhe 33194/07. Strasburg, 9 dhjetor 2013.

⁴⁰ Përgjigje e nënkryetarit të GjTh Prizren, Artan Sejrani, për IKD, 21 qershor 2020.

⁴¹ Përgjigje e zëdhënësit të GjTh në Gjiilan, Sabit Shkodra, për IKD, 22 qershor 2020.

⁴² Përgjigje e zëdhënësit të GjTh në Gjakovë, Lekë Muçaj, për IKD, 20 qershor 2020.

akuzuarit Pjetër Ndrecaj, i akuzuar për vrasje të dyfishtë, gjykata kishte aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e tij. E më pas, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, me vendimin e saj, pasi kishte anuluar edhe aktgjykimin e shkallës së parë edhe atë të Apelit, e cila kishte ndryshuar aktgjykimin e dënuar me burgim të përjetshëm Ndrecaj, kishte konstatuar se në shqyrtim fillestar pranimi i fajësisë është në kundërshtim të plotë me dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë.

Kjo pasi që Ndrecaj akuzohet se ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë, e cila kryhet në rastet kur me dashje kryhen dy apo më shumë vrasje, kurse deklarimi i tij është vetëm përkitazi me vrasjen e ish-bashkëshortes së tij, ashtu që i akuzuari pas leximit të aktakuzës dhe pas konsultimit me mbrojtësin e tij, kishte deklaruar se: *“E pranoj fajësinë për vrasjen e ish gruas time, mirëpo vajzën e kam vra aksidentalisht”*.

Shkelje tjetër gjatë pranimit të fajësisë ishte bërë edhe në rastin e Labinot Nurës, i akuzuar për veprën penale *“Kultivimi i bimës së hashashit, shkurrës së kokainës ose bimëve të kanabisit”*. I njëjti në shqyrtim fillestar, fillimisht kishte mohuar fajësinë për veprën penale që i vihej në barrë, mirëpo pas ndikimit e presionit nga ana e gjykatësit e prokurorit, ky i fundit kishte vendosur që të pranojë fajësinë. Ndërkaq, dihet se Kodi i Procedurës Penale ka përcaktuar se pranimi i fajësisë duhet të bëhet në mënyrë të vullnetshme, pa presion e ndikim. Gjithashtu, ky i pandehur as nuk kishte pasur në dispozicion provat të cilat organi i ndjekjes i posedonte dhe ka për obligim kushtetues dhe ligjor që ta pajis të pandehurit me to. E sërish, gjykata ka shkelur Kodin e Procedurës Penale kur ka miratuar pranimin e fajësisë. Kjo pasi Kodi i Procedurës Penale përcakton se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, siç është dëshmia e dëshmitarëve e paraqitur nga prokurori i shtetit ose i pandehuri. Si dhe, ky kod përcakton se gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues duhet të çmojë nëse prokurori i shtetit ka përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave nga neni 244 i këtij Kodi.

Në këtë rast, gjithashtu është shkelur edhe neni 30 i Kushtetutës së Kosovës, ku thuhet se çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.⁴³

Në rastin e Nurës, gjykatësi ka shkelur prezumimin e fajësisë meqenëse edhe pasi i akuzuari kishte mohuar fajësinë e tij, pasi prokurori i kishte thënë të akuzuarit *“Pranoje se s’ki ka ja man”*, gjykatësi i kishte thënë *“E merr ni kusht”*, duke aluduar se i akuzuari është fajtor, edhe pse ishte fillimi i shqyrtimit fillestar, nuk ishte bërë shqyrtimi i provave në procedurë dhe ende nuk ishte dëshmuar pafajësia apo fajësia e të akuzuarit dhe si është cekur më lartë, assesi pranimi i fajësisë nuk duhet të bëhet në presion apo në mënyrë të pavullnetshme, pa marrë parasysh se për çfarë presioni bëhet fjalë.

⁴³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. neni 30.

Tutje, IKD ka gjetur se aktgjykimet e përpiluara nga ana e gjyqtarëve të Departamentit për Krime të Rënda, nuk janë në përputhshmëri me Udhëzuesin për Politikë Ndëshkimore⁴⁴.

Se gjykatësit e prokurorët nuk po respektojnë të drejtat e të pandehurve dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale vërehet edhe në rastin e Nexhmedin Krasniqit, i akuzuar për narkotikë.

Në këtë rast, IKD ka gjetur se prokurorja ka bërë ricilësimin e veprës penale në Kodin e ri Penal, mirëpo vepra penale e ricilësuar nuk ka ekzistuar në kohën e kryerjes së veprës penale dhe si rrjedhojë është shkelur parimi retroaktivitetit të ligjeve pasi që ligjet nuk kanë fuqi prapavepruese dhe ndaj të pandehurit aplikohet vetëm ligji i cili ekziston në kohën e kryerjes së veprës penale. Me këtë rast gjykatësi i rastit, Sylë Lokaj, edhe pse prokurorja Haxhosaj kishte heqë dorë nga akuza pasi ishte bërë parashkrimi absolut i veprës së ricilësuar e ka hapur përsëri gjykimin dhe i pandehuri është gjykuar. Për më tepër, si veprim i pakuptimtë në një sistem penal si në rastin e Republikës së Kosovës, gjyqtari Sylë Lokaj e kishte rihapur rastin penal, me arsyetimin se nuk e ka pranuar tërheqjen e Prokurorit të Shtetit nga aktakuza. Madje, pas këtij vendimi, Prokurori i Shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor kishte lexuar aktakuzën nga e cila paraprakisht ishte tërhequr. I gjendur në këto rrethana, i pandehuri kishte pranuar fajësinë për posedim të narkotikëve, dhe në kundërshtim me ligjin, Gjykata e kishte dënuar të njëjtin për shpërndarje të narkotikëve.

Për më tepër, për këtë rast, mbrojtësi i të pandehurit kishte dyshime se në kundërshtim me ligjin, është ndërhyrë edhe në procesverbalin e seancës gjyqësore për këtë rast.

Ky është rast i shkeljeve direkte e të drejtave të njeriut dhe manifeston eksperimentet e prokurorisë në dëm të pandehurve, si dhe shkeljen e dispozitave ligjore nga ana e gjykatës, ku si pasojë është dëmtuar i pandehuri në procedurë.

Në këtë rast me anë të rikualifikimit të veprës penale me një vepër që nuk ka ekzistuar në kohën e kryerjes së veprës penale është shkelur neni 33 i Kushtetutës, që përcakton se *“askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit”*⁴⁵.

Gjithashtu, IKD ka vërejtur edhe mbylljen e seancave për publikun nga ana e gjyqtarëve pa u përmbushur kushtet e parapara me kod dhe duke shkelur në mënyrë arbitrare parimin e publicitetit.

IKD thekson se dispozitat ligjore vendore dhe ndërkombëtare dhe po ashtu edhe praktika e GjEDNj-së i japin rëndësi jetike proceseve gjyqësore të hapura për publikun dhe palët e

⁴⁴ Shala, Gzim. “Politika e dënimeve në Kosovë - Analizë e zbatimit të Udhëzuesit të Politikës Ndëshkimore nga Gjykatat e Republikës së Kosovës”. IKD. Nëntor 2019. (Shih linkun <https://kli-ks.org/politika-e-denimeve-ne-kosove/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁴⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 33.

interesuara, për të siguruar një proces gjyqësor të drejtë, që qëllim final ka fitimin e besimit të publikut në pavarësinë dhe paanshmërinë e gjykatave⁴⁶.

Po ashtu, gjatë monitorimit të IKD-së është vërejtur se në shumë raste, prokurorët nuk zbatojnë obligimin e tyre për sigurimin e mbrojtësit apo mbrojtësit kryesor me materialet që janë pjesë e lëndës, ashtu si parashihet me nenin 244 të Kodit të Procedurës Penale.

Po ashtu, një anomali tjetër që është vërejtur gjatë monitorimit të IKD-së është edhe asgjësimi i armës në rastin e vrasjes së njohur në publik si “Bon Vivant”. Arma në këtë rast ishte asgjësuar pa përfunduar gjykimi.

Tutje, në rastin e Arbnor Morinës, edhe prokuroria, edhe Gjykata e Apelit kishin shkelur të drejtat e tij si i pandehur. Morina akuzohej për vepra penale të lidhura me krim kibernetik, në të cilin rast, aktakuza në fjalë ishte ngritur pas kalimit të afatit ligjor dy vjeçar, nga dita kur ishte nxjerrë aktvendimi për fillimin e hetimit. Për këtë arsye, akuza ishte hedhur poshtë nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Por, pas ankesës së prokurorisë, Gjykata e Apelit, më 8 janar 2019, rastin e kishte kthyer në rivendosje, pasi kishte aprovuar si të bazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të ushtruar ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, për hudhjen e aktakuzës. Në arsyetim, Apeli nuk e kishte përmendur çështjen e hudhjes së aktakuzës, se ajo ishte ngritur pas kalimit të afatit ligjor, por në të përshkruhej se shkalla e parë ka gabuar në zbatimin e ligjit dhe se në këtë stad të procedurës, ka prova të mjaftueshme për një dyshim të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale, për të cilat është akuzuar. Ndërkaq, në mars të vitit 2019, në emisioni “Betimi për Drejtësi”, kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala, kishte deklaruar se konsideron se gjykata që ai udhëheq, ka gabuar kur nuk e kishte hudhur këtë aktakuzë, për shkak se ajo ishte ngritur pas afatit ligjor. Pas konfirmimit të aktakuzës nga ana e Gjykatës së Apelit, procesi gjyqësor në këtë rast kishte vazhduar, dhe në fund, gjykata e shkallës së parë kishte nxjerrë aktgjykim refuzues, i cili vendim ishte vërtetuar nga Gjykata e Apelit. Në anën tjetër, në këtë rast kanë kaluar 4 vite e 5 muaj që nga ngritja e aktakuzës deri në vendimin e Apelit, me anë të së cilit kishte vërtetuar vendimin e gjykatës së parë që kishte nxjerrë aktgjykim refuzues.

Sipas të dhënave që gjykatat dhe prokuroritë publikojnë vit pas viti, IKD ka vërejtur se gjykatat që nga viti 2016 kanë ulur efikasitetin në zgjidhjen e lëndëve. Këto të dhëna tregojnë se gjykatat vit pas viti kanë ulur numrin e lëndëve të zgjidhura edhe pse në krahasim me numrin e lëndëve të reja që i pranojnë në punë del që zgjidhin më shumë se sa kanë pranuar. Në vitin 2016, gjykatat kanë zgjidhur 697 lëndë më shumë se sa kanë pranuar, ndërsa në vitin 2017 kanë zgjidhur 525 lëndë më shumë se sa kanë pranuar. Edhe në vitin 2018, DKR-të e GjTh-ve kanë zgjidhur 470 lëndë më shumë se sa kanë pranuar, derisa në 2019 kanë zgjidhur 423 lëndë më shumë se sa kanë pranuar. Për shkak të kësaj gjendje, IKD vlerëson se ky është një shembull

⁴⁶ “IKD reagon ndaj praktikës së mbylljes të kundërligjshme të seancave të caktuara gjyqësore, duke censuruar mediat dhe publikun, kërkon llogaridhënie të gjykatësve”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. 24 dhjetor 2019 (Shih linkun <https://kli-ks.org/ikd-reagon-ndaj-praktikes-se-mbylljes-te-kunderligjshme-te-seancave-te-caktuara-gjyqesore-duke-cenzuruar-mediat-dhe-publikun-kerkon-llogaridhenie-te-gjykatesve/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

tipik se mungesa e resurseve humane nuk është problemi kryesor i sistemit gjyqësor në kuptim të numrit të madh të lëndëve. Kjo për arsye se përkundër faktit se kemi një ngritje të numrit të gjyqtarëve për 19% (8 gjyqtarë), kjo rritje nuk ka reflektuar fare në ngritjen e efikasitetit. Përkundrazi, numri i rasteve të zgjidhura tanimë është më i vogël.

Sa i përket sistemit prokurorial, nga të dhënat e siguruar përmes raporteve vjetore, vërehet disbalancë e madhe krahasuar me numrin e lëndëve të zgjidhura nga viti në vit. Krejt kjo, pasi në vitin 2016 rezultoi se janë zgjidhur 53% të lëndëve, në vitin 2017 vërehet rritje e numrit të lëndëve të zgjidhura në 1% më shumë, mirëpo dallim i madh paraqitet mes viteve 2016 dhe 2017 me vitin 2018. Kjo pasi sipas të dhënave zyrtare të raporteve të sistemit prokurorial, shihet se në vitin 2018 ka pasur ulje drastike të numrit të lëndëve të zgjidhura, pra rreth 20% më pak lëndë të zgjidhura. Ndërsa në vitin 2019 vërehet se është balancuar numri i lëndëve të zgjidhura me vitet 2016 dhe 2017.

Ndërkaq, në lidhje me performancën individuale të gjykatësve të dhënat tregojnë se ka diferencë të madhe të numrit të lëndëve të kryera mes gjyqtarëve në Departamentet e Krimeve të Rënda. Kjo për shkak se në mesin e gjyqtarëve të DKR-ve ka gjyqtarë që gjatë vitit 2019 ka kryer 102 lëndë, derisa ka edhe të tjerë që gjatë tërë vitit 2019 kanë përfunduar më pak lëndë se norma vjetore prej 31 lëndësh. Mirëpo, për shkak të mos përmbushjes së kësaj norme, KGJK nuk ka ndërmarrë masa parandaluese apo masa të tjera, në mënyrë që performanca jo e mirë e një gjykatësi të përmirësohet në vitin e ardhshëm. Përkatësisht, KGJK nuk ka përmbushur njërin prej kompetencave kryesore të saj, e që është mbajtja llogaridhënës e gjyqtarëve, në mënyrë që performanca, efikasiteti dhe efektiviteti i sistemit gjyqësor të ngritën. IKD ka vërejtur se në këtë situatë nuk ka pasur përmirësime ngase edhe në vitin 2018 gjendja ka qenë e njëjtë, ku ka pasur raste kur një gjykatës ka zgjidhur afër trefish më shumë lëndë se sa norma vjetore, ndërsa ka prej tyre që kanë zgjidhur vetëm nga 18 lëndë, edhe pse është dashur t'i zgjidhë 31 sosh.

Gjendja e njëjtë është edhe në sistemin prokurorial përkundër se për shkak të mos transparencës së këtij sistemi, është pamundësuar që të trajtohet performanca individuale e prokurorëve. Kjo pasi për dallim nga KGJK që ka publikuar pasqyrës e performancës në faqen e saj zyrtare, ku ipet të dhëna mbi performancën e secilit gjykatës, një gjë të tillë nuk e ka bërë edhe KPK. Mirëpo, sipas të dhënave nga raportet vjetore të Prokurorit të Shtetit, prokurorët e DKR-vë të prokurorive themelore edhe pse brenda një muaji është dashur t'i zgjidhin nga 6 kallëzime penale, ndërsa brenda vitit 66 kallëzime penale, ka pasur prej tyre që kanë zgjidhur në muaj 3 më pak se norma mujore dhe 33 më pak se norma vjetore. Nga raporti i Prokurorit të Shtetit për vitin 2019, rezultoi se një prokuror i PTh në Mitrovicë ka zgjidhur më së shumti lëndë për një muaj, pra 10.11 lëndë në muaj, pas tyre radhiten prokurorët e PTh në Gjilan me 6.33 lëndë në muaj, prokurorët e PTh në Ferizaj me 8.12 lëndë, prokurorët e PTh në Gjakovë me 7.04 lëndë, ndërsa nën normën mujore radhiten prokurorët e PTh në Prizren me 5.14 lëndë në muaj, prokurorët e PTh në Prishtinë me 4.41 lëndë në muaj, si dhe prokurorët e PTh në Pejë me 3.4 lëndë në muaj.

Sipas kësaj, vërehet se disa prokurori nuk e kanë arritur minimumin e normës vjetore, prandaj sipas IKD-së, KPK duhet të jap sqarime se cilat kanë qenë arsyet se përse kanë ardhur deri te kjo gjendje, për shkak se edhe në vitin 2018 ka qenë e njëjta gjendje e zgjidhjes së lëndëve ku disa prokurori kanë përmbushur normën, ndërsa disa prej tyre nuk e kanë përmbushur.

8. Trajtimi i detajuar i disa nga rasteve të analizuara nga IKD në DKR-të për vitin 2019

IKD në këtë raport ka analizuar detajisht 18 raste të trajtuara në DKR-të e gjykatave themelore, prej të cilave tri (3) raste janë të formës së prerë, dy (2) raste janë në proces për herë të parë, dy (2) raste janë të kthyera një herë në rigjykim, shtatë (7) raste janë të kthyera dy herë në rigjykim dhe katër (4) raste kanë përfunduar me aktgjykim të shkallës së parë.

Nga këto 18 raste, përfshihen 33 persona të akuzuar, prej të cilave 11 raste janë raste të veprave penale të vrasjeve ku përfshihen 21 persona të akuzuar derisa katër raste të tjera bëjnë pjesë në kuadër të veprave penale terroriste në të cilat përfshihen 9 persona të akuzuar. Përpos rasteve të vrasjeve dhe terrorizmit, dy (2) raste i takojnë veprave penale që lidhen me narkotikët ku janë të akuzuar dy (2) persona, kurse në një rast për vepra penale që lidhen me krime kibernetike përfshihet një person i akuzuar.

Në tri rastet që kanë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë, dy prej tyre janë raste të narkotikëve që përfshihen dy persona ndërsa në rastin tjetër të formës së prerë përfshihet një person i akuzuar për krime kibernetike.

Në dy rastet që janë në proces për herë të parë, të dyja rastet janë për vepra penale të vrasjeve ku përfshihen tre persona të akuzuar.

Në dy rastet e kthyera nga një herë në rigjykim janë të përfshirë dy persona për vepra penale të vrasjeve.

Në shtatë raste të cilat janë kthyer nga dy herë në rigjykim, janë të përfshirë 13 persona ku tre prej tyre janë të akuzuar për vepra penale terroriste dhe 10 persona për vepra penale të vrasjeve.

Në katër rastet që kanë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë, përfshihen 13 persona, ku gjashtë (6) janë të akuzuar për terrorizëm dhe shtatë për vepra penale të vrasjeve.

9. ANEX I: Analizë e detajuar e rasteve që kanë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë

1. Rasti i të akuzuarit për terrorizëm

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.181/18

Vepra penale: “Ndihma në kryerjen e veprës penale të terrorizmit”, pas rikualifikimit “Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale terroriste”

Kryetari i Trupit Gjykuës: Valbona Musliu-Selimaj

Prokuror special: Drita Hajdari

I pandehur: Fehmi Musa

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar

Nga ngritja e aktakuzës e deri kur aktgjykimi ka marrë formë të prerë kanë kaluar 1410 ditë apo 3 vite e 10 muaj.

Musa ka qenë i bashkë akuzuar në rastin e njohur si “Badovci”, i cili në këtë rast ishte dënuar me 4 vite burgim, dënim të cilin ia kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit, mirëpo rasti ndaj tij ishte kthyer në rigjykim nga Gjykata Supreme me 29 maj 2018. Aktakuza ndaj Musës dhe të bashkakuzuarve të tij Besnik Latifit, Gazmend Halitit, Milazim Haxhiajt, Betim Ibrahimajt dhe Enis Latifit ishte ngritur me 4 dhjetor 2015, nga PSRK.

Musa po akuzohet se me 11 korrik 2015 kishte shkuar tek liqeni i Badovcit për ti arratisur nga vendi i ngjarjes të akuzuarit Besnik dhe Enis Latifin si dhe Milazim Haxhijajn, të cilët me ikonografin e terrorit të organizatës terroriste ISIS, kishin pasur për qëllim incizimin e një video propaganduese me qëllim leximin e betimit ndaj udhëheqësit të ISIS-it dhe të publikojnë këtë video në internet, për t’ua dëshmuar botës shtrirjen e shtetit islamik në Republikën e Kosovës.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Musa për herë të parë ishte shpallur fajtor me 18 korrik 2016, dhe ishte dënuar me katër vite burgim efektiv, dënim të cilin e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit me 29 nëntor 2016⁴⁷.

Mirëpo, mbrojtësit e të akuzuarve kishin paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë pranë Gjykatës Supreme, e cila gjykatë e kishte vendosur që lënda të kthehet në rivendosje-rigjykim. Ndërsa, për herë të dytë Gjykata Themelore në Prishtinë, më 19 korrik 2017, Musën e kishte

⁴⁷ *Shënim:* Bashkë me Musën në gjykimin e parë të rastit “Badovci”, ishin dënuar edhe të akuzuarit e tjerë në këtë rast. Besnik Latifi ishte dënuar me 13 vjet burg, Gazmend Haliti me 12, Milazim Haxhiaj me 10 vjet e 3 muaj, Enis Latifi me 10 vjet. Nderkaq pas kthimit të lëndës në rigjykim, për herë të dytë, Gjykata Themelore në Prishtinë Besnik dhe Enis Latifi, si dhe të akuzuarit Haliti dhe Haxhiaj i kishte shpallur fajtorë dhe i kishte dënuar me nga tre vjet e gjashtë muaj burgim. Aktgjykimin ndaj tyre e kishte vërtetuar Gjykata e Apelit me 24 tetor 2017.

dënuar me tre vite burgim⁴⁸. Gjykata e Apelit me 24 tetor 2017, kishte refuzuar si të pabazuara ankesat e PSRK-së dhe mbrojtësve të të dënuarve dhe aktgjykimin e shkallës së parë të 19 korrikut e kishte vërtetuar⁴⁹. Kundër aktgjykimeve të kundërshtuara, mbrojtësi i të akuzuarit Fehmi Musa, avokati Blerim Qela, kishte paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, për shkak të shkeljeve të ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës ti ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara ose ti të njëjtat ti anuloj dhe çështjen ta kthej në rigjykim. Këtë kërkesë e kishte miratuar Gjykata Supreme me 29 maj 2018.

Sipas Supremes, vendimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për arsye se në të nuk janë paraqitur arsyet për faktet vendimtare dhe pasi që këto shkelje nuk janë eliminuar në aktgjykimin e shkallës së dytë dhe po ashtu edhe ai aktgjykim sipas Supremes, është përfshirë me shkelja të njëjta të dispozitave të procedurës penale. Sipas këtij aktgjykimi, ajo çfarë thuhet në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë nuk rezulton të jetë kontestuese rrethanat se Musa pas bisedës telefonike me të dënuarit Gazmend Halitin, kishte shkuar me automjetin e tij me të cilin kishte ushtruar veprimtarinë e taksistit deri te Liqeni i Badovcit dhe pas takimit me të i kishte transportuar të dënuarit Haliti deri në shtëpinë e tij në Hajvali, kurse të dënuarin tjetër Betim Ibrahimajn deri në Istog.

Sipas Supremes, nga këto rrethana gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë kanë dhënë konstatim se shkuarja e Musës në orët e vona të natës tregon qëllimin për t'iu ndihmuar të dënuarve tjerë për largimin nga vendi i ngjarjes. Prandaj Supremja me kthimin e lëndës në rivendosje ka kërkuar që gjykata e shkallës së parë të vërtetojë dhe të arsyetojë në mënyrë ligjore faktet vendimtare në bazë të të cilave vërtetohet se i akuzuari Musa kishte njohuri se të dënuarit tjerë kishin ndërmarrë veprime konkrete për veprat penale për të cilat ishin shpallur fajtor, si dhe të vërtetojë cilat shin veprimet inkriminuese të Musës.

Pas kthimit të lëndës në rivendosje, seanca e paraparë të mbahej me 16 janar 2019 ndaj Musës kishte dështuar për shkak të mungesës së përfaqësuesit nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), si dhe avokatit Blerim Qela⁵⁰.

Pas kthimit të rastit për të dytën herë në rigjykim, në seancën e 22 shkurt 2019, Musa për herë të tretë ishte deklaruar i pafajshëm për të njëjtin rast.⁵¹ Në seancën e 10 prillit me kërkesë të

⁴⁸ “Dënohen të akuzuarit në rastin Badovci”. Betimi për Drejtësi. 19 korrik 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohen-te-akuzuarit-ne-rastin-badovci/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁴⁹ “Apeli vërteton dënimin për të akuzuarit e rastit “Badovci”. Betimi për Drejtësi. 5 dhjetor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-denimin-per-te-akuzuarit-e-rastit-badovci/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁵⁰ “Dështon seanca ndaj të akuzuarit për terrorizëm, rasti i të cilit dy herë është kthyer në rigjykim”. Betimi për Drejtësi. 16 janar 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/desh-ton-seanca-ndaj-te-akuzuarit-per-terrorizem-rasti-i-te-cilit-dy-herë-eshte-kthyer-ne-rigjykim/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁵¹ “Për të tretën herë deklarohet i pafajshëm njëri nga të akuzuarit për terrorizëm në rastin “Badovci”. Betimi për Drejtësi. 22 shkurt 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/per-te-treten-herë-deklarohet-i-pafajshem-njeri-nga-te-akuzuarit-per-terrorizem-ne-rastin-badovci/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

prokurores Drita Hajdari ishte përjashtuar publiku për shkak se në këtë seancë ishin paraparë të dëgjohen hetuesit policorë nga Drejtoria Kundër Terrorizëm.⁵² Por pas dëgjimit të këtyre hetuesve seanca ishte rihapur për publikun, në të cilën ishin dëgjuar dy dëshmitarë.⁵³ Me 7 maj 2019 ishte mbajtur seanca e radhës në të cilën i akuzuari e kishte dhënë mbrojtjen e tij, si dhe palët e kishin dhënë edhe fjalën përfundimtare. Në këtë seancë prokurorja Drita Hajdari kishte ri-kualifikuar veprën penale nga ndihmë në kryerjen e veprës penale terroriste, në atë të dhënies së ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale terroriste.

Ndërsa me 13 maj 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë Musën e kishte dënuar me tre vite burgim⁵⁴, ndërsa Gjykata e Apelit me 14 tetor 2019 e kishte vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

⁵² “Përjashtohet publiku në rigjykimin e të akzuarit për terrorizëm në rastin “Badovci”. Betimi për Drejtësi. 20 prill 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/perjashtohet-publiku-ne-rigjykimin-e-te-akzuarit-per-terrorizem-ne-rastin-badovci/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁵³ “Shokët e të akzuarit për terrorizëm në rastin “Badovci” thonë se kishin qenë bashkë një ditë para se të arrestohej”. Betimi për Drejtësi. 20 prill 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shoket-e-te-akzuarit-per-terrorizem-ne-rastin-badovci-thone-se-kishin-qene-bashke-nje-dite-para-se-te-arrestohej/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁵⁴ “Pas kthimit në rigjykim, sërish dënohet me tre vjet burg i akuzuari në rastin “Badovci”. Betimi për Drejtësi. 13 maj 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-kthimit-ne-rigjykim-serish-denohet-me-tre-vjet-burg-i-akzuarit-ne-rastin-badovci/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

2. Rasti ku aktakuza është ngritur pas afatit ligjor

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.369/15

Vepra penale: “Keqpërdorimi i kartelave të bankës apo kreditit”, “Prodhimi, posedimi dhe tentativa e paautorizuar”

Kryetari i Trupit Gjykses: Naser Foniqi

Prokuror : Fikrije Fejzullahu, Besa Limani

I pandehur: Arbnor Morina

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar

Nga ngritja e aktakuzës e deri në vërtetimin e aktgjykimit nga Gjykata e Apelit kanë kaluar 1624 ditë apo 4 vite e 5 muaj.

Sipas aktakuzës së ngritur më 29 qershor 2015, i akuzuari Arbnor Morina akuzohet se prej kohës së pavërtetuar, në vazhdimësi, deri më datën 26 prill 2013, në bashkëkryerje me një person të panjohur ka keqpërdorur kartelat bankare të personave të ndryshëm, në atë mënyrë që paraprakisht e ka falsifikuar një letërnjoftim në emër të Bekim Thaqit, e pastaj duke hyrë në mënyrë të paautorizuar në sistemin kompjuterik ka arritur të merr identitetin e kartelave bankare e të cilat i ka vënë në përdorim, ashtu që përmes tyre ka porositur sende të ndryshme si: laptop, telefona, kompjuterë etj.

Gjithnjë sipas prokurorisë, me këto veprime të të akzuarit Arbnor Morina u janë shkaktuar humbje të mëdha firmave të ndryshme, e me datën 26 prill 2013, Dogana e Kosovës ka vërejtur se disa porosi kanë arritur për pranues të dyshimtë dhe se pas hetimit nga ana e personave zyrtar konstatohet se pranuesi kundërligjor është i akuzuari Arbnor Morina.

Me këto veprime, Prokuroria e ngarkonte të akzuarin Arbnor Morina se ka kryer veprat penale “keqpërdorimi i kartelave të bankës apo kreditit” nga neni 307 i KPRK-së, “Prodhimi, posedimi dhe tentativa e paautorizuar” neni 13 par.3 dhe Neni 15 i Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Në këtë rast, Prokuroria Themelore në Prishtinë, aktvendimin për fillim të hetimeve e kishte nxjerrë më 27 prill të vitit 2013, kurse aktakuzën e kishte ngritur më 29 qershor të vitit 2015. Përpilimi i aktakuzës ishte bërë nga prokurorja Fikrije Fejzullahu, ndërsa përfaqësimin në gjykatë e kishte bërë prokurorja Besa Limani.

Në seancën e 8 tetorit 2018, ku ishte paraparë të mbahej shqyrtimi fillestar, kishte munguar prokurorja Besa Limani e cila ishte obliguar nga kryetari i trupit gjykses, gjykatësi Naser Foniqi, që të bëjë plotësimin dhe precizimin e aktakuzës, pasi në seancën e 20 shtatorit 2018,

ishite cilësuar si e mangët dhe jo e plotë nga ana e gjykatësit Foniqi.⁵⁵ Por, edhe seanca e 23 tetor 2018, kishte dështuar të mbahet për shkak të mungesës së gjykatësit Foniqi, i cili kishte qenë në një trajnim.⁵⁶

Me 12 nëntor 2018, apo 1,232 ditë pas ngritjes së aktit akuzues, ishte arritur të mbahej shqyrtimi fillestar edhe pse sipas nenit 242 par. 4 të KPPK-së ishte dashur të mbahej brenda 30 ditëve pas ngritjes së aktakuzës.

Në këtë seancë i akuzuari ishte deklaruar i pafajshëm, ndërsa prokurorja Besa Limani kishte bërë plotësimin dhe precizimin e aktakuzës, dhe sipas saj ishte përcaktuar me saktësi figura veprave penale, të cilat me aktakuzën e vitit 2015, ishin përcaktuar në mënyrë të përgjithshme vetëm me nenet përkatëse. Sipas prokurores Limani, tashmë janë inkriminuar edhe paragrafët e këtyre veprave penale, siç janë paragrafi 3 i nenit 13 dhe paragrafi 1 i nenit 15 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik.⁵⁷

Pasi prokurorja Limani kishte deklaruar se gjatë shqyrtimeve të ardhshme do të bëjë përshkrimin për secilën vepër penale, mbrojtësi i të akuzuarit Morina, avokati Xhafer Maliqi, kishte deklaruar se kanë kaluar afër dy muaj prej ditës kur gjykata i kishte dërguar një parashtrësë me shkrim prokurorisë, konform nenit 442 të KPPK-së dhe me atë shkresë gjykata e kishte njoftuar prokurorinë për pasojat e mosveprimit sipas vendimit të saj.

Më 14 dhjetor 2018, ishte mbajtur shqyrtimi i dytë në këtë rast, ku prokurorja e rastit Besa Limani, ka kërkuar nga gjykata që t'i refuzojë kërkesat për hudhjen e aktakuzës të parashtruara më 29 nëntor 2018 nga mbrojtësi i të akuzuarit Arbnor Morina, avokati Xhafer Maliqi⁵⁸.

Ndërsa me 17 dhjetor 2018, gjykata e kishte hudhur aktakuzën me arsyetimin se aktakuza në fjalë ishte ngritur pas kalimit të afatit ligjor dy vjeçar, nga dita kur ishte nxjerrë aktvendimi për fillimin e hetimit, ashtu që ky vendim ishte marrë më 27 prill 2013, ndërsa aktakuza në këtë çështje penale ishte ngritur më 29 qershor 2015, pra dy muaj e dy ditë pas kalimit të afatit të paraparë me Kodin e Procedurës Penale.

⁵⁵ “Mungesa e prokurores shtyn gjykimin ndaj të akuzuarit për krim kibernetik”. Betimi për Drejtësi. 8 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungesa-e-prokurores-shtyn-gjykimin-ndaj-te-akuzuarit-per-krim-kibernetik/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁵⁶ “Gjykatësi në trajnim, sërish dështon gjykimi ndaj të akuzuarit për krim kibernetik”. Betimi për Drejtësi. 23 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykatesi-ne-trajnim-serish-deshton-gjykimi-ndaj-te-akuzuarit-per-krim-kibernetik/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁵⁷ “Pas plotësimit të aktakuzës, deklarohet i pafajshëm i akuzuari për krim kibernetik”. Betimi për Drejtësi. 12 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-plotesimit-te-aktakuzes-deklarohet-i-pafajshem-i-akuzuari-per-krim-kibernetik/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁵⁸ “Gjykimi ndaj të akuzuarit për krim kibernetik, Prokuroria kërkon të refuzohet kërkesa e mbrojtjes për hudhje të aktakuzës”. Betimi për Drejtësi. 14 dhjetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-ndaj-te-akuzuarit-per-krim-kibernetik-prokuroria-kerkon-te-refuzohet-kerkesa-e-mbrojtjes-per-hudhje-te-aktakuzes/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

Por, Gjykata e Apelit me vendimin e 8 janarit 2019, ka vendosur që ta konfirmoj aktakuzën duke aprovuar si të bazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë të ushtruar ndaj vendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, për hudhjen e aktakuzës.

Në vendimin e siguruar, rezulton se Apeli kishte vërtetuar se gjykata e shkallës së parë, gabimisht e kishte aprovuar kërkesën e mbrojtjes për hudhjen e aktakuzës, me ç'rast kishte zbatuar gabimisht dispozitat e kodit lidhur me ekzistimin e rrethanave që pengojnë ndjekjen penale. Tutje, Apeli kishte konstatuar se në rastin konkret, në bazë të provave dhe shkresave tjera në lëndë, ka prova të mjaftueshme nga të cilat rezulton dyshimi i bazuar mirë se i akuzuari Arbnor Morina, ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar.

Më 18 janar 2019, gjykatësi Foniqi, kishte kërkuar që prokuroria edhe njëherë të plotësimin e aktit akuzues, ai kishte kërkuar që prokurorja ta bëj përshkrimin e secilës vepër veç e veç, me të cilën ngarkohet i akuzuari Morina. E kjo seancë ishte përcjellë me tensione mes Foniqit e Limanit.⁵⁹

Në mars të vitit 2019, emisioni “Betimi për Drejtësi”, kishte realizuar hulumtimin për “Praktikat jo unike gjyqësore për aktakuzat e kundërligjshme”, në kuadër të së cilit ishte trajtuar edhe rasti i kësaj aktakuze. Në këtë emision, kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala, kishte deklaruar se konsideron se gjykata që ai udhëheq, ka gabuar kur nuk e kishte hudhur këtë aktakuzë, për shkak se ajo ishte ngritur pas afatit ligjor.⁶⁰

Më 24 shtator të vitit 2019, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kishte përfunduar gjykimi në rastin e të akuzuarit për krim kibernetik, Arbnor Morina, pavarësisht, se aktakuza në këtë rast ishte vlerësuar e se ishte ngritur pas afatit ligjor, gjykimi kishte vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve në procedurë. Prokurorja Limani kishte kërkuar dënimin e të akuzuarit.

Ndërkaq, mbrojtja kishte thënë se kjo procedurë është dashur të pushohet për shkak të shkeljes së afatit për ngritjen e aktakuzës. Këtë e kishte bazuar në vendimin e kryetarit të trupit gjykues Naser Foniqi, me të cilin është hedhur aktakuza dhe deklaratimet e kryetarit të Gjykatës së Apelit, Hasan Shala, lidhur me këtë rast. “Vendimi i kësaj aktakuze është bërë objekt diskutimi i të gjitha instancave gjyqësore dhe prokuroriale, në emisionin “Betimi për Drejtësi”, të datës 02.03.2019, në të cilën vet kryetari i Gjykatës së Apelit z. Hasasn Shala ka thënë “njerëz jemi, nuk jemi të pagabueshëm dhe ky kolegji ka gabuar, këtë gabim nuk do ta përsërisim dhe këtë gabim do ta përmirësojmë” thuhet në fjalën përfundimtare të mbrojtësit të të akuzuarit, Avokatit Xhafer Maliqi.

⁵⁹ “Gjykata e kthen sërish në plotësim aktakuzën, prokurorja: “A jemi në diktaturë”, tensione në gjykimin për krim kibernetik”. Betimi për Drejtësi. 18 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-e-kthen-serish-ne-plotesim-aktakuzen-prokurorja-a-jemi-ne-diktature-tensione-ne-gjykimin-per-krim-kibernetik/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁶⁰ “Praktikat jo unike gjyqësore për aktakuzat e kundërligjshme”. Betimi për Drejtësi. 2 mars 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/emisionet/praktikat-jo-unike-gjyqesore-per-aktakuzat-e-kunderligjshme/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

Ndërkaq, më 25 shtator 2019, gjykata e kishte rrëzuar aktakuzën për shkak se ishte ngritur jashtë afatit ligjor⁶¹.

Kurse, me 9 dhjetor 2019, Apeli kishte refuzuar ankesën e prokurorisë për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe e kishte vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, me arsyetimin se aktgjykimi është përpiluar sipas dispozitave ligjore. Sipas Apelit, gjykata e shkallës së parë drejt ka vlerësuar se ekzistojnë rrethana të cilat e pengojnë ndjekjen penale për shkak të mos respektimit të afateve për ngritjen e aktakuzës”, thuhet në këtë aktgjykim⁶².

⁶¹ “Gjykata e rrëzon aktakuzën për krim kibernetik për shkak se ishte ngritur pas afatit ligjor”. Betimi për Drejtësi. 25 shtator 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-e-rrazon-aktakuzen-per-krim-kibernetik-per-shkak-se-ishte-ngritur-pas-afatit-ligjor/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁶² “Apeli vërteton se aktakuza ndaj të pandehurit për krim kibernetik ishte ngritur pas afatit ligjor” Betimi për Drejtësi. 20 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-se-aktakuza-ndaj-te-pandehurit-per-krim-kibernetik-ishte-ngritur-pas-afatit-ligjor/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

3. Rasti ku prokurori e gjykatësi ndikuan që i akuzuari për narkotikë të pranojë fajësinë

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.217/2019

Vepra penale: “Kultivimi i bimës së hashashit, shkurrës së kokainës ose bimëve të kanabisit”

Kryetari i Trupit Gjykses: Isuf Makolli

Prokuror : Ilaz Beqiri

I pandehur: Labinot Nura

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar

[Nga ngritja e aktakuzës e deri në aktgjykimin përfundimtar kanë kaluar 30 ditë apo 1 muaj.](#)

Sipas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 10 shtator 2019, me datë 6 shkurt 2014, rreth orës 19:50, në një shtëpi të pa banuar që gjendet në rrugën e “Zagrebit”, afër tjegullores në Prishtinë, ku përkohësisht banonte i pandehuri, i njëjti pa autorizim ka kultivuar bimë të kanabisit, në atë mënyrë që gjatë një bastisje nga ana e pjesëtarëve të Policisë të Kosovës të asaj banese, kanë gjetur dhe sekuestruar 5 bimë të kanabisit me gjatësi prej 1.5 cm të cilat ishin të kultivuara në 5 saks.

Me këtë, ai akuzohej se ka kryer veprën penale “Kultivimi i bimës së hashashit, shkurrës së kokainës ose bimëve të kanabisit”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Në këtë rast shqyrtimi fillestar është mbajtur më 10 tetor të vitit 2019. I akuzuari fillimisht nuk e kishte pranuar fajësinë për veprën penale që i vihej në barrë nga ana e organit të ndjekjes, mirëpo, pas disa minutash kishte ndryshuar mendimin dhe kishte pranuar fajësinë.

Mirëpo, ai kishte bërë ndryshimin e deklaramit të tij lidhur me fajësinë, pas presionit të bërë nga ana e prokurorit Ilaz Beqiri dhe gjykatësit Isuf Makolli. I akuzuari në këtë shqyrtim gjyqësor nuk ishte i përfaqësuar me avokat mbrojtës.

Më pas, kur gjykatësi Makolli kishte filluar të bëjë udhëzimin e të pandehurit lidhur me kërkesën për hudhje të aktit akuzues dhe kundërshtimit të provave, kishte thënë se i akuzuari nuk di të bëjë kundërshtimet. Ndërkaq, prokurori Beqiri kishte deklaruar “I kfishet o”, e i akuzuari kishte thënë se prokurori e gjykatësi e njohin prej para lufte. Mirëpo, një gjë të tillë e kishin mohuar edhe prokurori edhe gjykatësi.

Prokurori Beqiri i kishte thënë të akuzuarit “prano se s’ki ka ja man”. Kurse, gjykatësi Makolli, me këtë rast i kishte thënë të akuzuarit “e merr ni kusht”. Prokurori Beqiri i kishte thënë të akuzuarit se nëse bëhet kundërshtimi i aktakuzës, procedura do të zgjatet më shumë. Ai më pas kishte thënë “Ndaq shkruje një kundërshtim, a din”, e i akuzuari e kishte pohuar një gjë të tillë. “Brenda 30 dite. Nëse don shkojmë drejt në gjykim, bohet ma shpejt ky veç formalitet o”, kishte prokurori Beqiri. E i akuzuari Nura kishte thënë “Qysh të vendos gjykata”. Kurse,

gjykatësi Makolli kishte thënë “Mirë o me hek dorë ky”. Ndërkaq prokurori Beqiri kishte thënë “Vijnë tre gjykatës, i ngojnë fjalët e tua e të miat, tani vendosin”. I akuzuari kishte thënë se më mirë pra është kështu dhe ai ka hequr dorë nga e drejta për të paraqitur kërkesën për hushje të aktakuzës e kundërshtimin e provave.

I akuzuari iu ishte drejtuar gjykatësit Makolli se nëse e pranon fajësinë çfarë kushti ia shqipton, ndërsa gjykatësi Makolli kishte thënë “Qashtu bonu djalë i mirë. Që po thom unë pranoje mos gabo me pranë. Pe caktojmë edhe nihere duhet me ardh, edhe dy edhe tre here”. Pas kësaj i akuzuari e kishte pranuar fajësinë, ndërsa pas 15 minutash, ishte shpallur edhe aktgjykimi, ku i akuzuari është dënues me 1 vit burgim me kusht, mirëpo dënimi ndaj tij nuk do të ekzekutohet nëse i njëjti brenda periudhës prej dy vitesh nuk kryen vepër tjetër penale.

“Shumë o dy vjet zotëri gjykatës. Bone 1 prej 1, pse me nejt 2 vjet”, kishte thënë i akuzuari, pasi fillimisht gjykatësi kishte thënë se i akuzuari dënohet me 1 vit burgim me kusht dhe dënimi nuk do të ekzekutohet nëse i njëjti brenda periudhës prej dy viteve nuk kryen vepër tjetër penale. E më pas gjykatësi Makolli kishte ndryshuar kohëzgjatjen e periudhës verifikuese. “1 për 1 po të thom brenda një viti nëse nuk kryen vepër tjetër penale”, kishte thënë Makolli.

Ndërkaq, paraprakisht në fillim të kësaj seance, gjykatësi Makolli e ka pyetur prokurorin Beqiri se sa vjet është e dënueshme vepra penale, e prokurori ka thënë se deri në 10 vite. “Avokat s’ka nevojë”, ka thënë gjykatësi Makolli, e këtë ia kishte pohuar prokurori Beqiri.

Mirëpo, vepra penale për të cilën ngarkohet i akuzuari dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

I njëjti është njoftuar me të drejtën e tij që mund të mbrohet vet apo të angazhojë avokat e se gjykata mund t’i caktojë avokatin kur mbrojtja është e detyrueshme, e i njëjti nuk ka mundësi financiare për të angazhuar mbrojtës. Mirëpo, ai nuk është njoftuar se në bazë të nenit 58 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata mund t’i caktojë avokat me shpenzime publike edhe kur mbrojtja nuk është e detyrueshme

Paragrafi i parë i këtij neni thotë se “Kur nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtjen e detyruar, të pandehurit i caktohet mbrojtës me shpenzime publike me kërkesën e tij”.

E kjo nëse nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtje të detyrueshme e procedura penale zhvillohet për vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim me tetë (8) ose më shumë vjet.

Gjithashtu, avokati mund t’i caktohet edhe kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë pavarësisht nga dënimi parashikuar, të dyshuarit apo të pandehurit me kërkesën e tij i caktohet mbrojtësi, në qoftë se sipas gjendjes pasurore të tij nuk mund t’i përballojë shpenzimet e mbrojtjes së tij.

Ndërkaq, sipas nenit 248 të Kodit të Procedurës Penale, në pikën 1.2 të këtij neni thuhet se “Pranimi bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin, nëse i pandehuri ka mbrojtës”.

Tutje, në pikën 1.3 të këtij neni thuhet se “*Pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, siç është dëshmia e dëshmitarëve e paraqitur nga prokurori i shtetit ose i pandehuri*”.

Ndërsa, i akuzuari Nura gjatë kësaj seance është pajisur vetëm me aktakuzë dhe nuk ka pasur në dispozicion shkresat e tjera të lëndës, që përfshijnë provat që organi i akuzës ka ndaj të akuzuarit.

Lidhur me këtë situatë, neni 246.2 i KPPRK-së përcakton se “*Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues pastaj çmon nëse e drejta e të pandehurit në mbrojtës është respektuar dhe nëse prokurori i shtetit ka përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave nga neni 244 i këtij Kodi*”.

Ndryshe, në mes të seancës gjykatësi Makolli i është drejtuar monitorueses së “Betimi për Drejtësi” duke i thënë “A pi qet krejt qito, mos na qit krejt qito”⁶³.

Në këtë rast, gjithashtu është shkelur edhe neni 30 i Kushtetutës së Kosovës, ku thuhet se çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

Në rastin e Nurës, gjykatësi ka shkelur prezumimin e fajësisë meqenëse edhe pasi i akuzuari kishte mohuar fajësinë e tij, pasi prokurori i kishte thënë të akuzuarit “Pranoje se s’ki ka ja man”, gjykatësi i kishte thënë “E merr ni kusht”, duke aluduar se i akuzuari është fajtor, edhe pse ishte fillimi i shqyrtimit fillestar, nuk ishte bërë shqyrtimi i provave në procedurë dhe ende nuk ishte dëshmuar pafajësia apo fajësia e të akuzuarit dhe si është cekur më lartë asesi pranimi i fajësisë nuk duhet të bëhet në presion apo në mënyrë të pavullnetshme.

⁶³ “Prano se s’ki ka ja man”, prokurori e gjykatësi ndikojnë në të akuzuarin ta pranojë fajësinë, dënohet me burgim me kusht”. Betimi për Drejtësi. 15 tetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prano-se-ski-ka-ja-man-prokurori-e-gjykatesi-ndikojne-ne-te-akuzuarin-ta-pranoje-fajesine-denohet-me-burgim-me-kusht/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

4. Rasti ku gjykatësi kundërligjshëm rihapi shqyrtimin fillestar pasi prokurorja kishte hequr dorë nga akuza

Gjykata Themelore në Pejë

Numri i lëndës: PKR.nr.43/2011

Vepra penale: “Blerja, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike”

Kryetari i Trupit Gjykses: Sylë Lokaj

Prokuror : Sahide Gashi, Valbona Disha - Haxhosaj

I pandehur: Nexhmedin Krasniqi

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar

Nga ngritja e aktakuzës deri në aktgjykimin përfundimtar kanë kaluar 3226 ditë ose 8 vite e 6 muaj

Sipas aktakuzës së ish-Prokurorisë Publike Komunale të ngritur më 23 nëntor 2010, Nexhmedin Krasniqi akuzohet se më 27 prill 2010, pa autorizim ka poseduar me qëllim të shitjes, substanca narkotike.

Në aktakuzë thuhet se rasti ka ndodhur në atë mënyrë që pas informatave paraprake të policisë me urdhëresë të Gjykatës është bërë bastisja e shtëpisë së të pandehurit dhe në tualet janë gjetur një qese që kanë rezultuar me përbërje të marihuanës, në sasi 0.98 gram, fara kanabisi dhe heroinë në sasi 0.35 gramë.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Më 28 prill 2010, është parashtruar kallëzimi penal për këtë rast dhe në po të njëjtën ditë ishte nxjerrë edhe aktvendimi për fillim të hetimeve nga ana e organit të ndjekjes. Ndërsa aktakuza ishte ngritur më 22 nëntor 2010, por gjykatës i janë dashur 8 vite që të mbajë shqyrtimin fillestar me 20 shtator 2018, edhe pse sipas nenit 242 par.4 të KPPK-së shqyrtimi fillestar duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës. Mirëpo kjo kishte ndodhur për shkak se i akuzuari kishte qenë i paarritshëm për gjykatën.

IKD ka gjetur se në seancën e 20 shtatorit 2019, prokurorja Valbona Disha - Haxhosaj e kishte bërë rikualifikimin e veprës penale nga posedimi i narkotikëve me qëllim të shitjes, që parashihej me Kodin e Përkohshëm Penal, në veprën penale të posedimit të narkotikëve, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Vepra penale e posedimit të narkotikëve, pa qëllim shitje, nuk parashihej në Kodin Penal në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale. Pra, me këtë rast prokurorja e rastit e ka ngarkuar të pandehurin me një vepër e cila në kohën e kryerjes së veprës penale, nuk ka qenë e inkriminuar si vepër penale.

Pas ricilësimit të veprës penale, prokurorja Dishaj-Haxhosaj kishte hequr dorë nga ndjekja penale me arsyetimin se ka arritur afati i parashkrimit absolut për veprën penale të posedimit të

narkotikut, edhe pse i akuzuari për këtë vepër penale e kishte pranuar fajësinë, por ka rezultuar se ricilësimi nënkuptonte se vepra penale ishte parashkruar.

Pas heqjes dorë nga akti akuzues, palët ishin larguar nga Gjykata me bindjen se ky rast tanimë ka përfunduar. Të paktën, ligjërisht ashtu duhet të jetë.

Por, këtë ricilësim e ka refuzuar GjTh në Pejë, pasi që sipas gjyqtarit është konstatuar se prokurorja kishte gabuar kur e ka ricilësuar veprën penale me një vepër që nuk parashihej me Kodin e Përkohshëm Penal, i cili ishte në fuqi në kohën kur pretendohet se i akuzuari e ka kryer veprën.

Pasi është vërejtur gabimi në ricilësimin e kësaj vepre, gjykatësi Sylë Lokaj, kishte thënë për “Betimi për Drejtësi”, se do ta hap sërish shqyrtimin ndaj të akuzuarit në këtë rast.⁶⁴

Kështu, gjykatësi Sylë Lokaj edhe pse prokurorja Haxhosaj kishte heqë dorë nga akuza pasi ishte bërë parashkrimi absolut i veprës së ricilësuar, e ka hapur përsëri gjykimin dhe i pandehuri është gjykuar. Pasi është rihapur shqyrtimi fillestar, prokuroria kishte mbetur pranë aktakuzës burimore dhe kualifikimit juridik nga neni 229, paragrafi 1 i KPPK-së, e më pas i akuzuari kishte pranuar fajësinë. Pra, prokurorja kishte mbrojtur në gjykatë një aktakuzë, nga e cila paraprakisht ishte tërhequr.

Pasi i akuzuari e kishte pranuar fajësinë vetëm për posedim, me 23 shtator 2019, gjykata e kishte dënuar të pandehurit për posedim me qëllim shitje. Pra, Gjykata mbi bazën e pranimin të fajësisë, e kishte dënuar të pandehurin për një vepër penale për të cilën i njëjti nuk e kishte pranuar fajësinë. Dënimi i shqiptuar ishte dënim me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 muajsh, i cili dënim me pëlqim të akuzuarit është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 500 eurosh.

Si rrjedhojë e analizës dhe emisionit të publikuar nga ana e Betimi për Drejtësi për këtë rast, Prokuroria Themelore në Pejë përmes Zyrës së Kryeprokurorit kishte bërë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në favor të pandehurit duke kërkuar që Gjykata Supreme të prish vendimin e Gjykatës së Pejës dhe të konstatojë parashkrimin e veprës. Në këtë kërkesë të përpiluar nga ana e prokurores Sahide Gashi thuhet se kërkohet inicimi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të shkeljes së ligjit material, si dhe shkeljes esenciale të Kodit të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1 i këtij kodi.

Në këtë kërkesë elaborohet ricilësimi i veprës penale nga ana e prokurores si dhe thuhet se është interpretuar gabimisht neni 3 i Kodit të ri Penal, sikurse parimi i ligjshmërisë nga neni 2 i këtij kodi, për faktin se Kodi i Përkohshëm Penal që kishte qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale nuk e ka inkriminuar “posedimin e paautorizuar të narkotikëve, substancave

⁶⁴ “Gjykata “përmirëson gabimin” e prokurores që ricilësoi jashtëligjshëm veprën penale, pas së cilës arrihej parashkrimi”. Betimi për Drejtësi. 20 shtator 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-permireson-gabimin-e-prokurores-qe-ricilesoi-jashteligjshem-vepren-penale-pas-se-ciles-arrihej-parashkrimi-absolut/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

psikotrope ose analoge”. Si rrjedhojë e kësaj, thuhet se gjykata ka rihapur shqyrtimin fillestar më 23 shtator 2019, në kundërshtim me nenin 245, e sidomos nenin 52 të KPP-së, me arsyetim se duhet sqaruar ligjshmëria e rikualifikimit të veprës penale nga ana e prokurorisë në rastin konkret.

Tutje, thuhet se gjithashtu është thirrur gabimisht në dispozitat e nenit 357 të KPP-së, edhe pse me tërheqjen e prokurorit ka mbetur pa objekt shqyrtimi, si dhe dispozitat në fjalë qartazi kanë të bëjnë vetëm me shqyrtim kryesor dhe atë pas një procedure të administrimit të provave e assesi nuk kanë të bëjnë me shqyrtim fillestar, në të cilën fazë vetëm vlerësohet bazueshmëria e aktakuzës dhe provave mbi të cilën është mbështetur ajo.

Prokurorja Gashi kishte konsideruar se të gjitha shkeljet janë bërë në dëm të tanimë të dënuarit dhe kishte propozuar që të iniciohet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatë Supreme, me propozim që e njëjta pas aprovimit të kërkesës në fjalë, ta ndryshojë vendimin e formës së prerë, ashtu që të marr aktgjykim refuzues konform nenit 438, paragrafit 1, nën paragrafit 1.1.

Më 23 mars të vitit 2019, Gjykata Supreme e kishte hedhur si të papranueshme kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Kjo gjykatë këtë kërkesë e kishte konsideruar të papranueshme.

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës kishte konstatuar se kjo kërkesë është e papranueshme meqenëse kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore, e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë. Ndërkaq, sipas dispozitës së nenit 423, paragrafit 4 të KPPK-së, sipas kësaj gjykate, gjatë procedurës penale që nuk ka përfunduar në formë të prerë, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin ose vazhdimin e paraburgimit.

Sipas kësaj gjykate, me shikim e shkresave të lëndës, ishte gjetur se aktgjykimi i shkallës së parë nuk kishte marrë formën e prerë sepse nuk i është dorëzuar asnjëherë të dënuarit, e çka vërtetohet nga shkresat e çështjes, sepse në shkresa gjendet fletëkthesa, respektivisht zarfi me aktgjykimin e shkallës së parë, në të cilin konstatohet se dorëzimi është tentuar, por pa sukses.

Mirëpo, anëtarja e kolegjit të Supremes, gjyqtarja Mejreme Memaj, kishte shkruar një mendim mospajtues. Ajo kishte thënë se meqenëse me aktgjykimin e atakuar del qartazi se është shkelur ligji penal në dëm të pandehurit ngase pasi prokurorja ka hequr dorë nga ndjekja penale për veprën e ricilësuar, gjykata është dashur të merr aktgjykim refuzues e jo të rihap çështjen dhe të dënojë të pandehurin, konsideron se është në interes të drejtësisë në përgjithësi dhe të pandehurit në veçanti që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur në dobi të pandehurit të aprovohet e jo të hedhet e papranueshme për faktin se aktgjykimin nuk ka marrë formë të prerë për shkak se nuk i është dorëzuar të pandehurit.

Ky rast paraqet shkelje direkte të të drejtave të njeriut dhe manifeston eksperimentet e prokurorisë në dëm të pandehurve, si dhe shkeljen e dispozitave ligjore nga ana e gjykatës, ku

si pasojë është dëmtuar i pandehuri në procedurë. Për më tepër, veprime të tilla shkatërrojnë sigurinë juridike të qytetarëve në një procedurë të caktuar në sistemin e drejtësisë, si dhe minojnë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Në këtë rast me anë të rikualifikimit të veprës penale me një vepër që nuk ka ekzistuar në kohën e kryerjes së veprës penale është shkelur neni 33 i Kushtetutës, i cili përcakton se “askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit”. Për më tepër, ky është një ndër postulatet kryesore të drejtësisë.

Pas emisionit të “Betimi për Drejtësi”, ku është trajtuar ky rast, U.D Kryetari i Gjykatës së Pejës ka filluar procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit Lokaj, dhe ka bërë kërkesë në KGJK që të themelohet paneli hetimor. Aktualisht ky rast është duke u zhvilluar në KGJK. Ndërkaq, edhe Kryeprokurori i Prokurorisë në Pejë ka konfirmuar se është hapur rast ndaj prokurores, mirëpo se i njëjti është pezulluar për shkak të pandemisë⁶⁵.

⁶⁵ “Ish-kryetari i Supremes: Rihapja e çështjes pas tërheqjes së prokurores nga aktakuza, vendim jo me ligj, por me “malik” (Video)”. Betimi për Drejtësi. 9 nëntor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-supremes-rihapja-e-ceshtjes-pas-terheqjes-se-prokurores-nga-aktakuza-vendim-jo-me-ligj-por-me-maliqu/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

10. ANEX II: Trajtimi i detajuar i rasteve të kthyer në rigjykim

1. Rasti i vrasjes së dyfishtë në Gjakovë

Gjykata Themelore në Gjakovë

Numri i lëndës: PKR.nr.43/19

Vepra penale: “Vrasje e rëndë”, “Mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve”

Kryetari i Trupit Gjykses: Gëzim Pozhegu

Prokuror: Agron Matjani, Ali Uka

I pandehur: Pjeter Ndrecaj

Faza e procedurës: Në proces pas rigjyimit

Nga ngritja e aktakuzës e deri me 31 dhjetor 2019, kanë kaluar 461 ditë apo 1 vit e tre muaj)

Me 7 gusht 2018, në fshatin Brekoc të Komunës së Gjakovës, i akuzuari Pjeter Ndrecaj me dashje kishte privuar nga jeta në shtëpinë e familjes së viktimës, bashkëshorten e tij V.N, dhe vajzën e tij K.N. Një ditë më vonë, me 8 gusht 2018, Prokuroria Themelore në Gjakovë, kishte marrë aktvendim për fillimin e hetimeve, me pretendimin se ai ka kryer veprën penale “vrasje e rëndë”.

Të nesërmen me 9 gusht 2018, ku ishte paraparë të mbahej seanca dëgjimore ndaj tij për caktimin e masës së paraburgimit, atij u ishte përkeqësuar gjendja shëndetësore, pasi ai aty e kishte kuptuar se përveç gruas e kishte privuar nga jeta edhe vajzën e tij nëntë vjeçare.⁶⁶

Mirëpo, pas përmirësimit të gjendjes së tij, me urdhëresë të prokurorisë ai ishte dërguar në Qendrën Psikiatrike në Prishtinë, ndërsa me 10 gusht 2018, Gjykata Themelore në Gjakovë, i'a kishte caktuar masën e paraburgimit prej një muaji, ku seanca dëgjimore ishte mbajtur në Spitalin Rajonal të Gjakovës “Isa Grezda”, në repartin e psikiatrisë, pasi psikiatri kishte konstatuar se Ndrecaj kishte kaluar stresin akut dhe se ishte në gjendje të merrte pjesë në seancë.⁶⁷

⁶⁶ “Për shkak të përkeqësimit të shëndetit, ndërpritet seanca ndaj të dyshuarit për vrasjen e ish-gruas dhe vajzës së tij”. Betimi për Drejtësi. 9 gusht 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/per-shkak-te-perkeqesimit-te-shendetit-nderpritet-seanca-degjimore-ndaj-te-dyshuarit-per-vrasjen-e-ish-gruas-dhe-vajzes-se-tij/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁶⁷ “Seanca mbahet në spital, i dyshuari thotë se ndien keqardhje për vrasjen e dyfishtë, i caktohet një muaj paraburgim”. Betimi për Drejtësi. 10 gusht 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/seanca-mbahet-ne-spital-i-dyshuari-thote-se-ndien-keqardhje-per-vrasjen-e-dyfishte-i-caktohet-nje-muaj-paraburgim/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

Kjo masë Ndrecajt iu ishte vazhduar edhe për dy muaj tjerë, pasi sipas aktvendimit për vazhdimin e paraburgimit, i dyshuari do të qëndrojë në këtë masë nga 6 shtatori deri më 5 nëntor 2018.⁶⁸

Me 26 shtator 2018, Prokuroria Themelore Gjakovë kishte ngritur aktakuzë ndaj tij për shkak të veprës penale “vrasje e rëndë” nga 179 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.3 dhe 1.11 të KPRK-së, dhe për veprën penale “mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve” nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së.⁶⁹

Në aktakuzë thuhet se ai kishte shkuar në shtëpinë e vëllezërve të viktimës i armatosur, ku kishte qëlluar më pushkën automatike në drejtim të shtëpisë, duke qëlluar për vdekje bashkëshorten dhe vajzën e tij.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Aktakuza ndaj Ndrecajt ishte ngritur me 26 shtator 2018, ndërsa shqyrtimi fillestar ishte caktuar me brenda afatit me 24 tetor 2018, mirëpo e njëjta seancë ishte ndërprerë për shkak se mbrojtësja e të akuzuarit Ndrecajt, avokatja, Fehmije Zhubi, kishte propozuar që të shkohet në negociimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, propozimin i cili ishte aprovuar nga trupi gjykues, i kryesuar nga gjykatësi Gëzim Pozhegu.⁷⁰

Mirëpo, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Ali Selimaj, nuk kishte dhënë leje që të negociohet marrëveshja për pranimin e fajësisë, pasi sipas tij i akuzuari ishte recidivist, duke e kryer veprën penale një muaj pasi kishte dalë nga paraburgimi.⁷¹ Në seancën e 31 tetorit 2018, Ndrecajt e kishte pranuar fajësinë duke thënë se vajzën e tij nëntë vjeçare e kishte vrarë në mënyrë aksidentale dhe se i vjen keq për rastin që ka ndodhur.⁷²

⁶⁸ “I vazhdohet edhe për dy muaj paraburgimi të dyshuarit për vrasjen e ish-gruas dhe vajzës së tij”. Betimi për Drejtësi. 5 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-vazhdohet-edhe-per-dy-muaj-paraburgimi-te-dyshuarit-per-vrasjen-e-ish-gruas-dhe-vajzes-se-tij/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁶⁹ “Ngritet aktakuzë për vrasjen e ish-bashkëshortes dhe vajzës në Gjakovë”. Betimi për Drejtësi. 27 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ngritet-aktakuze-per-vrasjen-e-ish-bashkeshortes-dhe-vajzes-ne-gjakove/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁷⁰ “Vrasja e dyfishtë në Gjakovë, shkon në negociim marrëveshja për pranimin e fajësisë”. Betimi për Drejtësi. 24 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/vrasja-e-dyfishte-ne-gjakove-shkon-ne-negocim-marreveshja-per-pranimin-e-fajesise/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁷¹ “Kryeprokurori i Gjakovës refuzon negociimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë në rastin e të akuzuarit për vrasjen e dyfishtë”. Betimi për Drejtësi. 25 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryeprokurori-i-gjakoves-refuzon-negocimin-e-marreveshjes-per-pranimin-e-fajesise-ne-rastin-e-te-akuzuarit-per-vrasjen-e-dyfishte/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁷² “Pranon fajësinë i akuzuari për vrasjen e dyfishtë në Gjakovë, thotë se vrasja e vajzës së tij ishte aksidentale”. Betimi për Drejtësi. 31 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pranon-fajesine-i-akuzuari-per-vrasjen-e-dyfishte-ne-gjakove-thote-se-vrasja-e-vajzes-se-tij-ishte-aksidentale/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

Pas dy ditësh, me 2 nëntor 2018, Gjykata Themelore në Gjakovë e kishte dënuar Ndrecajn me 24 vite burgim efektiv, 23 vite burgim për vrasje të dyfishtë, dhe me 2 vite burgim për armëmbajtje pa leje.⁷³

Mirëpo të pakënaqur me këtë dënim, i akuzuari Ndrecaj me 31 janar 2019, kishte kërkuar zbutje të dënimit, ndërsa Prokuroria Themelore në Gjakovë kishte kërkuar burgim të përjetshëm⁷⁴.

Pas dy muajve, përkatësisht me 1 mars 2019, Gjykata e Apelit kishte ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë, duke e dënuar Ndrecaj me burgim të përjetshëm, pasi sipas kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë, nuk i kishte vlerësuar në mënyrë të drejtë rrethanat rënduese dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe dënimi unik prej 24 viteve burgim, nuk ishte adekuat me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit⁷⁵.

Në qershor të vitit 2019, Gjykata Supreme e Kosovës, i kishte anuluar dy aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë dhe çështjen ia ka kthyer gjykatës së shkallës së parë në rivendosje. Sipas Supremes, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe se gjykata e shkallës së dytë, në pranimin e këtyre defekteve, në procedurën e pranimin të fajësisë, ka qenë e detyruar që aktgjykimin ta shqyrtojë dhe ta anulojë atë, e jo të kalojë mbi këtë shkelje, e cila është e pranishme dhe që kushtëzon cilësimin juridik, ngase mund të bëhet fjalë për vrasje të rëndë nga neni 179 par.1 nënp.1.11. të KPK-ës, vetëm nëse dy e më shumë vrasje janë kryer me dashje.

“Gjykata Supreme, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale, bazuar në faqen e tretë të procesverbalit të shqyrtimit fillestar, ka gjetur se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është në kundërshtim të plotë me dispozitivin e aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë, pasi që akuzohet se ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë, e cila kryhet në rastet kur me dashje kryhen dy apo më shumë vrasje, kurse deklarimi i tij është vetëm përkitazi me vrasjen e ish-bashkëshortes së tij, ashtu që i akuzuari pas leximit të aktakuzës dhe pas konsultimit me mbrojtësin e tij, kishte deklaruar se: “E pranoj fajësinë për vrasjen e ish gruas time, mirëpo vajzën e kam vra aksidentalisht”, thuhet në komunikatën e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.”⁷⁶

⁷³ “Dënohet me 24 vite burgim i akuzuari për vrasjen e dyfishtë në Gjakovë”. Betimi për Drejtësi. 2 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-24-vite-burgim-i-akuzuari-per-vrasjen-e-dyfishte-ne-gjakove/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁷⁴ “Prokuroria kërkon burg të përjetshëm ndaj të dënuarit për vrasjen e gruas e të vajzës së tij, ai kërkon nga Apeli zbutje të dënimit”. Betimi për Drejtësi. 31 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-kerkon-burg-te-perjetshem-ndaj-te-denuarit-per-vrasjen-e-gruas-e-te-vajzes-se-tij-ai-kerkon-nga-apeli-zbutje-te-denimit/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁷⁵ “Apeli e dënon me burg të përjetshëm të akuzuarin për vrasjen e gruas e vajzës së tij”. Betimi për Drejtësi. 1 mars 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-denon-me-burg-te-perjetshem-te-akuzuarin-per-vrasjen-e-gruas-e-vajzes-se-tij/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁷⁶ “Gjykata Supreme kthen në rigjykim rastin e të dënuarit me burgim të përjetshëm për vrasjen e gruas dhe vajzës së tij”. Betimi për Drejtësi. 24 qershor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-supreme-kthen-ne-rigjykim-rastin-e-te-denuarit-me-burgim-te-perjetshem-per-vrasjen-e-gruas-dhe-vajzes-se-tij/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

Pas tre muajsh, me 12 shtator 2019, është mbajtur seanca e rigjykimit, ku i akuzuari Ndrecaj e kishte mohuar fajësinë duke thënë se vrasja kishte ndodhur aksidentalisht, ndërsa mbrojtja e tij kishte kërkuar që të hudhet poshtë aktakuza si e pabazuar.⁷⁷

Ky rast është akoma në proces.

⁷⁷ “Rigjykimi ndaj të akuzuarit për vrasjen e gruas dhe vajzës së tij, mbrojtja kërkon hudhjen e aktakuzës dhe raport të ri psikiatrik, kundërshton prokuroria dhe pala e dëmtuar”. Betimi për Drejtësi. 14 tetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rigjykimi-ndaj-te-akuzuarit-per-vrasjen-e-gruas-dhe-vajzes-se-tij-mbrojtja-kerkon-hudhjen-e-aktakuzes-dhe-raport-te-ri-psikiatrik-kundershton-prokuroria-dhe-pala-e-demtuar/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

2. Rasti ndaj të akuzuarit për terrorizëm që u kthye dy herë në rigjykim

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.161/18

Vepra penale: “Organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste”

Kryetari i Trupit Gjykses: Vesel Ismaili

Prokuror special: Elez Blakaj, pastaj Valdet Gashi

I pandehur: Nexhat Ademi

Faza e procedurës: Në proces në shkallë të parë pas rigjykimit

Nga ngritja e aktakuzës e deri më 31 dhjetor kanë kaluar 1112 ditë apo mbi 3 vite

Ademi akuzohej se më 17 janar 2014, kishte udhëtuar nga Aeroporti i Prishtinës për në Stamboll, e pastaj nga Stambolli ka udhëtuar për në qytetin Gazientep të Turqisë, afër kufirit me Sirinë, nga aty ka arritur të kaloj në territorin e Sirisë me dashje që t’i bashkohet dhe të bëhet pjesë e organizatës “Al Nusra”. Sipas aktakuzës, i pandehuri Ademi, pasi që ka qëndruar një javë në Siri është kthyer në Kosovë.

Prokuroria pretendon se Ademi më 4 mars 2016, kishte provuar që përsëri të shkoi në Siri, duke shfrytëzuar rrugën Shkup-Stamboll, mirëpo i njëjti pasi mbërrin në Aeroportin e Stambollit, autoritetet turke e ndalojnë, e pastaj e dëbojnë për shkak të lidhjes së tij me zonën e luftës.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Kallëzimi penal ndaj Ademit ishte parashtruar me 31 maj 2016, ndërsa në të njëjtën ditë PSRK kishte nxjerrë aktvendimin për fillim të hetimeve, derisa me 14 dhjetor 2016, PSRK kishte ngritur aktakuzë ndaj Ademit.

Pasi aktakuza ishte ngritur me 14 dhjetor 2016, seanca fillestare ishte caktuar të mbahej me 3 korrik 2017, apo pas mbi 6 muajve pas ngritjes së aktakuzës, por se për shkak të mungesës së të akuzuarit, seanca nuk kishte arritur të mbahej⁷⁸.

Ndërsa seanca fillestare e 12 shtatorit 2017, kishte arritur të mbahej, në të cilën i akuzuari ishte deklaruar i pafajshëm, duke theksuar se e kishte bërë të kundërtën e asaj që akuzohet, duke u bërë thirrje të rinjve për të mos shkuar në Siri⁷⁹.

⁷⁸ “Nuk paraqitet në gjykatë i akuzuari për pjesëmarrje në organizatën terroriste ISIS”. Betimi për Drejtësi. 3 korrik 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/nuk-paraqitet-ne-gjykate-i-akuzuari-per-pjesemarrje-ne-organizaten-terroriste-isis/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁷⁹ “Deklarohet i pafajshëm i akuzuari për organizim dhe pjesëmarrje në grupe terroriste”. Betimi për Drejtësi. 12 shtator 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohet-i-pafajshem-i-akuzuari-per-organizim-dhe-pjesemarrje-ne-grupe-terroriste/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

Seanca e shqyrtimit të dytë ishte caktuar të mbahej me 16 tetor 2017, brenda afatit ligjor, mirëpo e njëjta kishte dështuar për shkak të mungesës së të akuzuarit, ndaj të cilit ishte lëshuar urdhëresë për sjellje me detyrim⁸⁰.

Shqyrtimi i dytë ishte caktuar me 19 dhjetor 2017, mirëpo mbrojtësi i të akuzuarit Ademi, avokati Sabedin Cena kishte hequr dorë nga ky shqyrtim për shkak të ekonomizimit të çështjes, pasi sipas tij kishin kaluar gjashtë muaj nga seanca fillestare. Në këtë seancë Ademi kishte shfrytëzuar të drejtën ligjore për tu mbrojtur në heshtje.⁸¹

Në seancën e 26 janarit 2018, me kërkesë të avokatit Cena, ishte caktuar ekzaminim psikiatrik ndaj Ademit, për shkak se sipas avokatit, i njëjti vuan nga një lloj depresioni, dhe se kishte probleme shëndetësore.⁸²

Me 12 mars 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë Ademin e kishte shpallur fajtor për terrorizëm dhe e kishte dënuar me tre vite burgim, ndërsa iu ishte ndërprerë paraburgimit nga 9 janari 2018, deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.⁸³

Mirëpo me 14 qershor 2018, mbrojtësi i tij, avokati Sabedin Cena kishte kërkuar nga Gjykata e Apelit lirim të tij nga akuza me pretendimet se nuk ishte arritur të vërtetohej fajësia, dhe se aktgjykimi i shkallës së parë ishte nxjerr me shkelje të dispozitave procedurale dhe se në të nuk ishin paraqitur fare arsytet në lidhje me faktet vendimtare.⁸⁴

Këto pretendime i kishte marrë për bazë Gjykata e Apelit e cila e kishte prishur aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe rastin e kishte kthyer në rigjykim. Edhe pas rigjykimit, i akuzuari Ademi kishte mundur në seancën e 3 dhjetorit 2018, ndërsa në seancën e 15 janarit i akuzuari për të dytën herë e kishte mohuar fajësinë dhe ishte mbrojtur në heshtje.⁸⁵

Me 12 mars 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, Ademin e kishte shpallur fajtor për të dytën herë, mirëpo kësaj here ia kishte zbutur dukshëm dënimin, nga tre vite burgim efektiv, në dy

⁸⁰ “Dështon gjykimi për terrorizëm, për të akuzuarin lëshohet urdhëresë për sjellje me detyrim”. Betimi për Drejtësi. 16 tetor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshton-gjykimi-per-terrorizem-per-te-akuzuarin-leshohet-urdherese-per-sjelljen-me-detyrim/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁸¹ “Mbrohjet në heshtje i akuzuari për organizim dhe pjesëmarrje në grupe terroriste”. Betimi për Drejtësi. 19 dhjetor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mbrohet-ne-heshtje-i-akuzuari-per-organizim-dhe-pjesemarrje-ne-grupe-terroriste/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁸² “Caktohet ekzaminim psikiatrik për të akuzuarin për terrorizëm, ai kërkon të dërgohet në një qendër tjetër paraburgimi”. Betimi për Drejtësi. 26 janar 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/caktohet-ekzaminim-psikiatrik-per-te-akuzuarin-per-terrorizem-ai-kerkon-te-dergohet-ne-nje-qender-tjeter-paraburgimi/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁸³ “Dënohet me tre vjet burgim për organizim dhe pjesëmarrje në grupet terroriste në Siri”. Betimi për Drejtësi. 12 mars 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-tre-vjet-burgim-per-organizim-dhe-pjesemarrje-ne-grupet-terroriste-ne-siri/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁸⁴ “Mbrojtja e të akuzuarit për terrorizëm kërkon nga Apeli lirim të tij nga akuza”. Betimi për Drejtësi. 14 qershor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mbrojtja-e-te-akuzuarit-per-terrorizem-kerkon-nga-apeli-lirimin-e-tij-nga-akuza/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁸⁵ “Rigjykimi për terrorizëm, i akuzuari sërish deklarohet i pafajshëm, thotë se do të mbrohet në heshtje”. Betimi për Drejtësi. 15 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rigjykimi-per-terrorizem-i-akuzuari-serish-deklarohet-i-pafajshem-thote-se-do-te-mbrohet-ne-heshtje/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

vite burgim me kusht i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse ai brenda periudhës prej tre vitesh nuk kryen ndonjë vepër penale. Atij iu është ndërprerë edhe masa e paraburgimit.⁸⁶

Kundër këtij aktgjykimi, PSRK kishte parashtruar ankesë, të cilën ankesë e kishte aprovuar Gjykata e Apelit e cila me 8 gusht 2019, rastin e kishte kthyer në rigjykim dhe rivendosje duke anuluar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Sipas Apelit, aktgjykimi i shkallës së parë përpos që është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata e shkallës së parë kishte shqiptuar dënim nën minimumin e përcaktuar me ligj, duke mos dhënë asnjë arsye se cilat kishin qenë rrethanat veçanërisht lehtësuese që kishte shqiptuar dënim të kushtëzuar dhe nuk kishte aplikuar dispozitat për zbutjen e dënimit.

Gjatë vitit 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, pas kthimit të lëndës për të dytën herë në rigjykim, nuk ka caktuar asnjë seancë.

⁸⁶ “Pas kthimit në rigjykim, dënohet me dy vjet burgim me kusht i akuzuari për terrorizëm”. Betimi për Drejtësi. 12 mars 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-kthimit-ne-rigjykim-denohet-me-dy-vjet-burgim-me-kusht-i-akuzuari-per-terrorizem/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

3.Rasti Çekiçi

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.257/16

Vepra penale: “Vrasje e rëndë”

Kryetari i Trupit Gjykses: Vesel Ismaili

Prokuror special: Fikrije Fejzullahu

Të pandehur: Gëzim Retkoceri, Osman Spahiu

Faza e procedurës: Në proces në shkallë të parë

Nga ngritja e aktakuzës e deri me 31 dhjetor 2019, kanë kaluar 3631 ditë, apo 9 vite e 11 muaj

Prokuroria Themelore në Prishtinë, aktakuzën ndaj Gëzim Retkocerit dhe Osman Spahiut e kishte ngritur me 21 janar 2010, për shkak të veprës penale “vrasje e rëndë”. Sipas prokurorisë, dy të akuzuarit më 29 prill të vitit 2009, me qëllim që vetit t’i sjellin dobi pasurore, e kishin rrëmbyer tani të ndjerin Naim Hajrizin, me qëllim që ta privojnë nga jeta.

Në aktakuzë thuhet se tani të ndjerin e kishin goditur me mjete të forta në kokë, duke ia lidhur këmbët dhe duart, pastaj e kishin vlarë dhe e kishin dërguar në një lokacion ndërmjet fshatit Smallushë dhe Dobratin dhe për të fshehur gjurmët, e kishin djegur trupin e tij.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Kallëzimi penal në këtë rast ishte parashtruar me 2 maj 2009, ndërsa aktakuza ishte ngritur me 21 janar 2010. Fillimisht ky rast kishte përfunduar në vitin 2015, ku Gjykata Themelore në Prishtinë pas disa seancave të mbajtura me 7 korrik të vitit 2015, dy të akuzuarit i kishte dënuar me nga 30 vite burgim, mirëpo pas ankesave të mbrojtjes ky rast ishte kthyer në rigjykim me 4 maj 2016, pasi Gjykata e Apelit kishte gjetur shkelje ligjore në vendimin e marrë nga gjykata e shkallës së parë.

Me rastin e kthimit në rigjykim, Gjykata e Apelit, kishte konstatuar se Gjykata Themelore në Prishtinë kishte shkelur dispozitat e procedurës penale dhe se dispozitivi i aktgjyimit nuk ishte hartuar ashtu siç parashihet me Kodin e Procedurës Penale. Që nga kthimi në rigjykim, IKD për këtë rast ka monitoruar gjithsej 18 seanca, prej të cilave vetëm dy prej tyre janë shtyrë, ndërsa 16 janë mbajtur.

Që kur ky rast është kthyer në rigjykim, vazhdimisht ky rast penal është përcjellë me tensione në mes familjes së të dëmtuarit Hajrizi dhe familjarëve të dy të akuzuarve, e që ndikoi edhe në denoncimin në polici për kërcënimet e marra.⁸⁷

⁸⁷ “Rasti “Çekiçi”, tensione ndërmjet familjarëve të të vlarit dhe të akuzuarit për vrasjen e vitit 2009 në Lipjan”. Betimi për Drejtësi. 27 prill 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-cekiqi-tensione-ndermjet-familjareve-te-te-vlarit-dhe-te-akuzuarit-per-vrasjen-e-vitit-2009-ne-lipjan/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

Në seancën e mbajtur me 6 shtator 2017, babai i të akuzuarit Retkoceri, Nazmi Retkoceri kishte deklaruar se gjykata nuk e kishte ftuar për të dëshmuar njërën nga dëshmitarët i cili kishte qenë në dijeni për vrasjen për të cilën po akuzohet djali i tij, pasi sipas tij, me dëshminë e këtij dëshmitari do të zbardhet e vërteta në këtë rast.⁸⁸ Në seancën e 27 dhjetorit 2017, ishte dëgjuar eksperti mjeko-ligjor Arsim Gërxhaliu i cili kishte deklaruar se viktimë Naim Hajrizi në momentin e djegies së trupit kishte qenë ende gjallë, por sipas ekspertit vdekja e të ndjerit kishte ardhur si pasojë e goditjeve me një mjet i cili kishte mundur të ishte një çekan.⁸⁹

Pasi dëgjimit të dëshmitarëve të propozuar, Gjykata Themelore në Prishtinë, në seancën e 24 tetorit 2018, kishte vendosur që pas afër 10 vjetësh, të dilet në vendngjarje, konkretisht në auto-servisin “Cali”, ku pretendohet se janë gjetur gjurmët e vrasjes së Hajrizit. Ky vendim është marrë pas kërkesës së mbrojtës së të akuzuarit Retkoceri, avokates Kosovare Kelmendi, sipas së cilës për zbardhjen e këtij rasti ishte e nevojshme jo të bëhej rikonstruimi i vendit të ngjarjes, por vetëm të bëhet shikimi, për shkak të rrethanave të bastisjes së autoservisit “Cali”.⁹⁰

Me 9 korrik 2019, i akuzuari Spahiu kishte vendosur që pas 10 vitesh qëndrimi në paraburgim të deklarohet në hollësi për rastin për të cilin edhe po akuzohet.⁹¹ Ai në këtë seancë e kishte inkriminuar të akuzuarin e parë, Gëzim Retkoceri, për të cilat deklarime ka reaguar disa herë i akuzuari Retkoceri. Edhe seanca e 19 shtatorit 2019, është përcjellë me tensione, por këtë herë mes të akuzuarit Retkoceri dhe mbrojtësve së të akuzuarit Spahiu, avokatëve Ramë Dreshaj dhe Hidije Ademi. Ky tensionim kishte ardhur si pasojë e deklarimit të të akuzuarit Retkoceri i cili kishte thënë se me 17 maj 2017, i akuzuari Osman Spahiu, në emër të avokatëve të tij, i kishte kërkuar atij 50 mijë euro, me qëllimin që prokurorja e rastit, Fikrije Fejzullahu të tërhiqej nga aktakuza.⁹²

Ky rast edhe pas afër katër vitesh në rigjykim, akoma është në proces në shkallë të parë.

⁸⁸ “Babai i të akuzuarit për vrasje thotë se dëshmitari që ka dijeni për ngjarjen nuk u ftua të jap dëshmi asnjëherë”. Betimi për Drejtësi. 6 shtator 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/babai-i-te-akuzuarit-per-vrasje-thote-se-deshmitari-qe-ka-dijeni-per-ngjarjen-nuk-u-ftua-te-jap-deshmi-asnjehere/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁸⁹ “Rasti “Çekiqi”, eksperti mjekoligjor thotë se viktimë në momentin e djegies së trupit kishte qenë gjallë”. Betimi për Drejtësi. 27 dhjetor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-cekiki-eksperti-mjekoligjor-thote-se-viktima-ne-momentin-e-djegies-se-trupit-kishte-qene-gjalle/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁹⁰ “Gjykata vendos që të dilet në vendngjarje gati dhjetë vjet pas vrasjes në Lipjan”. Betimi për Drejtësi. 24 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-vendos-qe-te-dilet-ne-vendngjarje-gati-dhjetë-vjet-pas-vrasjes-ne-lipjan/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁹¹ “I akuzuari në rastin “Çekiqi” pas 10 vitesh në paraburgim deklarohet hollësisht për vrasjen e vitit 2009, në Lipjan”. Betimi për Drejtësi. 9 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-ne-rastin-cekiki-pas-10-vitesh-ne-paraburgim-deklarohet-hollesisht-per-vrasjen-e-vitit-2009-ne-lipjan/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁹² “I akuzuari në rastin “Çekiqi”: M’u kërkuar 50 mijë euro nga mbrojtja e të akuzuarit tjetër që prokurorja ta tërheq këtë aktakuzë”. 19 shtator 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-ne-rastin-cekiki-mu-kerkuan-50-mije-nga-mbrojtja-e-te-akuzuarit-tjetër-qe-prokurorja-ta-terheq-kete-aktakuze/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

4. Rasti Shega

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.130/19

Vepra penale: “Vrasje e rëndë”, “Vrasje e rëndë në tentativë”, “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, “falsifikim i dokumenteve”

Kryetari i Trupit Gjykses: Vesel Ismaili

Prokuror: Merrushe Llugiqi

Të pandehur: Besim Istrefi, Besart Istrefi, Jeton Saraçi

Faza e procedurës: Në proces në shkallë të parë

[Nga ngritja e aktakuzës e deri me 31 dhjetor 2019, kanë kaluar 2488 ditë, apo 6 vite e 9 muaj](#)

Kallëzimi penal në këtë rast ishte parashtruar me 03 maj 2014, ndërsa aktakuza ishte ngritur me 10 mars 2015. Sipas aktakuzës, në restorant “Shega” në Milloshevë të Obiliqit, më 2 maj 2014, pas një mosmarrëveshjeje të çastit ishin vrarë Nazim Gërvalla e Lutfi Saraçi, ndërsa kishin mbetur të plagosur rëndë pronari Besim Istrefi dhe djali i tij, Besart Istrefi, të akuzuar në këtë rast.

Në aktakuzë thuhet se e gjithë ngjarja kishte filluar kur kamerierët kishin filluar përgatitjen për mbylljen e lokalit, në të cilin i pandehuri Jeton Saraçi, kishte qenë në tavolinë së bashku me Adem Dautaj dhe tani të ndjerët Lutfi Saraçi dhe Nazim Gërvalla. Për këtë gjë, Saraçi kishte reaguar dhe kishte filluar fjalosjen mes tij me Besart Istrefin, ku më pas kishin nxjerrë revolet dhe ia kishin drejtuar njëri-tjetrit.

Sipas prokurorisë, pas telefonatës nga i biri, kishte ardhur në restorant edhe Besim Istrefi, i cili ua kishte drejtuar revolen, ku më pas e kishte shtënë nëntë herë në drejtim të tani të ndjerëve Lutfi Saraçi dhe Nazim Gërvalla.

Në ato çaste, sipas aktakuzës, kishte filluar një shkëmbim i të shtënave me armë nga të dyja palët, ku si pasojë e këtij shkëmbimi, plagë vdekjeprurëse kishin marrë tani i ndjeri Lutfi Saraçi dhe Nazim Gërvalla, ndërsa Besim dhe Besart Istrefi ishin lënduar rëndë.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Procesi gjyqësor me këtë rast kishte filluar në vitin 2017, ku në seancën e 6 korrikut 2017 ishte mbajtur seanca e parë e shqyrtimit kryesor, i cili kishte zgjatur për vite me radhë, dhe pas kthimit të lëndës në rigjykim, ky rast është akoma në proces.

Edhe pse vrasja kishte ndodhur në maj të vitit 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë kishte vendosur që pas katër vitesh të bëjë rikonstruimin e vendit të ngjarjes, me qëllim që të gjendet

e vërteta materiale se çfarë kishte ndodhur në ditën kritike.⁹³ Kështu, me 4 tetor 2018 kishte shpallur aktgjykimin në këtë rast, ku të akuzuarin Besim Istrefi e kishte dënuar me 7 vite burgim për vrasje, kurse me dënim unik prej pesë vjet e katër muaj burgim, është dënuar edhe djali i tij, Besart Istrefi, pasi është shpallur fajtor për dy vepra penale, atë të vrasjes dhe armëmbajtjes pa leje.

Kurse, i akuzuari i tretë Jeton Saraçi, është liruar nga akuzat për tentim vrasje dhe për armëmbajtje pa leje, si dhe ndaj tij është marr aktgjykim refuzues për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, për shkak të parashkrimit të veprës penale.

Po ashtu, trupi gjykues kishte vendosur që ta rikualifikojë veprën penale për dy të akuzuarit Istrefi, nga vrasje e rëndë në vrasje.⁹⁴

Mirëpo, Gjykata e Apelit, më 11 prill 2019, kishte marr aktvendim me të cilin çështjen e kishte kthyer në rigjykim, për shkak se sipas kësaj gjykate aktgjykimi i atakuar me ankesë është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke vlerësuar se të njëjtat ndikojnë në vërtetimin e gjendjes faktike. Sipas Apelit, dispozitivët e aktgjykimit janë në kundërshtim me arsyetimet sidomos tek pjesa liruese, sa i përket të akuzuarit Jeton Saraçi.

“Nëse lexohet me kujdes ky dispozitiv shihet se i akuzuari Jeton, me provat e administruara është iniciuesi i komplet rastit, ndërsa gjykata e shkallës së parë thekson se i njëjti ka nxjerr një revole të ngjyrës së zezë të tipit të panjohur dhe e ka drejtuar atë në drejtim të të akuzuarit Besart duke e sharë dhe duke e kërcënuar, ndërsa në anën tjetër e liron nga akuza me arsyetimin se nuk është provuar se i njëjti ka pasur armë” thuhej në aktvendimin e Apelit.

Gjykata e Apelit, ndër të tjera kishte kërkuar të bëhet administrimi i provave veç e veç, ku do të vërtetohet se Besim dhe Besart Istrefi a kanë vepruar në mbrojtje të nevojshme, gjegjësisht se a ka qenë sulmi i kundërligjshëm, a është dashur të zmbropsët nga të abuzuarit, a ka qenë sulmi real dhe i atëçastshëm si dhe proporcioni me shkallën e rrezikut që ka paraqitur sulmi.⁹⁵

Mirëpo, rigjykimi i këtij rasti ka nisur me tensione, pasi në seancën e 17 shtatorit 2019, trupi gjykues i kryesuar nga gjykatësi, Vesel Ismaili ia ka ndryshuar masën e paraburgimit, të akuzuarit Besart Istrefi, ndaj të cilit ka caktuar masën e arrestit shtëpiak, ku njëri nga familjarët e të ndjerit Gërvalla e kishte akuzuar gjykatësin Ismaili se këtë vendim e kishte marrë pasi ishte

⁹³ “Caktohet të bëhet rikonstruimi i vendit të ngjarjes në rastin e vrasjes në “Shega””. Betimi për Drejtësi. 23 janar 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/caktohet-te-behet-rikonstruimi-i-vendit-te-ngjarjes-ne-rastin-e-vrasjes-ne-shega/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁹⁴ “Babë e bir dënohen me mbi 12 vjet burgim për vrasjen në Milloshevë, i akuzuari i tretë shpallet i pafajshëm”. Betimi për Drejtësi. 4 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/babe-e-bir-denohen-me-mbi-12-vjet-burgim-per-vrasjen-ne-millosheve-i-akuzuari-i-trete-shpallet-i-pafajshem/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁹⁵ “Pas kthimit në rigjykim, caktohet seanca për rastin e vrasjes në restorantin “Shega””. Betimi për Drejtësi. 23 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-kthimit-ne-rigjykim-caktohet-seanca-per-rastin-e-vrasjes-ne-restorantin-shega/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

korruptuar.⁹⁶ Në seancën e 14 nëntorit 2019, janë dëgjuar ekspertët e balistikës, Lutfi Raci dhe Qendrim Topalli, ku ky i fundit kishte deklaruar se nuk ishte vërtetuar se cili nga të akuzuarit kishte shtënë në të ndjerin Gërvalla.⁹⁷

Rasti është ende në proces.

⁹⁶ “Nis me tension rigjykimi për vrasje në rastin “Shega”, familjari i thotë gjykatësit: Hallall t’koftë, paske marr pare”. Betimi për Drejtësi. 17 shtator 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/nis-me-tension-rigjykimi-per-vrasje-ne-rastin-shega-familjari-i-thote-gjykatesit-hallall-tkoftë-paske-marr-pare/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁹⁷ Rigjykimi për vrasjen në “Shega”, eksperti i balistikës thotë se s’dihet se kush ka shtënë në njërin prej viktimave”. Betimi për Drejtësi. 14 nëntor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rigjykimi-per-vrasjen-ne-shega-eksperti-i-balistikes-thote-se-sdihet-se-kush-ka-shtene-ne-njerin-prej-viktimave/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

5. Rasti i vrasjes së vitit 2012 në Lipjan

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.226/19

Vepra penale: “vrasje e rëndë”, “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, “shkaktim i rrezikut të përgjithshëm”

Kryetari i Trupit Gjykses: Vesel Ismaili

Prokuror: Shemsije Asllani

Të pandehur: Arian Agushi, Mentor Agushi, Shpend Agushi, Xhevahir Agushi

Faza e procedurës: Në proces në shkallë të parë

Nga ngritja e aktakuzës e deri me 31 dhjetor 2019 kanë kaluar 3370 ditë, apo 9 vite e 2 muaj

Kallëzimi penal në këtë rast është parashtruar me 12 prill 2012 ndërsa një ditë më pas Prokuroria Themelore në Prishtinë me 13 prill 2012 ka nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve, ku pas shtatë (7) muaj hetime, më 9 tetor 2012 kjo prokurori ka ngritur aktakuzë në këtë rast.

Sipas kësaj aktakuze, katër (4) të akuzuarit me 12 prill 2012, në fshatin Gadime e Epërme, në Lipjan, pas marrëveshjes paraprake mes tyre, me paramendim, kanë shkuar në arën e të dëmtuarit Nuredin Demiri, cili ishte duke punuar me djalin e tij, kishin sulmuar të dëmtuarin Nuredin Demiri. Sipas prokurorisë, me të shkuar në arën e të dëmtuarit, i akuzuari Mentor Agushi, kishte gjuajtur me revole në drejtim të tij dhe e kishte goditur në këmbën e djathtë. Ndërsa, Arian Agushi akuzohet se me pushkën e gjuetisë kishte gjuajtur në drejtim të Ramadan Nuredinit, të cilit i kishte shkaktuar plagë vdekjeprurëse.

Katër të akuzuarit ngarkohen me veprat penale “vrasje e rëndë në bashkëkryerje” dhe veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shitje të paautorizuar të armëve”, ndërsa Arian Agushi akuzohet edhe për veprën penale “shkaktim i rrezikut të përgjithshëm”, pasi kishte shtënë disa herë me armë në oborrin e stacionit.

Me këto veprime, ata akuzoheshin se në bashkëkryerje kishin kryer veprat penale, vrasje e rëndë në bashkëkryerje, armëmbajtje pa leje dhe shkaktim të rrezikut të përgjithshëm.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Pasi aktakuza ishte ngritur me 09 tetor 2012, një muaj më pas, me 8 nëntor 2012 është mbajtur shqyrtimi fillestar. Pas tre vitesh proces gjyqësor, Gjykata Themelore në Prishtinë me 14 tetor 2015 kishte shpallur aktgjykimin, ku të akuzuarin Arian Agushi e kishte dënuar me 19 vite burgim, Mentor Agushi me 14 vite, ndërsa Shpend Agushi dhe Xhevahir Agushi me nga 5 vite burgim.

Aktgjykimin e shkallës së parë e kishte vërtetuar Gjykata e Apelit, me rastin e shqyrtimit të ankesave të deponuara nga të akuzuarit, përmes mbrojtësve të tyre, mirëpo pasi lënda kishte shkuar në shkallën e tretë, Gjykata Supreme e Kosovës kishte anuluar të dy aktgjykimet dhe lëndën e kishte kthyer në rivendosje në shkallën e parë.

Pasi lënda ishte kthyer në rigjykim, në seancën e 13 korrikut 2017, i akuzuari Arian Agushi, pak kohë pasi e pranoi fajësinë për armëmbajtje pa leje, e ka tërhequr atë, pas konsultimit me mbrojtësin e tij, avokatin, Jusuf Bytyqi.⁹⁸ Pas dy vitesh proces gjyqësor që nga kthimi i rastit në rigjykim, Gjykata Themelore në Prishtinë me 15 prill 2019, i ka dënuar me 41 vite burgim katër të akuzuarit për këtë vrasje.

Arian Agushi ishte dënuar me 21 vjet burgim, Mentor Agushi me 11 vjet burgim, ndërsa të akuzuarit Shpend dhe Xhevahir Agushi, ishin dënuar me nga 4 vjet e 10 muaj burgim. Ndërsa, Arian Agushi në mungesë të provave ishte liruar nga akuza për veprën penale “shkaktim i rrezikut të përgjithshëm”, ndërsa ndaj të gjithë të akuzuarve për veprën penale të armëmbajtjes pa leje, ishte shqiptuar aktgjykim refuzues, pasi për këtë vepër prokurori Armend Hamiti, ishte tërhequr nga ndjekja penale.⁹⁹

Mirëpo, ky rast ishte kthyer përsëri në rigjykim nga Gjykata e Apelit, dhe pas kthimit për herë të dytë, nga gjykatësja Shpresa Hasaj – Hyseni, rasti kishte kaluar tek gjykatësi Naser Foniqi.

Rasti është ende në proces në shkallë të parë.

⁹⁸ “I akuzuari heq dorë nga pranimi i fajësisë pas konsultimit me avokatin”. Betimi për Drejtësi. 13 korrik 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-heq-dore-nga-pranimi-i-fajesise-per-vrasje-dhe-armembajtje-pa-leje/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

⁹⁹ “Pas rigjykimit, dënohen me mbi 41 vjet burgim katër të akuzuarit për vrasjen e vitit 2012 në Lipjan”. Betimi për Drejtësi. 15 prill 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-rigjykimit-denohen-me-mbi-41-vjet-burgim-kater-te-akuzuarit-per-vrasjen-e-vitit-2012-ne-lipjan/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

6. Rasti Granit Elshani

Gjykata Themelore në Pejë

Numri i lëndës: PKR.nr.100/18

Vepra penale: “Vrasje e rëndë”, “Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm”, “Vrasje e rëndë në tentativë” dhe “Mbajte në pronësi, posedim dhe përdorim të paautorizuar të armëve”.

Kryetari i Trupit Gjykses: Sami Sarrahiu, Sylë Lokaj

Prokuror : Andrew Huhges, Afrim Shefkiu

I pandehur: Granit Elshani

Faza e procedurës: Në proces në shkallë të parë

[Nga ngritja e aktakuzës e deri më 31 dhjetor 2019 kanë kaluar 1131 ditë apo 3 vite e 1 muaj](#)

Sipas aktakuzës PSRK-së të ngritur më 25 nëntor 2016, thuhet se më 2 janar të viti 2010, në diskotekën “City Club” në Pejë i akuzuari Granit Elshani, kishte hyrë me dy revole të tipit “TT” dhe kishte filluar të shtinte në drejtim të tani të ndjerit Besart Shabi dhe Valdet Kelmendit, i cili ishte plagosur.

Siç përshkruhet në aktakuzë, natën kritike Granit Elshani, shënjestër të vrasjes kishte anëtarin e familjes Kelmendi, Valdetin, por që plumbi kishte goditur Besart Shabi, i cili kishte qëlluar afër tij. Sipas prokurorisë, atë natë lëndime kishin pësuar edhe persona të tjerë që ishin mbledhur për të festuar, ndër ta edhe zyrtari policor Hasan Buqaj.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Më 3 mars të vitit 2010, Policia e Kosovës, kishte paraqitur kallëzimin penal në këtë rast. Aktvendimi për fillim të hetimeve ishte nxjerrë më 5 mars të po të njëjtit vit, kurse ishte finalizuar me aktakuzën e përpiluar nga prokurori Andrew Hughes me 25 nëntor 2016.

Me 13 dhjetor të vitit 2016, ishte mbajtur shqyrtimi fillestar në këtë rast, ku Elshani kishte mohuar fajësinë për veprat penale që i vihen në barrë.

Pas 12 seancave të mbajtura në të clat ishin dëgjuar disa dëshmitarë, në seancën e 24 prillit 2018, i akuzuari në mbrojtjen e tij ishte mohuar akuzën dhe kishte refuzuar të përgjigjet në pyetjet e prokurorit Hughes.¹⁰⁰

Kurse, me 25 maj 2018, kishte përfunduar gjykimi në këtë rast, ku palët kishin paraqitur fjalët përfundimtare¹⁰¹, ndërsa me 30 maj 2018, Gjykata Themelore në Pejë kishte shpallur

¹⁰⁰“ Vrasja në “City Club”, i akuzuari thotë se në natën kur ndodhi ngjarja ai nuk ishte në diskotekë”. Betimi për Drejtësi. 24 prill 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/vrasja-ne-city-club-i-akuzuari-thote-se-ne-naten-kur-ndodhi-ngjarja-ai-nuk-ishte-ne-diskoteke/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹⁰¹ “Përfundon gjykimi për vrasjen në “City Club”, prokuroria kërkon dënimin e të akuzuarit, mbrojtja lirim e tij”. Betimi për Drejtësi. 25 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/perfundon-gjykimi-per->

aktgjykimin në këtë rast dhe të akuzuarin e kishte dënuar me 25 vite burgim për veprat penale “vrasje e rëndë”, “shkaktim i rrezikut të përgjithshëm”, “vrasje e rëndë në tentativë” dhe “armëmbajtje pa leje”.¹⁰²

Në 16 tetor 2018, ishte mbajtur seanca në Gjykatën e Apelit, ku PSRK kishte kërkuar dënim më të lartë, ndërsa mbrojtja kishte kërkuar rigjykim apo lirim nga akuza¹⁰³.

Gjykata e Apelit, kishte vendosur ta kthejë lëndën në rigjykim duke miratuar ankesën e mbrojtësit të akuzuarit Granit Elshani, avokati Ndrecë Dodaj, për shkak se aktgjykimi i shkallës së parë ishte marrë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike.

“Gjykata e shkallës së parë ka bërë vetëm përshkrim të deklaratave të dëshmitarëve, të dëmtuarave, kurse në arsyetim, nuk ka bërë as përpjekjen më të vogël që të bëjë një analizë të mirëfilltë dhe objektive të gjitha provave. Nuk ka dhënë asnjë sqarim se a përputhen gëzhojat e gjetura jashtë lokalit me ato që janë gjetur në brendi të lokalit, sa ka qenë numri i gëzhojave të gjetura”, thuhet në aktvendimin e Apelit.

Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë, është në kundërshtim me vetveten dhe me arsyetimin e aktgjykimit dhe nga provat e administruara ka kundërthënë në mes dëshmimeve të dëshmitarëve rreth përshkrimit të personit i cili ka shtënë me armë.

“Ka kundërthënë në mes dëshmitarëve rreth përshkrimit të personit i cili ka shtënë me armë, se cili nga dëshmitarët e përshkruan pamjen e personit në mënyra të ndryshme, kurse dëshmitari Xhevdet Kelmendi, të cilit gjykata ia ka falur besimin, në arsyetim të aktgjykimit ia përshkruan komplet deklaratën e tij pa dhënë një konkludim se në cilën pjesë të deklaratës është bazuar. Po ashtu qëndrojnë pretendimet ankimore përkitazi me mosdhënien e arsyeve lidhur me propozimin e refuzuar të mbrojtjes së të akuzuarit, që të dërgohet CD e kamerave në një institucion të pajisur me teknologji brenda vendit ose jashtë vendit që të shtjellohen fotot ku mund të identifikohet kryesi i veprave penale dhe me personin që e kanë përshkruar dëshmitarët”, theksohet në aktvendimin e Gjykatës së Apelit.

[vrasjen-ne-city-club-prokuroria-kerkon-denimin-e-te-akuzuarit-mbrojtja-lirimin-e-tij/](#)). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹⁰²“Dënohet me 25 vjet burgim i akuzuari për vrasjen në “City Club”, Granit Elshani”. Betimi për Drejtësi. 30 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-25-vjet-burgim-i-akuzuari-per-vrasjen-ne-city-club-granit-elshani/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹⁰³“Vrasja në “City Club”, PSRK kërkon dënim më të lartë për Granit Elshanin, mbrojtja kërkon lirim nga akuza apo rigjykim”. Betimi për Drejtësi. 16 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/vrasja-ne-city-club-psrk-kerkon-denim-me-te-larte-per-granit-elshanin-mbrojtja-kerkon-lirimin-nga-akuza-apo-rigjykim/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

Kurse, pjesa refuzuese e aktgjykimit të shkallës së parë, është vërtetuar ndërsa ndaj të akuzuarit Granit Elshani, i është vazhduar masa e paraburgimit.¹⁰⁴

Në janar të vitit 2019, kishte filluar rigjykimi ndaj Elshanit, ku kryetar i trupit gjykues ishte caktuar Sylë Lokaj, ndërkaq akuzën e kishte përfaqësuar prokurori i PSRK-së, Afrim Shefkiu.

Për këtë rast gjatë vitit 2019, janë caktuar 9 seanca, ndërsa rasti është ende në proces.

Seanca e 3 qershorit 2019, kishte dështuar të mbahej. Sipas kryetarit të trupit gjykues, Sylë Lokaj, gjykata e kishte njoftuar njësitin e transportit dhe burgun e Lipjanit me kohë në mënyrë që të sigurohet prezenca të akuzuarit në seancë, mirëpo sipas Lokajt, përkundër kësaj ata nuk kanë pasur evidencë se janë ftuar nga gjykata për këtë seancë¹⁰⁵.

¹⁰⁴“ Vrasja në “City Club” në Pejë, Apeli e kthen në rigjykim rastin e Granit Elshanit, i cili ishte dënuar me 25 vjet burgim”. Betimi për Drejtësi. 11 dhjetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/vrasja-ne-city-club-ne-peje-apeli-e-kthen-ne-rigjykim-rastin-e-granit-elshanit-i-cili-ishte-denuar-me-25-vjet-burgim/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹⁰⁵“ Vrasja në “City Club”, dështon seanca e rigjykimit ndaj të akuzuarit Granit Elshani”. Betimi për Drejtësi. 03 qershor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/vrasja-ne-city-club-deshton-seanca-e-rigjykimit-ndaj-te-akuzuarit-granit-elshani/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

7. Rasti i të akuzuarit për terrorizëm që u lirua dy herë dhe rasti për herë të dytë është kthyer në rigjykim

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.157/18

Vepra penale: “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”

Kryetari i Trupit Gjykses: Beqir Kalludra

Prokuror: Faik Halili, Atdhe Dema

I pandehur: Leunis Frangu

Faza e procedurës: Në proces, pas kthimit në rigjykim

Nga ngritja e aktakuzës e deri më 31 dhjetor 2019 kanë kaluar 1405 ditë apo 3 vite, 10 muaj e 6 ditë

PSRK aktakuzën në këtë rast e kishte ngritur më 25 shkurt 2016, me pretendimin se Frangu ka kryer veprën penale “organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist” nga neni 143 paragrafi 2 i KPRK-së.

Sipas aktakuzës së përpiluar nga prokurori Faik Halili, i pandehuri Frangu pas marrëveshjes paraprahe me Blerim Sylën, më 3 nëntor 2014 përmes aeroportit të Prishtinës kishin shkuar në Turqi, ku nga Stambolli thuhet se kishin shkuar së pari në qytetin turk Hatay, e nga atje në një qytet tjetër të Turqisë afër kufirit të Sirisë, me emrin Rehyanli.

Ata pretendohet se kishin kaluar kufirin nga qyteti i përmendur dhe kishin hyrë në Siri ku iu ishin bashkëngjitur organizatës terroriste “ISIS”, ndërsa pas qëndrimit një kohë të gjatë në Siri përmes kufirit në Han të Elezit ishin kthyer në Kosovë.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Kallëzimi penal në këtë rast ishte parashtruar me 20 maj 2015, ndërsa pas disa muajsh, më 25 shkurt të vitit 2016, ishte ngritur aktakuza.

Fillimisht, pas zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Themelore në Prishtinë me 27 shkurt 2018, në mungesë të provave e kishte liruar Frangun nga akuza për terrorizëm.

Kundër këtij aktgjykimi, kishte bërë ankesë Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) pasi kishte konsideruar se shkalla e parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal.

Gjykata e Apelit e kishte aprovuar ankesën e PSRK-së pasi kishte konstatuar se Gjykata Themelore në Prishtinë, nuk ka dhënë fakte vendimtare kur ka marrë një aktgjykim lirues.

Apeli, kishte konstatuar se aktgjykimi ishte në kundërshtim me vetveten pasi sipas saj, shkalla e parë nuk e kishte kontestuese se i akuzuari ka qenë në Siri, por lirim e të akuzuarit e kishte bazuar në atë se nuk dihej se cilës organizatë terroriste i ka takuar Frangu.

Pasi Gjykata e Apelit e kishte kthyer rastin në rigjykim, më 8 janar 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, për herë të dytë e ka liruar nga akuza për terrorizëm, Leunis Frangun.

Kryetari i trupit gjykues Beqir Kalludra, në arsyetimin e shkurtër të këtij aktgjykimi, kishte thënë se nuk është kontestuese që i akuzuari Frangu, kishte shkuar në Siri, por sipas tij, nuk është vërtetuar elementi qenësor i veprës, që është pjesëmarrja në ndonjë grup terrorist, duke shtuar se prokuroria nuk ka sjellë prova të mjaftueshme që i akuzuari të shpallet fajtor.

Kalludra, gjithashtu kishte thënë se në kohën kur pretendohet se i akuzuari ka kryer veprën penale nuk ka qenë në fuqi ligji, i cili tashmë sanksion edhe shkuarjen në Siri¹⁰⁶.

Pasi Frangu për herë të dytë ishte liruar nga akuza, PSRK përsëri kishte parashtruar ankesë kundër këtij aktgjykimi për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

Këto pretendime të PSRK-së i kishte marrë për bazë Gjykata e Apelit, e cila më 25 nëntor 2019, e kishte kthyer rastin për të dytën herë në rigjykim.

Sipas Apelit, gjykata e shkallës së parë në rigjykim duhet të eliminojë të gjitha paqartësitë në lidhje me atë se cila ishte arsyeja e udhëtimit të të akuzuarit në Siri, nëse ai nuk i ishte bashkëngjitur ndonjë grupi terrorist, sepse sipas Apelit, ai 15-17 ditë kishte ushtruar dhe ishte armatosur.

Rasti është ende në proces në shkallë të parë.

¹⁰⁶ “Për herë të dytë shpallet i pafajshëm i akuzuari për pjesëmarrje në grupe terroriste”. Betimi për Drejtësi. 8 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/per-here-te-dyte-shpallet-i-pafajshem-i-akuzuari-per-pjesemarrje-ne-grupe-terroriste/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

8. Rasti i të akuzuarit që ishte liruar, pas rigjykimit ishte dënuar me burgim të përjetshëm e që Supremja e ktheu në rigjykim

Gjykata Themelore në Pejë

Numri i lëndës: PKR.nr.83/18

Vepra penale: “vrasje e rëndë”, “mbajtje në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”

Kryetari i Trupit Gjykses: Sylë Lokaj, pastaj Kreshnik Radoniqi

Prokuror: Valbona Disha Haxhosaj

I pandehur: Naser Pajazitaj

Faza e procedurës: Në proces në shkallë të parë pas kthimit në rigjykim

Nga ngritja e aktakuzës e deri me 31 dhjetor 2019 kanë kaluar 936 ditë apo 2 vite, 6 muaj e 23 ditë

Sipas Prokurorisë Themelore në Pejë, Naser Pajazitaj akuzohet se me 9 nëntor 2015 rreth orës 14:30 në bjeshkët e Strellcit të Komunës së Deçanit, me armë, në mënyrë mizore ka privuar nga jeta të ndjerën Donjeta Pajazitaj. Derisa e ndjera ka qenë duke shkuar në punë në këmbë, aty kalon i pandehuri me veturën e tij, e merr të ndjerën, e dërgon në bjeshkët e lartcekura, ku fillimisht e privon nga jeta duke shtënë dy herë në kokë të saj, e më pas për të humbur gjurmët të njëjtën e mbulon me disa drunj dhe largohet nga vendi i ngjarjes. Trupi i të ndjerës gjendet pas më shumë se një muaji.

Me këtë, Pajazitaj akuzohet se ka kryer veprën penale të “vrasjes së rëndë” nga neni 179 paragrafi 1 pika 1.4 dhe 1.12 të KPRK-së.

Aktakuza të njëjtin e ngarkonte edhe me veprën penale të “mbajtjes në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 374 par 1 të KPRK-së, gjegjësisht të një arme automatike, pushkës së gjuetisë, 12 fishek dhe një armë e tipit “AK 47”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Kallëzimi penal për këtë rast ishte parashtruar më 24 dhjetor të vitit 2015, ndërsa të njëjtën ditë Prokuroria Themelore në Pejë kishte nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve, ndërsa aktakuzën ishte ngritur me 8 qershor të vitit 2017 nga prokurorja Valbona Disha-Haxhosaj.

Shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 22 qershor 2017, apo dy javë pas ngritjes së aktit akuzues dhe në po këtë ditë, një person ishte arrestuar pas një përleshjeje që kishte ndodhur në mes të disa familjareve të palës së dëmtuar dhe të akuzuarit. Përleshja mes tyre kishte ndodhur pikërisht pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar. Deri te kjo përleshje kishte ardhur pasi vëllai i të ndjerës, Shkelqim Pajazitaj, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar e ka goditur të akuzuarin. Në atë moment kishin ndërhyrë zyrtarët policor, dhe i njëjti është arrestuar. Tutje, në shkallë të gjykatës kishte ndodhur një tjetër konflikt verbal, këtë herë ndaj prokurores Valbona Disha

Haxhosaj nga ana e babait të të ndjerës, Halil Pajazitaj dhe të afërmëve të saj, Qamil dhe Xhefer Pajazitaj.

Ndryshe, në shqyrtimin fillestar, Naser Pajazitaj ishte deklaruar i pafajshëm për veprën penale të vrasjes së rëndë, ndërsa, për veprën penale nga pika 2 dhe 3 e dispozitivit të akuzës, e që kanë të bëjnë me armëmbajtje pa leje, i njëjti kishte deklaruar se për pikën 3 e pranon fajësinë, ndërsa për pikën 2 e pranon fajësinë si të pjesshme. Me këtë rast, kryetari i trupit gjykues, gjyqtari Sylë Lokaj me aktvendim kishte aprovuar pranimin e fajësisë për pikën e 3 të akuzës, ndërsa kishte refuzuar pranimin e fajësisë për pikën 2 të akuzës¹⁰⁷.

Pas dëgjimit të dëshmitarëve në seanca paraprake, me 26 shkurt të vitit 2018, i akuzuari Pajazitaj kishte vendosur të mbrohet në heshtje.¹⁰⁸ Në seancën e mbajtur me 5 mars 2018, ishin paraqitur fjalët përfundimtare nga palët në procedurë, ku prokuroria kishte kërkuar dënimin e të akuzuarit, kurse mbrojtja lirim të akuzës.¹⁰⁹

Gjykata Themelore në Pejë, të akuzuarin Naser Pajazitaj e kishte liruar nga akuzat për vrasjen e Donjeta Pajazitaj, kurse e kishte dënuar për veprën penale të armëmbajtjes pa leje, për çka Pajazitaj, ishte dënuar me dënim unik prej dy vjet e katër muaj burgim. E pakënaqur me aktgjykimin e shkallës së parë, prokurorja Valbona Disha-Haxhosaj, ishte ankuar në Apel, duke kërkuar që kjo çështje të kthehet në rigjykim. Në anën tjetër, ankesën e prokurorisë e kishte kundërshtuar mbrojtja e Pajazitaj¹¹⁰.

Gjykata e shkallës së dytë, më pas, këtë rast e kishte kthyer në rigjykim.¹¹¹

Pas kthimit në rigjykim, kryetar i trupit gjykues ka qenë gjykatësi Kreshnik Radoniqi, i cili në këtë kohë ka shërbyer edhe si kryetar i Gjykatës Themelore në Pejë.

Më 25 mars të vitit 2019, Pajazitaj ishte dënuar me burgim të përjetshëm.¹¹²

¹⁰⁷ “Përleshje në gjykatë, arrestohet një person pas fillimit të gjykitimit ndaj të akuzuarit për vrasjen e Donjeta Pajazitaj”. Betimi për Drejtësi. 22 qershor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/perleshje-ne-gjykatene-e-pejes-arrestohen-kater-persona-pas-gjykitimit-ndaj-te-akuzuarit-per-vrasjen-e-donjeta-pajazitaj/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹⁰⁸ “I akuzuari për vrasjen e Donjeta Pajazitajt mbrohet në heshtje”. Betimi për Drejtësi. 26 shkurt 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-per-vrasjen-e-donjeta-pajazitajt-mbrohet-ne-heshtje/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹⁰⁹ “Prokuroria kërkon dënimin e të akuzuarit për vrasjen e Donjeta Pajazitaj, mbrojtja lirim të tij, nesër shpallet aktgjykim”. Betimi për Drejtësi. 05 mars 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-kerkon-denimin-e-te-akuzuarit-per-vrasjen-e-donjeta-pajazitaj-mbrojtja-lirim-e-tij-neser-shpallet-aktgjykimi/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹¹⁰ “Prokuroria kërkon rigjykim për të akuzuarin për vrasjen e Donjeta Pajazitaj, mbrojtja kundërshton”. Betimi për Drejtësi. 10 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-kerkon-rigjykim-per-te-akuzuarin-per-vrasjen-e-donjeta-pajazitaj-mbrojtja-kundershton/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹¹¹ “Apeli e kthen në rigjykim rastin e vrasjes së Donjeta Pajazitaj”. Betimi për Drejtësi. 17 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rigjykim-rastin-e-vrasjes-se-donjeta-pajazitaj/>).

¹¹² “Pas rigjykitimit, dënohet me burgim të përjetshëm i akuzuari për vrasjen e Donjeta Pajazitajt”. Betimi për Drejtësi. 25 mars 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-rigjykitimit-denohet-me-burgim-te-perjetshem-i-akuzuari-per-vrasjen-e-donjeta-pajazitajt/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

E thirrja telefonike e të akuzuarit për vrasje të rëndë, Naser Pajazitaj, ka qenë një nga provat në të cilat është thirrur Gjykata Themelore në Pejë, për ta dënuar atë me burgim të përjetshëm. Në këtë aktgjykim, thuhej se kjo gjykatë ka konstatuar përmes provave të administruara në shqyrtimin kryesor se i akuzuari Naser Pajazitaj, në mënyrë dinake ka privuar nga jeta tani të ndjerën Donjeta Pajazitaj. Sipas kësaj gjykate, provë e re ka qenë lista e thirrjeve nga i akuzuari që ka bërë në ditën kritike, me ç'rast është aktivizuar antena, e cila mbulon bjeshkën e Strelcit. *“Nga sa u elaborua me lartë gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Viktima është zhdukur me datë 09.11.2015 ne ora 13:44, ndërsa i akuzuari është lokalizuar në vendin e ngjarjes në ora 15:19, pra koha kur është kryer vrasja ka qenë intervali kohor nga 13:44 gjer ne ora 15:19”,* thuhej në arsyetim.¹¹³

E me 20 qershor të vitit 2019, për herë të dytë në Apel ishte mbajtur seancë. Mbrojtësi i dënuarit Pajazitaj, avokati Gëzim Kollçaku, kishte kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë që të merr vendim me të cilin klienti i tij të lirohet nga përgjegjësia penale, ose në të kundërtën rastin ta kthejë edhe një herë në shkallë të parë, në një proces të tretë të gjyimit.¹¹⁴

Gjykata e Apelit, e kishte vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë pasi sipas saj vendimi i shkallës së parë ishte i drejtë dhe nuk përmban shkelje ligjore. “Kolegji profesional i kësaj gjykate, vlerësoj se aktgjykimin e shkallës së parë, nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë si dhe nuk ka shkelje të ligjit penal”, thuhej në komunikatën e shkallës së dytë. Kurse sa i përket vendimit mbi dënimin, Apeli kishte konstatuar se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit. “Sa i përket vendimit mbi dënim, Gjykata e Apelit konstatoj se meqenëse në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë rrethana posaçërisht renduese, ashtu sikurse ka vlerësuar edhe gjykata e shkallës së parë, dënimi me burgim të përjetshëm është në harmoni me rrezikshmërinë shoqërore të kësaj veprë dhe shkallen e përgjegjësisë penale të akuzuarit, dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit, sikur parasheh neni 44 i KPRK-së”, thuhej tutje në njoftimin e Apelit.¹¹⁵

Mirëpo, Pajazitaj do të gjykohej edhe njëherë lidhur me akuzat për vrasjen e Donjeta Pajazitajt, kjo pasi që Gjykata Supreme e Kosovës, i ka prishur të dy aktgjykimet e Gjykatës Themelore në Pejë dhe të Gjykatës së Apelit. Por, Gjykata Supreme e ka aprovuar ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit dhe sipas detyrës zyrtare ka anuluar dy aktgjykimet paraprake. Supremja ka

¹¹³ “Thirrja telefonike nga Naser Pajazitaj një nga provat që përmendet nga Gjykata e Pejës në arsyetimin e dënimit me burgim të përjetshëm”. Betimi për Drejtësi. 02 maj 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/thirrja-telefonike-nga-naser-pajazitaj-nje-nga-provat-qe-permendet-nga-gjykata-e-pejes-ne-arsyetimin-e-denimit-me-burgim-te-perjetshem/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹¹⁴ “Lirim ose rigjykim kërkon nga Apeli i dënuari me burgim të përjetshëm për vrasjen e Donjeta Pajazitajt”. Betimi për Drejtësi. 20 qershor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/lirim-ose-rigjykim-kerkon-nga-apeli-i-denuari-me-burgim-te-perjetshem-per-vrasjen-e-donjeta-pajazitajt/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹¹⁵ “Gjykimi për vrasjen e Donjeta Pajazitajt, Apeli ia vërteton dënimin me burgim të përjetshëm Naser Pajazitajt”. Betimi për Drejtësi. 30 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-vrasjen-e-donjeta-pajazitajt-apeli-ia-verteton-denimin-me-burgim-te-perjetshem-naser-pajazitajt/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

konstatuar se të dy aktgjykimet kanë qenë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për shkak të mos arsyetimit të refuzimit të propozimeve të bëra nga mbrojtësi i të pandehurit.

Aty thuhet se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyetim të pamjaftueshëm për poseduesin e numrit të telefonit që dyshohet se është kontaktuar nga ana e tani të ndjerës dhe një personi tjetër. Supremja ka konstatuar se është e nevojshme që të sqarohet aspekti i aktivizimit të kamerave, se pse nuk ka pasur vazhdimësi të kohës së xhirimit. Sa i përket listës së thirrjeve lidhur me vendndodhjen e të akuzuarit, e cila ka qenë provë e re sipas gjykatës së shkallës së parë, Supremja ka kërkuar të angazhohet një ekspert i lëmisë përkatëse, për të qartësuar faktin e aktivizimit të antenave në ditën kritike. Gjithashtu, Supremja ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë është dashur që në mënyrë të hollësishme të arsyetojë mënyrën dinake të veprimet të të akuzuarit me rastin e privimit nga jeta të tani të ndjerës.

“Gjykata e Pejës ta ftojë dëshmitaren Hejdije Kelmendi për të sqaruar informatat e pranuar përmes “Viberit”, nga ana e personit të panjohur, të sqarohet se si ka funksionuar kamera e vendosur në shtëpinë e Nedi Jusaj, se incizimi a bëhet me vazhdimisht apo me lëvizjen e objekteve dhe të caktohet eksperti i telekomunikacionit që të jep sqarime lidhur me faktin se cilin territor e mbulon antena Zllapekut dhe cilën e mbulon antena e Strellcit, dhe Bjeshkët e Strellcit”, thuhet tutje në vendim.¹¹⁶

Gjithashtu, në vendim të Supremes, thuhet se ka konstatuar se në shkresat e lëndës gjendet një letër e dërguar nga një person anonim në oborrin e shtëpisë së familjes së të ndjerës dhe nga përmbajtja e letrës përmendet emri i një personi si i involvuar i mundshëm në rastin e vrasjes së të ndjerës dhe për më tepër në letër përshkruhet edhe motivimi i mundshëm i provimit nga jeta të të ndjerës. Andaj, thuhet se gjykata e shkallës së parë në rigjykim të kësaj çështje për shkak të përmbajtjes së letrës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, duhet të administrohet si provë dhe pastaj duhet të bëhet përpjekje që të sigurohet prezenca dhe të dëgjohet personi që potencohet në letër dhe pa prejudikuar epilogun e kësaj prove, megjithatë bazuar në përmbajtjen e saj mundet eventualisht të zbardhet motivi i kësaj vrasje.

¹¹⁶ “Supremja anulon dy aktgjykimet dhe e kthen në rigjykim rastin e Naser Pajazitajt, i dënuar me burgim të përjetshëm për vrasjen e Donjeta Pajazitajt”. Betimi për Drejtësi. 02 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/supremja-anulon-dy-aktgjykimet-dhe-e-kthen-ne-rigjykim-rastin-e-naser-pajazitajt-i-denuar-me-burgim-te-perjetshem-per-vrasjen-e-donjeta-pajazitajt/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

9. Rasti “Bon Vivant”, arma u asgjësua pa përfunduar gjykimi

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.389/15

Vepra penale: “Vrasje e rëndë” ; “ Mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve”

Kryetari i Trupit Gjykes: Suzana Çerkini

Prokuror : Ferdane Sylejmani

I pandehur: Masar Gërdovci, Sherif Krasniqi

Faza e procedurës: Në proces pas kthimit në rigjykim

Nga ngritja e aktakuzës deri më 31 dhjetor kanë kaluar 1638 ditë apo 4 vite, 5 muaj e 24 ditë

Sipas aktakuzës së ngritur më 7 korrik 2015, Masar Gërdovci dhe Sherif Krasniqi, akuzohen se në bashkëkryerje, kanë kryer veprën penale, vrasje të rëndë, dhe armëmbajtje pa leje.

Sipas prokurorisë, më 13 tetor 2014, Masar Gërdovci dhe Sherif Krasniqi, kanë shkuar në lokalin “Bon Vivant”, i cili gjendet në rrugën “Rexhep Luci”, në Prishtinë.

Sipas aktakuzës, me të hyrë brenda në lokal, menaxheri i lokalit Ilir Misini, i pyet të pandehurit se a kishin rezervuar ku të njëjtit ishin përgjigjur “Ne asnjëherë nuk kemi bërë rezervim”, dhe kishin vazhduar të ulen në tarracë, në pjesën e pasme të lokalit.

Në aktakuzë thuhet se menaxheri i lokalit i kishte thënë tani të ndjerit Rahman Uka, të merret me të pandehurit që t’i largoi nga lokali, i cili ishte ofruar tek tavolina ku ishin ulur ata, me qëllim për t’i larguar nga lokali pasi të njëjtit nuk kishin rezervim.

Sipas aktakuzës, sapo Uka largohet dhe hynë në sallën e lokalit, të pandehurit ngritën nga tavolina dhe shkojnë në drejtim të tij, ku fillojnë ta sulmojnë me grushte.

Gjithnjë sipas aktakuzës, me qëllim që ta privojnë nga jeta, fillimisht Masar Gërdovci e kishte nxjerrë revolen nga çanta e tij dhe kishte shtënë në drejtim të punëtorit të sigurimit Rahman Uka, i cili ishte përlur në atë moment për t’i shmangur goditjeve. Sipas aktakuzës, Uka me tu ngritur në këmbë niset në drejtim të tashmë të pandehurve që në moment ishte duke shkuar në drejtim të daljes nga lokali, papritmas i pandehuri Sherif Krasniqi, me dashje që ta provoi nga jeta merr revolen nga Masar Gërdovci dhe shkrep dy herë në drejtim të tani të ndjerit me ç’rast e plagos në regjionin e gjoksit dhe si pasojë e gjakderdhjes masive nga plag Masa Gërdovci dhe Sherif Krasniqi.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Më 14 tetor të vitit 2014, Policia e Kosovës, kishte iniciuar kallëzimin penal në këtë rast. Pas përfundimit të hetimeve, me korrik të vitit 2015, prokurorja Ferdane Sylejmani kishte bërë

përpilimin e aktit akuzues. Më 4 shtator të vitit 2015, ishte mbajtur shqyrtimi fillestar në këtë rast, respektivisht 59 ditë pas ngritjes së aktit akuzues, duke mos u respektuar afati ligjor i përcaktuar me anë të Kodit të Procedurës Penale për caktim të seancës fillestare. Me 31 mars të vitit 2016, ishte mbajtur shqyrtimi i dytë, ku më pas gjykata e shkallës së parë kishte bërë aprovimin e akuzës, ndërkaq mbrojtja vendimin e kishte apeluar në gjykatë të shkallës së dytë. Mirëpo, edhe gjykata e shkallës së dytë, sikurse ajo e shkallës së parë, kishte bërë aprovimin e aktit akuzues.

Gjatë dhënies së fjalës përfundimtare në këtë rast, më 1 nëntor të vitit 2018, dy të akuzuarit përmes mbrojtësve të tyre, e kishin fajësuar njëri tjetrin.¹¹⁷

Më pas, më 12 nëntor 2018, ishte rihapur shqyrtimi gjyqësor ndaj të të akuzuarve, me arsyetimin se nevojitet sqarimi i një çështjeje konkrete, siç është sigurimi i dy provave, përmes ekspertizës. Sipas gjyqtarës Çerkini, nevojitej ekspertiza mbi ekzaminimin e gjurmëve të vijave papilare, dhe ADN-së në armën që dyshohet të jetë përdorur në rastin e vrasjes në “Bon Vivant”.

E në seancën e 18 janarit të vitit 2019, mbrojtësi i të akuzuarit Krasniqi, Haxhi Millaku, kishte deklaruar se tre muaj para se të ngritet aktakuza, prokuroria ka asgjësuar provat në këtë rast, ku pikërisht, në këtë seancë ishte paraparë paraqitja e dy ekspertizave forenzike, por gjykatësja Suzana Çerkini kishte deklaruar se kishte pranuar përgjigje me shkrim nga Agjencia Kosovare e Forenzikës, me të cilën ishte njoftuar se arma nuk ishte dorëzuar fare në agjenci.

Lidhur me këtë gjykatësja Çerkini, kishte deklaruar se kishte pranuar edhe një raport nga Drejtoria Rajonale e Policisë, me të cilën ishte njoftuar se arma në fjalë, është shkatërruar, pas konstatimit se ajo nuk ka pasur përputhshmëri me rastet e hapura në laboratorin e armëve të zjarrit.

Avokati Millaku, kishte propozuar që të dëgjohen si dëshmitarë hetuesit nga ekipi i këtij rasti, me arsyetimin se kjo do të ndihmonte për të sqaruar parregullsitë lidhur me asgjësimin e armës. Por, propozimi i tij sa i përket dëgjimit të dëshmitarëve ishte refuzuar nga gjykata, pasi që sipas kryetares së trupit gjykues, deklaratat e tyre gjenden në shkresat e lëndës.

Ndërkohë, në këtë seancë, palët në procedurë kanë dhënë sërish fjalët e tyre përfundimtare, ku prokurorja Sylejmani, sa i përket provës së re lidhur me raportin e policisë mbi asgjësimin e armës, ajo kishte thënë se të njëjtin e kishte siguruar nga policia, pasi që kishte pranuar shkresën nga ana e gjykatës. Sipas saj, arma ishte shkatërruar me urdhëresë së prokurorisë.¹¹⁸

¹¹⁷ “Të akuzuarit për vrasjen në “Bon Vivant” fajësojnë njëri-tjetrin, prokuroria kërkon dënimin e tyre”. Betimi për Drejtësi. 01 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/te-akuzuarit-per-vrasjen-ne-bon-vivant-fajesojne-njeri-tjetrin-prokuroria-kerkon-denimin-e-tyre/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹¹⁸ “Vrasja në “Bon Vivant”, avokati thotë se prokuroria asgjësoi armën tre muaj para ngritjes së aktakuzës”. Betimi për Drejtësi. 18 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/vrasja-ne-bon-vivant-avokati-thote-se-prokuroria-asgjesoi-armen-tre-muaj-para-ngritjes-se-aktakuzes/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

Më 22 janar, Masar Gërdovci, ishte dënuar me 21 vjet e 8 muaj burgim, pasi është shpallur fajtor për vrasjen. Kurse, i akuzuari tjetër në këtë rast, Sherif Krasniqi, ishte dënuar me 4 vjet e 3 muaj, pasi është shpallur fajtor për pjesëmarrje në rrahje, pasi ndaj tij është bërë ricilësimi i veprës penale nga vrasje e rëndë në bashkëkryerje, në pjesëmarrje në rrahje. Krasniqi ishte liruar nga akuza për armëmbajtje pa leje, pasi që nuk është provuar se ai ka kryer një vepër të tillë penale.

I akuzuari Masar Gërdovci, për veprën penale të vrasjes së rëndë, ishte dënuar me 21 vjet burgim, kurse për armëmbajtje pa leje, ishte dënuar me 21 vjet e 8 muaj burgim. Atij i ishte vazhduar edhe masa e paraburgimit, ndërsa të akuzuarit Sherif Krasniqi i ishte ndërprerë një masë e tillë. Ndërsa, lidhur me armën gjykata kishte marrë vendim që e njëjta të konfiskohet, ndonëse në seancën e kaluar gjykatësja Çerkini, kishte deklaruar se përmes raportit nga Drejtoria Rajonale e Policisë, ishte njoftuar se arma në fjalë, është shkatërruar, pas konstatimit se ajo nuk ka pasur përputhshmëri me rastet e hapura në laboratorin e armëve të zjarrit.¹¹⁹

Me 18 tetor të vitit 2019, palët i ishin drejtuar Gjykatës së Apelit, e cila rastin e kishte kthyer në rigjykim, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kushtëzojnë anulimin e aktgjykimit. Sipas Apelit, arsyet e dhëna në aktgjykim janë të paqarta dhe kundërthënëse.¹²⁰

“Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar të Gjykatës së shkallës së parë nuk përmban faktet dhe rrethanat vendimtare që formësojnë elementet objektive dhe subjektive të formës cilësuese veprës penale vrasje e rëndë nga neni 179, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 të KPRK-së për të cilën i akuzuari Masar Gërdovci është shpallur fajtor dhe dënuar, e nga arsyeja se në dispozitiv nuk është përfshirë se a ka pasur njerëz në terasën e përparme të lokalit në momentin e kacafytjes dhe shtënies me armë, nëse ka pasur sa njerëz kanë qenë, pastaj cili ka qenë identiteti i tyre, ku gjendeshin në momentin e shkrepjes me armë dhe jeta e cilëve persona konkretë është rrezikuar nga shkrepja e armës e që kjo rezulton në mungesën e përcaktimit të rrezikshmërisë konkrete si element i veprës penale” thuhet ndër të tjera në këtë aktvendim.

Po ashtu, Gjykata e Apelit ka gjetur se në dispozitivin e aktgjykimit nuk është konstatuar dashja e dyfishtë e të akuzuarit Masar Gërdovci për shkaktimin e dy pasojave, privimi nga jeta e viktimës si dhe vënia në rrezik e personave tjerë konkretë të cilat gjendeshin afër personit të privuar nga jeta, çka thuhet se rezulton me mungesën e elementit subjektiv të veprës.

Tutje, Apeli ka konstatuar se gjendja e vërtetuar faktike në aktgjykimin e ankimuar është më ndryshe nga ajo e përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, me arsyetimin se përderisa në

¹¹⁹ “Masar Gërdovci shpallet fajtor për vrasjen në “Bon Vivant”, dënohet me mbi 21 vjet burg”. Betimi për Drejtësi. 22 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/masar-gerdovci-shpallet-fajtor-per-vrasjen-ne-bon-vivant-denohet-me-mbi-21-vjet-burg/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹²⁰ “Vrasja në “Bon Vivant”, vëllai i të ndjerit i drejtohet Apelit: Pres prej juve dënim maksimal, mos na e leni në dorë neve”. Betimi për Drejtësi. 18 tetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/vrasja-ne-bon-vivant-vellai-i-te-ndjerit-i-drejtohet-apelit-pres-prej-juve-denim-maksimal-mos-na-e-leni-ne-dore-neve/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

dispozitivin e aktakuzës ekziston konstatimi se i akuzuari Sherif Krasniqi ia ka marr revolen nga dora të akuzuarit Masar Gërdovci, duke shkrepur dy herë në drejtim të tani të ndjerit Rrahman Uka, në dispozitivin e aktgjyqimit të ankimuar konstatohet se i akuzuari Masar Gërdovci, me dashje, duke vënë në rrezik edhe jetën e personave tjerë në lokal, ka privuar nga jeta tani të ndjerin Rrahman Uka duke shkrepur me revole dy-tre herë në distancë përafërsisht një metër.¹²¹

Gjykata pas kthimit të lëndës në rigjykim, gjatë vitit 2019 nuk e ka caktuar ende seancën e rigjyqimit.

¹²¹ “Apeli e kthen në rigjykim rastin e vrasjes në “Bon Vivant”, konstaton se aktgjykimi i shkallës së parë është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore” Betimi për Drejtësi. 27 nëntor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rigjykim-rastin-e-vrasjes-ne-bon-vivant-konstaton-se-aktgjykimi-i-shkalles-se-pare-eshte-nxjerr-ne-kundershtim-me-dispozitat-ligjore/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

11. ANEX III: Analizë e detajuar e rasteve që kanë përfunduar në shkallë të parë

1. Rasti i vrasjes me pagesë

Gjykata Themelore në Pejë

Numri i lëndës: PKR.nr.56/18

Vepra penale: “Vrasja e rëndë”

Kryetari i Trupit Gjykses: Sami Sharaxhiu

Prokuror : Valbona Disha-Haxhosaj

I pandehur: Bekim Raja, Murat Sinanaj, Avni Sinanaj dhe Gjon Pnishi

Faza e procedurës: Aktgjykim i shkallës së parë

Nga ngritja e aktakuzës deri më 21 dhjetor kanë kaluar 523 ditë apo 1 vit e 5 muaj

Sipas aktakuzës së ngritur më 26 korrik 2018, nga Prokuroria Themelore në Pejë, të pandehurit Avni Sinanaj, Murat Sinanaj dhe Bekim Raja akuzohen se në maj të vitit 2012 në Zvicër, i pandehuri Bekim Raja me qëllim të hakmarrjes së paskrupullt, e ka porositur të pandehurin Gjon Pnishi, që ky i fundit së bashku me të pandehurin Avni dhe Murat Sinanaj, ta kryejnë vrasjen e viktimës Ferdinand Gjinit, duke premtuar dhe dhënë shpërblim prej një qind mijë franga zvicerane.

Në dispozitivin e aktakuzës përshkruhet se të pandehurit Gjon Pnishi, Avni dhe Murat Sinanaj me 23 qershor 2014, duke vepruar sipas marrëveshjes paraprake në mes tyre në mënyrë dinake dhe me qëllim të fitimit të dobisë pasurore për vete, e mashtrojnë viktimën duke e joshur me substanca narkotike, në atë mënyrë që viktimë niset me veturën e tij “Pasat” nga Gjakova për në drejtim të Deçanit, i përcjell nga i pandehuri Gjon Pnishi, për të shkuar dhe për të marrë një sasi të substancave narkotike, ashtu siç i kishte premtuar i pandehuri Avni Sinanaj.

Më tutje, sipas aktakuzës, i pandehuri Gjon Pnishi, duke vepruar sipas sugjerimeve të pandehurit Avni Sinanaj, që të kalojnë nëpër fshatrat Hereq, Gramaqel, Dubrav, Gllogjan, dhe me të arritur tek ura që i lidh fshatrat Llukë e Prapaqan, i pandehuri Murat Sinanaj duke qenë i përgatitur, i zënë pritën, dhe me të kaluar viktimë me veturë mbi urë, i pandehuri Murat Sinaj shtënë me armë automatike në drejtim të viktimës, duke i shkaktuar lëndime vdekjeprurëse.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Në këtë rast, më 1 mars 2017, kallëzimi penal ishte iniciuar nga ana e Policisë së Kosovës. Aktvendimi për fillim të hetimeve ishte nxjerrë nga ana e organit të akuzës më 3 mars të po të njëjtit vit. Ndërkaq, akti akuzues ishte ngritur më 26 korrik të vitit 2018 nga prokurorja Valbona Disha-Haxhosaj. Shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 6 gusht 2018, ndërkaq ai i dytë më 14 shtator 2018, ku më pas gjykata e shkallës së parë e kishte aprovuar aktin akuzues, e pas

ankesës së mbrojtjes, edhe Apeli kishte vendosur që akti akuzues të aprovohet dhe ankesa e mbrojtjes të refuzohet.

Fillimisht, në këtë rast ka qenë i akuzuar Gjon Pnishi, i cili ishte shpallur fajtor për këtë vrasje dhe ishte dënua me 18 vjet burgim nga Gjykata Themelore e Pejës, në qershor të vitit 2016. Por, pas këtij dënimi, ai ka pranuar të bashkëpunojë me prokurorinë në lidhje me vrasjen e Ferdinand Gjinit, për çka edhe Gjykata e Apelit e kishte kthyer rastin në rigjykim, në shkurt të vitit 2017.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me 6 gusht 2018, të akuzuarit ishin deklaruar të pafajshëm.¹²²

Pas konfirmimit të aktit akuzues, në seancën e mbajtur me 11 shkurt 2019, prokurorja kishte pretenduar se organi i ndjekjes ka prova ndaj të akuzuarve në fjalë, kurse mbrojtja e të akuzuarve kishte pretenduar se akuzu është e bazuar vetëm në deklaratë të një të akuzuari dhe se të akuzuarit janë të pafajshëm.¹²³ Më pas, gjykimi ishte mbajtur edhe me 12 e 13 shkurt.

Në seancën e mbajtur me 22 mars 2019, pas dëgjimit të një dëshmitari, ishte bërë mbyllja e seancës për publikun.

Arsye për mbylljen e kësaj seance ishte se në këtë shqyrtim do të dëgjohet dëshmitarja D.K, bashkëshortja e të ndjerit M.K, e cila të pandehurin Bekim Raja e ka djalë të xhaxhait, si dhe dëshmitarja S.K, e sipas gjykatës, në dëshminë e tyre mund të përmendet dëshmitari bashkëpunues i këtij gjykimi. Propozimin për mbylljen e seancës, e ka bërë prokurorja Valbona Dishaj-Haxhosaj, me arsyetimin se këto dëshmitare e përmendin në deklaratimet e tyre dëshmitarin bashkëpunues, për të cilin gjykata ka lëshuar urdhër mbrojtës.¹²⁴

Edhe seanca e 20 maj 2019, ishte mbyllur për publikun, me arsyetimin se do të dëgjohej një dëshmitar i mbrojtur. Kjo seancë nga Gjykata Themelore në Pejë ishte transferuar të mbahej në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për shkak të pajisjeve teknike, pasi dëshmitari i mbrojtur kishte për tu dëgjuar përmes videolinkut.¹²⁵

¹²²“Deklarohen të pafajshëm të akuzuarit për kryerjen e vrasjes me pagesë para katër vjetësh në Deçan”. Betimi për Drejtësi. 06 gusht 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohen-te-pafajshem-te-akuzuarit-per-kryerjen-e-vrasjes-me-pagese-para-kater-vjetesh-ne-decan/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹²³“Gjykimi për vrasjen me pagesë në Deçan, prokuroria thotë se ka prova, mbrojtja thotë se aktakuza bazohet vetëm në deklaratën e njërit të akuzuar”. Betimi për Drejtësi. 11 shkurt 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-vrasjen-me-pagese-ne-decan-prokuroria-thote-se-ka-prova-mbrojtja-thote-se-aktakuza-bazohet-vetem-ne-deklaraten-e-njerit-te-akuzuar/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹²⁴“Mbyllet për publikun gjykimi ndaj të akuzuarve për vrasjen me pagesë në Pejë”. Betimi për Drejtësi. 22 mars 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mbyllet-per-publikun-gjykimi-ndaj-te-akuzuarve-per-vrasjen-me-pagese-ne-peje/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹²⁵“Për të dytën herë mbyllet për publikun gjykimi ndaj të akuzuarve për vrasjen me pagesë në Pejë”. Betimi për Drejtësi. 20 maj 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/per-te-dyten-here-mbyllet-per-publikun-gjykimi-ndaj-te-akuzuarve-per-vrasjen-me-pagese-ne-peje/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

Ndërkaq, në seancën e mbajtur me 21 maj 2019, prokurorja Valbona Dishaj-Haxhosaj, kishte deklaruar se është njoftuar nga dy të burgosur, të cilët pretendohet se e kanë dëgjuar një bisedë të të akuzuarit Bekim Raja, e në të cilën ai kishte përdorur fjalë kërcënuese ndaj prokurorëve. Për këtë arsye ajo ka propozuar që të dëgjohen si dëshmitarë dy të burgosurit Shpend Qerimi dhe Besnik Hasani. Sipas saj, arsye pse ka propozuar dëgjimin e këtyre dy dëshmitarëve është se ajo është mbështetur edhe në deklarinimin e dëshmitarit të mbrojtur, pasi që sipas prokurores, jeta dhe familja e tij është rrezikuar nga i akuzuari Bekim Raja. Një deklaratë e tillë, ka bërë që të kalojë me tensione kjo seancë, pasi që i akuzuari Raja, ka mohuar pretendimet e tilla, duke i cilësuar ato si manipulime të prokurores Dishaj-Haxhosaj.¹²⁶

Në seancën e 23 shtator 2019, gjykata ua kishte ndaluar mediave dhe monitoruesve që t'i publikojnë deklaratat e të akuzuarve, me arsyetimin se me publikimin e deklaratave mund të bëhet bashkërendimi i deklarimeve të të akuzuarve.¹²⁷

Pas disa seancave të zhvilluara, me 21 nëntor 2019, Gjykata Themelore në Pejë, të akuzuarin Murat Sinanaj e kishte dënua me 19 vite burgim, Bekim Rajën me 15 vite burgim, Avni Sinanajn me 9 vite burgim kurse Gjon Pnishin me 6 vite burgim.¹²⁸ Ky rast gjendet në Gjykatën e Apelit.

Një nga shkeljet e para të evidentuara në këtë gjykim ka qenë kufizimi i paarsyetuar dhe i pabazuar i kryetarit të trupit gjykues, Sami Sharaxhiu për ndalimin e incizimit dhe monitorimit gjatë fazës së dhënies së mbrojtjes nga ana e të pandehurve.

“Kryetari i trupit gjykues vlerëson se duke e pasur parasysh se shqyrtimi gjyqësor ka arritur në fazën ku të pandehurit do ta japin mbrojtjen e tyre lidhur me veprën penale për të cilën akuzohen e meqenëse të katër të pandehurit akuzohen se veprën penale e kanë kryer në bashkim kriminal, incizimi i tyre gjatë dhënies së dëshmisë do të mund të ndikojë në rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor. Gjykata ka planifikuar që të pandehurit të deklarohen në seancat e caktuara me datat 23.09.2019, 24.09.2019, 25.09.2019, 26.09.2019, ashtu që secili prej tyre do ta japë mbrojtjen në ditë të ndryshme andaj, meqenëse të pandehurit akuzohen për një vepër penale të natyrës së rëndë dhe dënimi i paraparë për këtë vepër është mjaftë i lartë, ekziston rreziku që incizimi i deklaratës së një të pandehuri të keqpërdoret në drejtim të bashkërendimit të mbrojtjes mes tyre e me këtë të pengohet arritja e qëllimit të gjykimit. Shqyrtimi gjyqësor do të vazhdojë më datën 03.10.2019, për kur është planifikuar që të jepet fjala përfundimtare nga ana e palëve në procedurë, në seancën e kësaj date lejohet filmimi. Kundër këtij aktvendimi

¹²⁶ “Prokurorja thotë të jetë njoftuar nga dy të burgosur se e kishin dëgjuar të akuzuarin duke kërcënuar prokurorët”. Betimi për Drejtësi. 21 maj 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurorja-thote-te-jete-njoftuar-nga-dy-te-burgosur-se-e-kishin-degjuar-te-akuzuarin-duke-kercenuar-prokuroret/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹²⁷ “Gjykata ndalon publikimin e deklaratave të të akuzuarve për vrasjen me pagesë në Deçan”. Betimi për Drejtësi. 23 shtator 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-ndalon-publikimin-e-deklaratave-te-akuzuarve-per-vrasjen-me-pagese-ne-decan/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹²⁸ “49 vjet burgim ndaj katër të akuzuarve për vrasjen me pagesë në Deçan”. Betimi për Drejtësi. 21 nëntor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/49-vjet-burgim-ndaj-kater-te-akuzuarve-per-vrasjen-me-pagese-ne-decan/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

lejohet ankesa në afat prej 3 ditësh në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, pas marrjes së të njëjtit, e nëpërmes kësaj Gjykate.”, thuhej në aktvendimin e Sarraxhiut.

Mirëpo, IKD kishte gjetur se një vendim i tillë është arbitrar, i pabazuar në ligj dhe kundërthënës në vetvete. Kjo për arsye sepse është ndaluar xhirimi, ndërsa monitoruesit janë lejuar të monitorojnë seancën pa pasur të drejtë për të raportuar deri në përfundimin e mbrojtjes të pandehurve dhe të jesh në një seancë publike e të ndalohet monitorimi është vendim kundërthënës dhe i pabazuar.

Arsyetimi i aktvendimit nuk qëndron sepse nuk ka logjikë të ndalohet xhirimi apo filmimi e të mos ndalohet në tërësi seanca, informatat prej të cilës, nëse publikohen do të mund ta rrezikojnë në çfarëdo mënyrë administrimin e drejtësisë për një gjykim të drejtë.

IKD vlerëson se publiciteti i seancave gjyqësore duhet të kuptohet në atë formë që në asnjë rrethanë nuk e dëmton administrimin e drejtësisë. Në të kundërtën, siç e përcakton edhe praktika e GjEDNj, ajo i mbron palët ndërgjyqëse kundër administrimit të drejtësisë në mënyrë të fshehur dhe është një nga mënyrat me anë të së cilës mbahet besimi në gjykata. Gjyqtarët duhet të jenë të vetëdijshëm se publiciteti i seancave gjyqësore, sipas GjEDNj-së, është një nga elementet që formëson të drejtën për një proces të rregullt.¹²⁹

¹²⁹ “IKD reagon ndaj praktikës së mbylljes të kundërligjshme të seancave të caktuara gjyqësore, duke censuruar mediat dhe publikun, kërkon llogaridhënie të gjykatësve”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. 24 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://kli-ks.org/ikd-reagon-ndaj-praktikes-se-mbylljes-te-kunderligjshme-te-seancave-te-caktuara-gjyqesore-duke-cenzuruar-mediat-dhe-publikun-kerkon-llogaridhenie-te-gjykatesve/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

2. Vrasje e cila u rikualifikua në vrasje nga pakujdesia

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.262/19

Vepra penale: “Vrasje nga pakujdesia”

Kryetari i Trupit Gjykses: Shashivar Hoti

Prokuror : Javorka Princevic

I pandehur: Nexhat Blakqori

Faza e procedurës: Aktgjykim i shkallës së parë

Nga ngritja e aktakuzës deri më 31 dhjetor kanë kaluar 62 ditë apo 2 muaj e një ditë

Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 30 tetor 2019, kishte ngritur aktakuzë ndaj Nexhat Blakqorit, të cilin pas ricilësimit të kualifikimit të veprës penale, e ngarkon me veprën penale “vrasje nga pakujdesia”, nga neni 172, lidhur me nenin 23 dhe nenin 24 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas aktakuzës, Blakqori, më 20 korrik 2019, në shkallët e nënkalimit, në bulevardin “Bill Kllinton”, pas mosmarrëveshjes verbal fizikisht e ka sulmuar tani të ndjerin Gani Rama, duke e goditur shume herë me grushte në pjesën e kokës, në këmbë e në pjesë të krahavorit. Në aktakuzë thuhet se si rezultat kësaj, tani i ndjeri e kishte humbur baraspeshën dhe ishte rrëzuar nga shkallët, duke ardhur deri te vdekja e viktimës. Me këto veprime, Blakqori akuzohet se ka kryer veprën penale të vrasjes nga pakujdesia.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Kallëzimin penal ishte parashtruar më 24 korrik 2019, ndërsa aktakuza ishte ngritur më 30 tetor 2019, për veprën penale “Vrasje”, për të cilën është i paraparë dënim jo më pak se pesë vjet burgim.

Mirëpo, gjatë seancës fillestarë të mbajtur me 6 dhjetor, e cila ishte mbajtur 37 ditë pas ngritjes së aktakuzës, duke mos u respektuar afati i paraparë me Kod të Procedurës Penale, prokurorja Princevic, kishte bërë cilësimin e aktakuzës, duke e ngarkuar të akuzuarin me veprën penale “vrasje nga pakujdesia”, nga neni 175 i KPRK- së, vepër për të cilën është paraparë dënim në kohëzgjatje prej gjashtë muaj deri në pesë vjet. Ndërkaq, pas këtij ricilësimi, i akuzuari kishte pranuar fajësinë. Pas ricilësimit të veprës penale, Gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit Blakqori, duke nënvizuar se i pandehuri këtë e kishte bërë në mënyrë të vullnetshme dhe duke qenë i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë¹³⁰.

¹³⁰ “Vrasja te nënkalimi në Prishtinë, ricilësohet vepra penale, i akuzuari e pranon fajësinë”. Betimi për Drejtësi. 06 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/vrasja-te-nenkalimi-ne-prishtine-ricilesohet-vepra-penale-i-akuzuari-e-pranon-fajesine/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

Tre ditë pas pranimit të fajësisë, kjo gjykatë e kishte dënuar me katër vjet e tetë muaj burgim të akuzuarin Nexhat Blakqori.¹³¹

Në arsyetimin e aktgjykimit thuhet se gjatë shqiptimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, mënyra e kryerjes së veprës penale, pesha e saj, një ashtu duke pasur për bazë se ndëshkueshmëria për këtë vepër penale, është 6 muaj deri në 5 vite, andaj gjykata i shqiptoi një dënim prej 4 vite e 8 muaj, duke konsideruar se me një shqiptim të tillë, do të arritët edhe qëllimi i dënimit. Ndërsa si rrethana lehtësuese mori për bazë se vepra është kryer nga pakujdesia, veprimi ka qenë i atëçastshëm, ndërsa i njëjti është familjar, është penduar për veprën penale të cilën e ka kryer, andaj gjykata i shqiptoj një dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi”.

Rasti aktualisht gjendet në shqyrtim në Gjykatën e Apelit.

¹³¹“ Dënohet me 4 vjet e 8 muaj burg i akuzuari për vrasjen të nënkalmi në Prishtinë”. Betimi për Drejtësi. 09 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-4-vjet-e-8-muaj-burg-i-akuzuari-per-vrasjen-te-nenkalimi-ne-prishtine/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

3. Rasti të akuzuarve për planifikim të sulmeve vetëvrasëse dhe vepra të tjera terroriste

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.258/18

Vepra penale: “Lehtësimi në kryerjen e terrorizmit” “Përgatitja e veprave terroriste ose veprave kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”, “Kryerja e veprës terroriste”, “Rekrutimi për terrorizëm”, “Moslajmërim i veprave penale apo kryerësve të tyre”, “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”

Kryetari i Trupit Gjykses: Mustaf Tahiri

Prokuror special: Afrim Shefkiu

Të pandehur: Bujar Behrami, Gramos Shabani, Albert Ademaj, Leotrim Musliu, Edona Haliti, Rasim Kastrati

Faza e procedurës: Aktgjykim i shkallës së parë

[Nga ngritja e aktakuzës e deri më 31 dhjetor 2019 kanë kaluar 453 ditë apo 1 vit e 2 muaj](#)

Sipas aktakuzës, të akuzuarit Bujar Behrami e Resim Kastrati, gjatë periudhës kohore nga muaji dhjetor 2017 e deri me datën 29 qershor 2018, kanë përgatitur sulme terroriste në Kosovë.

Sipas prokurorisë, i akuzuari Bujar Behrami ka tentuar ta krijojë grupin me emër “Ndihmëtarët e shtetit Islam në tokën e shqiptonjave”, për të vepruar në Kosovë, Maqedoni e Shqipëri. Veçmas janë përgatitë për sulme terroriste në diskotekat “Insomnia” dhe “Kamboxha” në Graçanicë, si dhe ndaj kishës ortodokse afër kafenesë “Moskva”, në pjesën veriore të Mitrovicës, si dhe vende të tjera të frekuentuara me qytetarë.

Në aktakuzë thuhet se Resim Kastrati është angazhuar në drejtim të furnizimit me armë të zjarra dhe materiale plasëse, si dhe gjetjen e personave për vendosjen e jelekëve me eksploziv.

I akuzuari Bujar Behrami, sipas pretendimit të prokurorisë, gjatë muajit prill – maj të vitit 2018, me qëllim të kryerjes së akteve terroriste në Kosovë, e gjatë komunikimit me personin e quajtur Mursel Murseli, i njëjti nga Gjermania ka dërguar mjete financiare për të dyshuarin Resim Kastrati, me qëllim të blerjes së materialeve eksplozive dh armëve të zjarra.

Në aktakuzë thuhet se me datë 20 prill 2018, 24 prill 2018 dhe 14 maj 2018, përmes institucioneve për transferimin e parave “Money Gram” dhe “Western Union”, tërthorazi ka dërguar shumën e të hollave prej 2629.45 euro, 3117.01 euro dhe 3255.00 euro (gjithsej 9001.46 euro), në emër të personit të quajtur Petrit Gashi (dëshmitar anonim) i shpallur nga Gjykata, e që edhe të njëjtat transaksione me implementimin e masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit janë konfirmuar nga vet i dyshuari Behrami.

Gramos Shabani po akuzohet se gjatë muajit maj e deri më 2 qershor 2018, me dashje direkte ka planifikuar përgatitjen e akteve terroriste në Belgjikë dhe në Francë, meqë është edhe shtetas belg, si dhe kishte planifikuar sulm vetëvrasës me eksploziv në vende të frekuentuara me qytetarë.

Po ashtu, ai po dyshohet se me dashje direkte i ka bërë thirrje bashkëshortes së tij Edona Haliti në drejtim të përgatitjes së akteve terroriste në Kosovë, duke e udhëzuar që të bëjë sulm vetëvrasës me materie eksplozive me automjet, ndaj pjesëtarëve të KFOR – it në Kosovë dhe në vendet e tjera të frekuentuara me qytetarë, e duke e planifikuar edhe furnizimin me armë të zjarra dhe materiale eksplozive, me qëllim të kryerjes së aktit terrorist.

E akuzuara Edona Haliti, sipas aktakuzës, gjatë muajit maj e deri më 02 qershor 2018, duke vepruar sipas udhëzimeve të të akuzuarit Gramos Shabani, është përfshirë në veprime inkriminuese të përgatitjes së akteve terroriste në Kosovë, duke planifikuar të bëjë sulm vetëvrasës me materie eksplozive në automjet ndaj pjesëtarëve të KFOR – it në Kosovë, si dhe në vende të tjera të frekuentuara me qytetarë, duke u furnizuar me armë të zjarra dhe materie plasëse me qëllim të kryerjes së aktit terrorist.

Dy të akuzuarit tjerë Albert Ademaj dhe Leotrim Musliu, prokuroria i akuzon se nga muaji dhjetor 2017, e deri më 29 qershor 2018, në Prishtinë dhe vende të tjera në Kosovë, edhe pse kanë qenë në njohuri dhe të informuar se Bujar Behrami dhe Resim Kastrati janë duke përgatitë akte terroriste në Kosovë, nuk i kanë lajmëruar në polici për veprimet inkriminuese.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

PSRK aktvendimi për fillimin e hetimeve e kishte nxjerrë me 8 dhjetor 2017, ndërsa me 4 tetor 2018 e kishte ngritur aktakuzën ndaj gjashtë të akuzuarve për vepra të ndryshme penale që lidhen me terrorizmin.

Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte mbajtur me 1 nëntor 2018 brenda afatit ligjor, pasi aktakuza ishte ngritur me 4 tetor 2018. Në këtë seancë të akuzuarit Bujar Behrami, Gramos Shabani, Albert Ademaj, Leotrim Musliu dhe Edona Haliti, janë deklaruar të pafajshëm, ndërsa i akuzuari tjetër lidhur me këtë rast, Resim Kastrati, nuk u deklarua, meqë kishte vendosur të mbrohet në heshtje.¹³² Mbrojtësit e të akuzuarve në afat ligjor kishin parashtruar kërkesat për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave, mirëpo të njëjtat kërkesa jashtë seancës ishin refuzuar nga kryetari i trupit gjykues, gjykatësi Mustaf Tahiri.

Pas konfirmimit të aktakuzës, seanca e parë e shqyrtimit kryesor është mbajtur me 14 shkurt 2019, në të cilën seancë të akuzuarit edhe njëherë janë deklaruar të pafajshëm, si dhe është dëgjuar hetuesi policor në Drejtorinë Kundër Terrorizëm, Adnan Omeri, i cili e kishte hetuar rastin e gjashtë të akuzuarve për terrorizëm.¹³³

¹³² “Deklarohen të pafajshëm të akuzuarit për planifikim të sulmeve vetëvrasëse dhe vepra të tjera terroriste”. Betimi për Drejtësi. 1 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohen-te-pafajshem-te-akuzuarit-per-planifikim-te-sulmeve-vetevrasese-dhe-vepra-te-tjera-terroriste/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹³³ “Hetuesi policor tregon si e kishte hetuar rastin kundër të akuzuarve për planifikim të sulmeve terroriste në Kosovë”. Betimi për Drejtësi. 14 shkurt 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/hetuesi-policor-tregon-si-e-kishte-hetuar-rastin-kunder-te-akuzuarve-per-planifikim-te-sulmeve-terroriste-ne-kosove/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

Seanca e radhës është mbajtur me 7 mars 2019, në të cilën seancë është dëgjuar dëshmitari Samir Hajdari i cili ka deklaruar se i akuzuari për përgatitje të sulmeve terroriste Resim Kastrati, e kishte përkrahur luftën në Siri dhe Irak dhe i kishte arsyetuar të rinjtë që kishin rënë në rrugë të Allahut. Pas konstatimit të përfundimit të kësaj seance, i akuzuari Kastrati ka deklaruar se gjatë vizitave në qendrën e paraburgimit si në Dyz dhe Hajvali, bashkëshortes së tij e cila ishte e mbuluar me “ferexhe”, nuk i lejohet vizita, por gjykatësi Tahiri e njoftoi se rregullat e vizitave në qendrat e paraburgimit përcaktohen me rregulloret përkatëse dhe si të tilla duhej të zbatoheshin.

Në seancën e mbajtur me 11 prill 2019, i akuzuari Kastrati kishte kërkuar nga trupi gjykues që avokati i tij të mos quhej i mbrojturi i tij, pasi sipas të akuzuarit mbrojtësi i tij i vetëm ishte Allahu.¹³⁴ Seanca e 12 prillit 2019 kishte dështuar të mbahej për shkak të mungesës së anëtares së trupit gjykues, gjykatëses Nushe Kuka-Mekaj.

Në seancën e mbajtur me 23 prill 2019, janë dëgjuar video incizimet nga monitorimi i masave të fshehta të bisedave në vende publike dhe private. Në këtë seancë mbrojtja e ka kundërshtuar video incizimin ku dëgjohej biseda e të akuzuarit Gramos Shabani i cili e kishte udhëzuar bashkëshorten e tij, të akuzuarën Edona Haliti që të kryejë sulm vetëvrasës ndaj KFOR-it.¹³⁵ Ky rast është ende në proces.

Në seancën e mbajtur me 13 qershor 2019, ishte administruar si provë, një raport që autoritetet gjermane ia kishin dorëzuar Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ku thuhej se të akuzuarit për terrorizëm, Bujar Behrami, i ishin gjetur fotografi dhe video në përkrahje të shtetit islamik. Mirëpo, këtë raport, e kishte kundërshtuar mbrojtësi i Behramit, avokati Arber Fazliu, i cili tha se të gjetura e këtij raporti, nuk e inkriminonin të mbrojturin e tij, pasi sipas tij, çdo kush ishte i lirë të hulumtojë në internet ose portale të ndryshme çfarë të dojë. Gjatë kësaj seance ishin parashtruar edhe propozime të tjera nga ana e mbrojtjes. Sigurimi i raportit mbi kalimin e pikave kufitare për periudhën e gjysmës së dytë të muajit mars 2018, dhe sigurimin e hartografisë nga operatorët mobil lidhur me komunikimin e të akuzuari Kastrati me të akuzuarin Ademaj, ishin aprovuar nga trupi gjykues, ndërsa ishte refuzuar propozimi që në cilësi të dëshmitarit të dëgjohej Mirsad Halimi.¹³⁶

¹³⁴ “I akuzuari për terrorizëm: Refuzoj që avokati im të quhet mbrojtësi im, për shkak se mbrojtësi im i vetëm është Allahu”. Betimi për Drejtësi. 11 prill 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-per-terrorizem-refuzoj-qe-avokati-im-te-quhet-mbrojttesi-im-per-shkak-se-mbrojttesi-im-i-vetem-eshte-allahu/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹³⁵ “Në gjykimin për terrorizëm dëgjohen audio-incizimet, mbrojtja nuk e konsideron provë bisedën ku i akuzuari e udhëzon bashkëshorten e tij për sulm vetëvrasës ndaj KFOR-it”. Betimi për Drejtësi. 23 prill 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ne-gjykimin-per-terrorizem-degjohen-audio-incizimet-mbrojtja-nuk-e-konsideron-prove-biseden-ku-i-akuzuari-e-udhezoon-bashkeshorten-e-tij-per-sulm-vetevrases-ndaj-kfor-it/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹³⁶ “Prokurori: Raporti i autoriteteve gjermane thotë se të akuzuarit për terrorizëm i ishin gjetur fotografi dhe video në përkrahje të organizatave terroriste”. Betimi për Drejtësi. 13 qershor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-raporti-i-autoriteteve-gjermane-thote-se-te-akuzuarit-per-terrorizem-i-ishin-gjetur-fotografi-dhe-video-ne-perkrahje-te-organizatave-terroriste/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

Në seancën e mbajtur me 19 gusht, gjykata e ka aprovuar propozimin e prokurorit të Shefkiiu që të lexohen deklaratat e të akuzuarve të dhëna në polici dhe prokurori. Ky vendim kishte ardhur pas polemikave të zhvilluara në momentin kur prokurori Shefikui para se të fillonte me fjalën përfundimtare kishte thënë se ka propozim që të administrohet edhe një provë.

Prokurori Shefkui kishte thënë se bazuar në atë që të akuzuarit në seancën e 29 korrikut ishin mbrojtur në heshtje, kërkon që si provë gjykata të administrojë procesverbalet mbi marrjen në pyetje të të akuzuarve në polici dhe prokurori. Sipas Shefkuiut, deklaratat e të akuzuarve ishin marrë në harmoni me ligjin, andaj këtë propozim tha se e mbështet në këto fakte, mirëpo këtë propozim e kundërshtuan kategorikisht avokatët e të akuzuarve.

I akuzuari Resim Kastrati, kishte thënë se nuk pajtohet me deklaratimet e tij, pasi që ai sa ishte marrë në pyetje në polici ishte rrahur dhe kishte pasur torturë fizike e psikike nga policët. I njëjti shtoi se pas gjashtë orëve kishte ardhur avokati e aty iu ishin cekur të drejtat e tij. Lidhur me këtë pretendim, avokati Hamdi Jashanica, kishte thënë se kishte qenë prezent gjatë dhënies së deklaratës të klientit të tij Kastratit, mirëpo atij në atë kohë i ishin lexuar të drejtat dhe ishte trajtuar në mënyrë korrekte në prezencë të tij. Pretendime të njëjta me të bashkakuzuarin Kastrati, kishte ndarë edhe i akuzuari Shabani, i cili kishte thënë se përkrah deklaratën e Kastratit pasi që ata kishin pasur dhunë fizike dhe psikike gjatë marrjes në pyetje në polici. Se ishte keqtrajtuar nga policët ka thënë edhe i akuzuari Ademaj. Kurse, i akuzuari Musliu kishte thënë se nuk kishte pasur dhunë gjatë marrjes në pyetje në polici. Në fund këtë propozim e kishte kundërshtuar edhe avokati i të akuzuarës Edona Haliti, i cili tha se ky propozim është në kundërshtim me dispozitat e procedurës penale.

Trupi gjykues duke u bazuar në propozimin e prokurorit dhe pas marrjes së mendimit nga mbrojtësit e të të pandehurve si dhe të pandehurve kishte marrë aktvendim që të aprovojë propozimin e prokurorit që deklaratat e Behramit, Kastratit, Shabanit, Ademajt, Musliut dhe Halitit të dhëna gjatë fazës së hetimeve të lexohen. Pas pajtimit të palëve, këto deklarata u konstatuan si të lexuar.¹³⁷

Më 30 gusht ishte dhënë fjala përfundimtare nga palët në procedurë, ku prokuroria kishte kërkuar dënimin e të akuzuarve, ndërsa mbrojtja lirim të tyre nga akti akuzues.¹³⁸

Më 4 shtator, Gjykata Themelore në Prishtinë i ka shpallur fajtorë gjashtë të akuzuarit. Sipas aktgjykimit të shpallur nga gjykatësi Mustaf Tahiri, i akuzuari Bujar Behrami, ishte dënuar me 10 vjet burgim efektiv, për dy vepra penale “përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”, si dhe “kryerja e veprës

¹³⁷ “Disa nga të akuzuarit për terrorizëm thonë se ishin rrahur e keqtrajtuar në polici”. Betimi për Drejtësi. 19 gusht 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/disa-nga-te-akuzuarit-per-terrorizem-thone-se-ishin-rrahur-e-keqtrajtuar-ne-polici/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹³⁸ “Gjashtë të akuzuarit për terrorizëm kërkojnë pafajësinë, prokuroria thotë se ata planifikuan sulme terroriste”. Betimi për Drejtësi. 30 gusht 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjashte-te-akuzuarit-per-terrorizem-kerkojne-pafajesine-prokuroria-thote-se-ata-planifikuan-sulme-terroriste/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

terroriste”. Për të njëjtat vepra penale, me katër vjet burg ishte dënuar edhe i akuzuari Resim Kastrati.

I akuzuari për përgatitje të veprave terroriste dhe për rekrutim në terrorizëm, Gramos Shabani ishte dënuar me dënim unik prej shtatë vjet burgim. Kurse, Edona Haliti ishte dënuar me një vit burgim, për “përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”, dhe veprën penale “kryerja e veprës terroriste”. Albert Ademaj ishte dënuar me një vit e gjashtë muaj burgim, për mos lajmërim të veprave penale. Për mos lajmërim të veprave penale dhe armëmbajtje pa leje, Leotrim Musliu ishte dënuar me dënim unik prej dy vjet e tre muaj burgim. Të akuzuarit Bujar Behrami, si dënim plotësues do t’i konfiskohet shuma prej 9000 mijë euro, ndërsa të akuzuarit Musliu, armët dhe fishekët e sekuestruar. Të akuzuarit ishin të obliguar të paguajnë nga 50 euro në emër të shpenzimeve procedurale dhe nga 50 euro për fondin për kompensim të viktimave. Të gjithë të akuzuarve, sipas aktgjykimin të shpallur, do t’u llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim.¹³⁹

Më 30 dhjetor 2019, ishin shqyrtuar pretendimet e palëve të parashtruara në ankesa ndaj aktgjykimin të shkallës së parë në Gjykatë të Apelit.¹⁴⁰

¹³⁹ “Mbi 25 vjet burg për gjashtë të akuzuarit për përgatitje të sulmeve terroriste”. Betimi për Drejtësi. 04 shtator 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mbi-25-vjet-burg-per-gjashte-te-akuzuarit-per-pergatitje-te-sulmeve-terroriste/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

¹⁴⁰ “Të dënuarit me mbi 25 vjet burg për terrorizëm kërkojnë pafajësinë në Apel, PSRK-ja kërkon dënime më të ashpra”. Betimi për Drejtësi. 30 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/te-denuarit-me-mbi-25-vjet-burg-per-terrorizem-kerkojne-pafajesine-ne-apel-psrk-ja-kerkon-denime-me-te-ashpra/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

12. ANEX IV: Analizë e detajuar e rastit që është ende në proces

1. Tre faze aktakuzë për tre të vrarët në Mati 1

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.294/19

Vepra penale: Vrasje në tentativë dhe mbajtje në pronësi, kontroll apo ose posedim të paautorizuar të armëve

Kryetari i Trupit Gjykses: Suzana Çerkini

Prokuror: Ilaz Beqiri

I pandehur: Naim Mehmeti

Faza e procedurës: Në proces

Nga ngritja e aktakuzës e deri më 31 dhjetor 2019 kanë kaluar 34 ditë apo 1 muaj e 4 ditë

Sipas aktakuzës së përpiluar më 27 nëntor 2019, ekziston dyshimi i bazuar se pas një kontesti pronësor që kishin mes vete familja Rafuna dhe Mehmeti, më 5 shtator 2019, rreth orës 15:40, në kryqëzimin e rrugës “Muharrem Fejza” dhe “Jakov Xoxa”, i pandehuri Naim Mehmeti ka tentuar që ta privojë nga jeta tani të ndjerin Mufail Rafuna.

Këtë thuhet se e ka bërë në atë mënyrë që paraprakisht është fjalosur me tani të ndjerin rreth anësorëve të shkallëve, të cilat i kishte hekur Mufail Rafuna dhe në momentin kur tani i ndjeri ka nxjerrë armën nga çanta, i pandehuri ka filluar të ikë rreth lokaleve duke vrapuar.

Sipas akuzës, i ndjeri Rafuna ka shtënë në drejtim të të pandehurit me revole dhe e ka goditur në pulpin e këmbës së majtë dhe në gishtin e madh të asaj këmbë.

Tutje, thuhet se i pandehuri ka shkuar në banesën që gjendet në katin e tretë, ka dëgjuar të shtënëat e armëve, ka marrë armën automatike, ka dal në hyrje të banesës, ka parë të plagosur Mufail Rafunën, e vëllain e tij, Bashkim Mehmetin, por fatmirësisht tani në ngjarje ishte implikuar pjesëtari i Policisë së Kosovës, në rroba civile, Irfan Bunjaku, i cili ka arritur që të pandehurit t’ia marrë armën “AK 47”, nga dora dhe ta vejë në kontroll të pandehurin, në të cilën kishte fishekun në tytë, dhe 28 fishekë të tjerë në karikator, ndërsa polici ka vërejtur se ka qenë i plagosur nga të shtënëat e Mufail Rafunës.

Për këtë akuzohet për veprën penale “Vrasje në tentativë”.

Ndërkaq, dispozitivi i dytë i aktakuzës thotë se nga data e pacaktuar deri më 5 shtator 2019, pa autorizim ka poseduar armën e tipit “AK47”, me 29 fishekë, me të cilin ka kryer veprën penale si në pikën e parë të akuzës, e pas bastisjes në banesë të tij, janë gjetur dhe sekuestruar 80 fishekë automatikut dhe 64 fishekë të pistoletës.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Më 5 shtator 2019, lagjja “Mati 1” në Prishtinë, ishte tronditur nga konflikti i armatosur në mes familjes Mehmeti dhe Rahuna, pas të cilin konflikt, kishin mbetur të vdekur tre persona. Ndër

tre personat e vdekur, një ishte nga familja Mehmeti, një nga familja Rafuna, derisa nga ky konflikt i armatosur, ka ndërruar jetë edhe një kalimtar rasti.

85 ditë më vonë, konkretisht me 27 nëntor 2019, Prokuroria Themelore në Prishtinë për këtë rast kishte ngritur aktakuzë prej tre faqe.

Në këtë rast, seanca fillestare ishte caktuar të mbahet me 6 dhjetor të vitit 2019, apo pas 9 ditësh nga ngritja e aktakuzës, por kishte dështuar të mbahet për shkak se mbrojtja ishte pajisur pjesërisht me shkresa të lëndës.¹⁴¹

Ndërsa, seanca fillestare e caktuar me 12 dhjetor 2019 kishte arritur të mbahej ku i akuzuari Naim Mehmeti, kishte mohuar fajësinë për vrasje në tentativë, ndërkaq fillimisht kishte pranuar fajësinë për armëmbajtje pa leje, fajësi e cila është pranuar nga gjykata e më pas është revokuar. Gjykatësja e rastit Suzana Çerkini kishte aprovuar pranimin e fajësisë për këtë vepër penale, ndërkaq mbrojtësi i të akzuarit kishte deklaruar se i mbrojturi i tij e kishte pranuar fajësinë vetëm për armën që ka pasur në dorë, ndërkaq për municion jo, pasi nuk janë gjetur në dhomë të tij. Për këtë arsye, prokurori Ilaz Beqiri kishte deklaruar se në këto rrethana nuk ka kushte për pranim të fajësisë. Më pas, gjykatësja Çerkini kishte bërë revokimin e pranimin të fajësisë. Ndërkaq, në këtë seancë fillestare, është refuzuar kërkesa e mbrojtjes që të ndërpritet masa e arrestit shtëpiak.

Siç është cekur edhe më lartë, për këtë rast, është ngritur një aktakuzë tre faqëshe. Në një nga tri faqet e kësaj aktakuze thuhet se i pandehuri këtë e ka bërë në atë mënyrë që paraprakisht është fjalosur me tani të ndjerin rreth anësorëve të shkallëve, të cilat i kishte hekur Mufail Rafuna dhe në momentin kur tani i ndjeri ka nxjerrë armën nga çanta, i pandehuri ka filluar të ikë rreth lokaleve duke vrapuar. Sipas akuzës, i ndjeri Rafuna ka shtënë në drejtim të të pandehurit me revole dhe e ka goditur në pulpën e këmbës së majtë dhe në gishtin e madh të asaj këmbë. Tutje, thuhet se i pandehuri ka shkuar në banesën që gjendet në katin e tretë, ka dëgjuar të shtënat e armëve, ka marrë armën automatike, ka dalë në hyrje të banesës, ka parë të plagosur Mufail Rafunën, e vëllain e tij, Bashkim Mehmetin, por fatmirësisht tani në ngjarje ishte implikuar pjesëtari i Policisë së Kosovës, në rroba civile, Irfan Bunjaku, i cili ka arritur që të pandehurit t'ia marrë armën "AK 47", nga dora dhe ta vejë në kontroll të pandehurin, në të cilën kishte fishekun në tytë, dhe 28 fishekë të tjerë në karikator, ndërsa polici ka vërejtur se ka qenë i plagosur nga të shtënat e Mufail Rafunës.

Në pak më shumë se një faqe arsyetim të kësaj aktakuze, trajtohet dëshmia dëshmitarit të vetëm të propozuar në aktakuzë dhe vetëm dy prova materiale. Po ashtu, në këtë pjesë është e listuar edhe deklarata e të pandehurit. Sa i përket vrasjes së mbetur në tentativë, organi i ndjekjes nuk ka elaboruar asgjë mbi formën dhe mënyrën e kryerjes së kësaj veprë penale, konkretisht veprimeve të ndërmarra nga ana e të pandehurit, me anë të së cilave ka tentuar ta privojë nga

¹⁴¹ "Rasti i vrasjeve në "Mati I", dështon seanca fillestare ndaj Naim Mehmetit që mbante automatikun në dorë". Betimi për Drejtësi. 06 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-i-vrasjeve-ne-mati-1-deshton-seanca-fillestare-ndaj-naim-mehmetit-qe-mbante-automatikun-ne-dore/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

jeta Mufail Rafunën. Ndër të tjera, në dispozitivin e aktakuzës, viktimës, aktakuza vazhdimisht i referohet si “tanimë i ndjeri”, nga dispozitivi në këtë aktakuzë në asnjë rrethanë nuk kuptohet nëse bëhet fjalë për vrasje apo për vrasje në tentativë. Neni 20 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) përcakton se “personi nuk është penalisht përgjegjës kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojës mungon lidhja shkakore”. Në kuptim të nenin 241, paragrafit 1.4 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), Prokuroria në këtë rast nuk sqaron fare nëse Mufail Rafuna, të cilit i referohet si “tani i ndjeri”, është vrarë si pasojë e të pandehurit apo ndonjë personi të tretë të involvuar në këtë konflikt.

Tutje, prokuroria i referohet veprës penale me një emërtim i cili nuk ekziston në Kodin, sipas të cilit prokuroria ka ngritur këtë aktakuzë. Emërtimi ligjor i nenit 172 të KPRK-së është “Vrasja”, derisa kësaj veprë penale, prokurori i referohet si “Vrasje në tentativë”, emërtim i cili nuk ekziston në KPRK. Çështja e emërimit ligjor të veprave penale në aktakuzë është e përcaktuar me nenin 241, paragrafi 1.5 të KPPRK-së, ku thuhet se aktakuza përmban “emërtimin ligjor të veprës penale duke iu referuar dispozitave të Kodit Penal”. Në anën tjetër, dispozitivi 2 i aktakuzës e ngarkon të pandehurin për veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, fare nuk është propozuar konfiskimi i armës dhe fishekëve tanimë të sekuestruar. Edhe këtë çështje e rregullon neni i lartcekur, i cili në paragrafin 1.9 thotë se “Aktakuza përcakton me saktësi çdo ndërtesë, pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme, fonde apo pasuri tjera që mund t’i nënshtrohen konfiskimit. Aktakuza po ashtu përshkruan provat e nevojshme që kërkohen për të arsyetuar konfiskimin nga Kapitulli XVIII i këtij Kodi”.

Për shkak të paqartësive të mëdha, “Betimi për Drejtësi” kishte kontaktuar prokurorin Ilaz Beqiri, i cili ka përpiluar këtë aktakuzë. Ai kishte thënë se arsyeja pse nuk janë përmendur personat e tjerë të ndjerë në këtë rast, është sepse ndaj tanimë të ndjerëve nuk është e mundur që të zhvillohen hetime. Ndërkaq, kishte bërë të ditur se Mufail Rafuna është vrarë nga ana e të ndjerit tjetër, Bashkim Mehmeti. Por, derisa Beqiri këtë sqarim e kishte dhënë në një prononcim për “Betimi për Drejtësi”, ai këtë nuk e ka bërë në aktin akuzues. Për këtë arsye, përpos këtyre dy dispozitave, aktakuza nuk flet asgjë tjetër mbi këtë masakër.¹⁴²

¹⁴² “Tre faqe aktakuzë për tre të vrarët në masakrën në “Mati I”. Betimi për Drejtësi. 06 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/tre-faqe-aktakuze-per-tre-te-vraret-ne-masakren-ne-mati-1/>). (Qasur për herë të fundit më 30 qershor 2020).

13. Rekomandime

- KGJK dhe KPK të bëjnë një analizë gjithëpërfshirëse të ngarkesës së DKR-ve me lëndë, në mënyrë që të kenë mundësi të ndërmarrin hapa për stabilizimin e këtyre departamenteve, veçanërisht sa i përket lëndëve të cilat barten vit pas viti.
- KGJK dhe KPK të ri analizojnë rregulloret mbi normat orientuese, në mënyrë që të krijohen indikatorë të saktë mbi matjen e efikasitetit dhe përmbushjen e obligimeve të punës të secilit gjyqtar dhe prokurorë.
- Me rastin e shqiptimit të dënimeve, gjyqtarët ta respektojnë Udhëzuesin për Politikë Ndëshkimore të miratuar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.
- Për të shmangur parashkrimin, si dhe për të respektuar të drejtën e të pandehurve për gjykim në kohë të arsyeshme, Gjykata e Apelit në rastet kur ia mundëson ligji, të vendos në mënyrë meritore dhe lëndët mos të kthehen në rigjykim, ashtu që të mos krijohet “ping-pong” gjyqësor.
- Lufta ndaj kriminalitetit të fokusohet edhe në fushën e sekuestrimit/konfiskimit të pasurisë së përfituar përmes veprës penale.
- Për rastet e lejuara me ligj, Prokurorët të aplikojnë Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë.
- Rastet gjyqësore, në të cilat të pandehurit gjendet në paraburgim të trajtohen me prioritet të lartë në mënyrë që mos të shkelen të drejtat e të pandehurit në procedurë.
- Gjyqtarët të respektojnë afatet ligjore të përcaktuara nga ana e Kodit të Procedurës Penale.
- Prokurorët të respektojnë afatet ligjore të përcaktuara për ngritje të aktakuzës nga ana e Kodit të Procedurës Penale.
- KPK të publikojë raportin e punës individuale të prokurorëve.
- Gjyqtarët të kenë parasysh dhe të respektojnë dispozitat ligjore me rastin e aprovimit dhe mos aprovimit të pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurve.
- Prokurorët të kryejnë obligimin e tyre ligjor për pajisjen e palës së akuzuar me provat në afatin ligjor të cilin e përcakton Kodi i Procedurës Penale.
- KGJK dhe kryetarët e gjykatave të marrin hapa me anë të së cilave duhet të ndalohet praktika e kufizimit të raportimit nga seancat gjyqësore publike.
- KGJK dhe KPK, të marrin masa disiplinore ndaj prokurorëve e gjykatësve të cilët kryejnë shkelje gjatë kryerjes së funksioneve të tyre.
- Gjykatat të publikojnë në faqet e tyre aktgjykimet e formës së prerë si dhe datën dhe orën se kur do të mbahen seancat.
- KGJK të mbajë përgjegjës gjyqtarët, aktgjykimet e të cilave kthehen disa herë në rigjykim. Kjo të ndodhë edhe për gjyqtarët e Gjykatave Themelore, aktgjykimet e të cilave prishen nga Gjykata e Apelit, por edhe ndaj Gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, aktgjykimet e të cilave prishen nga Gjykata Supreme.
- KGJK të adresojë dukurinë e parashkrimit të rasteve në DKR-të e Gjykatave Themelore
- Gjykatësit të zbatojnë obligimet ligjore ndaj prokurorëve, avokatëve dhe palëve tjera, të cilat nuk i arsyetojnë mungesat që ndikojnë në shtyrjen e seancave.